



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Spitalin Rajonal Shkodër

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**AUDITIMI PËRPUTHSHMËRISË
NË SPITALIN RAJONAL SHKODËR**

Tiranë, tetor 2021

PERMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	9
II. HYRJA	11
1. Objektivi i auditimit	11
2. Qëllimi i auditimit	11
3. Identifikimi i çështjes	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim	11
5. Përgjegjësitë e audituesve	11
6. Kriteret e vlerësimit	12
7. Standardet e auditimit	12
8. Metodatat e auditimit	12
9. Dokumentimi i auditimit	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13
2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	13
2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	14
2.3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative	17
2.3.1. Hartimi i Projekt Buxhetit	17
2.3.2. Buxhetit vjetor i alokuar	18
2.3.3. Planifikimi për barna dhe materiale mjekimi	20
2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave	25
2.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit për vitin 2018	30
2.5.4. Mbi Zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit për vitin 2019	40
2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile	51
2.7. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arke, banke dhe blerjet e vogla (shpenzimet administrative, për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.)	108
2.8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore	117
2.9. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit	130
2.10. Mbi zbatimin e fondeve të akorduara dhe shpenzuara për përballimin e situatës së pandemisë COVID-19	136
2.11. Të ndryshme	137
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	138
V. ANEKSE	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit

Spitali Rajonal i Shkodrës ofron kujdesin mjekësor me anë të poliklinikës së specialiteteve, shërbimin e pranim-urgjencës, laboratorin klinik-biokimik dhe bakteriologjik dhe shërbimin me shtretër në specialitetet e veta. Shërbimi i kirurgjisë në Spitalin Rajonal Shkodër ka statusin e klinikës universitare. Misioni i Spitalit Rajonal të Shkodrës është të përmirësojë shëndetin e komunitetit, duke ofruar një standard të ri në kujdesin shëndetësor, kujdesin klinik dhe ngritjen profesionale të mjekëve specialistë, duke siguruar një qendër mjekësore për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve. Rikthimi i besimit të qytetarëve për shërbimin shëndetësor, transformimi i kujdesit shëndetësor dhe krijimi i shpresës për komunitetin nëpërmjet rritjes së cilësisë dhe gamës së shërbimeve.

Në kushtet e nevojës së rritjes së autonomisë menexheriale, funksionaliteti i këshillit të administrimit do të shërbente në rritjen e disa treguesve të performancës së shërbimeve spitalore. Mungesa e tyre apo mosfunksionaliteti kanë ndikuar në zvogëlimin e autonomisë dhe kufizimin e vendimmarrjeve nga drejtuesit e institucioneve shëndetësore spitalore.

Objekti i auditimit është përputhshmëria e vendimmarrjeve nga strukturat përgjegjëse si dhe operacionet financiare të realizuara nga subjekti për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.01.2021

Qëllimi i auditimit është hartimi i projekt-raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të SRSH.

Auditimi i aktivitetit të SRSH është fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm, gjithashtu janë audituar shpenzime për personelin dhe paga, vendimet e marra nga Drejtoria e SRSH, të ardhurat, shpenzimet e realizuara, brenda periudhës së auditimit.

Janë audituar procedura prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave përkatëse, si dhe procedurat me blerje të vogël. Është audituar, dhënia me qira e ambienteve në dispozicion të SRSH, si dhe fondet e alokuara për përballimin e situatës së pandemisë COVID 19, etj.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Bazuar në nenin 15 pika 2 e Kontratës /S me nr. 45/2 date 13.01.2020, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, për vitin 2020 nuk ka ngritur komision ñad hoc për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit. Komisioni duhet të hartonte mbi bazën e kërkesave të shefave të shërbimit, listën vjetore të nevojave për barnave dhe materialeve të mjekimit për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit normal të shërbimeve spitalore deri në realizimin e procedurave të blerjes për vitin pasardhës. Lista e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit duhet të jetë e saktë dhe realiste për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e stokut të barnave të skaduara. Drejtori i SRSH Z. A. D. me shkresën nr.44 prot. date 09.01.2020 dhe nr.158 date 20.01.2020, ka përcjell në MSHMS listën me kërkesa për barna	fq. 21-22	E lartë	Drejtori i Spitalit, të përcjell pranë MSHMS, listën e barnave dhe materialeve të mjekimit për vitin ushtrimor, vetëm pas miratimit paraprak nga grupi teknik i ngritur për planifikimin e tyre SRSH të filloj hartimin e rregullores për shërbimin farmaceutik duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

	dhe materiale mjekimi për vitin 2020-2021. Por kjo listë nuk është hartuar nga asnjë komision. Veprime këto në mospërputhje me Kontrata/S nr. 45/2 date 13.01.2020, neni 15 pika 2 të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020 ndërmjet FDSKSH dhe SRSH, ku përcaktohet se: <i>“Lista e barnave që propozohet për planifikim për blerje për vitin ushtrimor, miratohet fillimisht nga grupi teknik i ngritur “Ad hoc” nga drejtori i spitalit dhe më pas dërgohet për miratim në MSHMS”</i>			
2	Gjatë vitit 2018 dhe 2019 është krijuar vlera më e madhe stokut të medikamenteve materialeve të mjekimit, të cilat kanë skaduar në farmacinë e Spitalit Rajonal te Shkodrës, si rezultat i kërkesave jo reale të shërbimeve dhe të planifikimit dhe menaxhimit jo eficient të tyre nga strukturat përgjegjëse të SRSH, duke shkaktuar një efekt negativ në buxhetin e SRSH. Si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë përgjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të Spitalit Rajonal Shkodër barna dhe materiale mjekimi në vlerën totale 11,116,722 leke. Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse. Grupi i punës për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura nga shefat e shërbimit pa analizuar gjendjen në magazinën e farmacisë dhe të qarkullimit të tyre në dy vitet e fundit.	Fq. 22-23	E Lartë	Drejtori i SRSH të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozojë masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.
3	Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionojnë dhe për një pjesë të tyre, nga komisioni është propozuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe me pas asgjësimi i tyre, sipas procedurave ligjore në fuqi. Disa nga aparaturat mjekësore janë pa dokumente dhe disa të tjera nuk janë të regjistruar në inventarin e SRSH. Nga shqyrtimi i të dhënave mbi inventarin e	Fq. 40-41	E lartë	SRSH në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bëjë vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SRSH të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e

	pajisjeve mjekësore dhe përpunimit të tyre nga pikëpamja sasiore nga grupi i auditimit rezulton, që: SRSH ka 471 pajisje mjekësore, nga këto 156 pajisje ose 33.1 % e tyre nuk funksionojnë dhe qëndrojnë prej vitesh në ambientet e brendshme të reparteve të SRSH duke ndikuar në ndotjen e ambientit për shkaqe të problematikave që ato kanë në drejtim të mundësisë së rrezatimit etj., duke ndikuar në cilësinë e shëndetit të pacienteve dhe personelit të spitalit. Të gjitha pajisjet mjekësore nuk janë regjistruar sipas formularit tip të inventarizimi, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) të pasqyruar në udhëzuesin e saj. Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO, njësia e inxhinierisë klinike pranë SRSH ka regjistruar 287 pajisje ose 61 % të tyre.			pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.
4	Marrja në dorëzim i sistemit të radhës ku përfshihet kompjuteri server, printer dhe TV Led nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe kolaudit pa verifikuar dhe identifikuar specifikimet teknike dhe markën e pajisjeve përbërëse të sistemit. Marrja në dorëzim e mallit është bërë sipas Aktit Teknik nr.1624 prot datë 08.05.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim. Akti Teknik nuk është miratuar nga titullari i institucionit ish Drejtori V.M., pasi nuk është nënshkruar prej tij. Lidhur me marrjen në dorëzim të mallrave rezulton se pajisjet e lëvruara janë të përshkruara sipas listës, pjesë e aktit por pa përcaktuar vendin e origjinës, markën (Brand Name). Po ashtu për sa i përket njësive të prenotimit me monitor me prekje dhe printer POS (fig. nr.1); monitor salle pritje (fig. Nr.2) dhe terminal thirrje numër radhë në shërbime (fig.4) janë përcaktuar si shembuj ilustrues, çka nënkupton se në momentin e hartimit të aktit dhe marrjes në dorëzim të mallit produktet nuk kanë qenë disponibël fizikisht. Për sa cituar më lart, rezulton se jemi para të njëjtave dokumenteve identik (formulari nr.3 me nr. 837 prot., date 01.03.2018 nëftese për oferte) miratuar nga titullari i AK z. V.M. dhe kontratës së shërbimit nr. 1323 prot., datë 13.04.2018 të nënshkruar nga titullari i AK V. M. dhe BOE O. shpk përfaqësuar nga R.K. dhe S.&S.	115-116	E lartë	Nga ana e Drejtorisë së SRSH të ngrihet grupi i punës për të verifikuar dhe identifikuar markën dhe specifikimet teknike të pajisjeve përbërëse hardware-ike të sistemit të radhës ku përfshihet; kompjuter server, printer dhe TV Led të dorëzuar nga BOE O. shpk dhe S.&S.

	përfaqësuar nga A. K. . Në këto kushte nuk rezultoi e dokumentuar se cilat produkte hardware-ike apo pajisje janë marrë në dorëzim dhe si kanë funksionuar ato në momentin e hartimit të aktit teknik dhe të marrjes në dorëzim.			
5	Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, rezultoi se, një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m2, përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat bar-bufë. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirimin e sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 nëPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 nëPër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore	124-125	E lartë	SRSH të bëjë inventarizimin dhe përditësimin e pasurisë së paluajtshme dhe aksesorëve të saj, si dhe në bashkëpunim me MSHMS, të marri masat e nevojshme për regjistrimin e pasurisë (truall ndërtesë), pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër. Drejtoria e SRSH, tã drejtohet zyrtarisht subjektit privat, i cili është duke përdorur sipërfaqe të truallit të pasurisë së paluajtshme të spitalit, me qëllim lirimin e saj, dhe në rast të mosveprimit nga subjekti privat, tã drejtohet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV)
6	SRSH nuk disponon kontratën koncesionare ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe S.S. me objekt nëKontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga ana e drejtuesve të SRSH brenda periudhës së auditimit nuk është kërkuar kopjo e kontratës koncesionare dhe ajo financiare të cilat rregullojnë marrëdhënien kontraktuale. Nga evidenca dokumentare konstatohet se nuk ka komunikim nga SRSH me MSHMS për evidentimin e problemeve të zbatimit të kontratës. Veprime në mospërputhje me kontratën Spitalore/S të FSDKSH dhe SRSH, neni 9, pika 1 nëDetyrime të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S.Se.ò	127-128	E lartë	Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë për kontratën koncesionare me objekt nëKontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale.
7	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Autoklava nuk është e certifikuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare	131-132	E lartë	Drejtori i SRSH të përcaktojë aktet administrative (rregullore e veçantë, urdhra, udhëzime, etj.) mënyrën e përdorimit të seteve

	të Pajisjeve Mjekësore dhe vazhdon të bëjë sterilizimin e seteve kirurgjikale kryesisht me kompleksitet të ulët. Administrimi i seteve të sterilizuara në autoklavën e spitalit bëhet në mungese të një urdhri dhe procedure të miratuara nga Drejtori i SRSH, gjithashtu setet kirurgjikale të sterilizuara nga kjo autoklavë nuk pajisen me pullën e sigurisë për evidentimin e cilësisë së sterilizimit. Përveç kostove të harxhimit të energjisë elektrike dhe ujit, nga sektori teknik për autoklavën është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Nga drejtuesit e SRSH nuk është hartuar rregullore apo udhëzim mbi administrimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara nga autoklava e SRSH . Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuara dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndara sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH.			kirurgjikale që janë në inventarin e spitalit dhe sterilizohen në autoklavën e Spitalit, për të mundur evidentimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, në sallat kirurgjikale sipas planifikimit apo rasteve urgjente, si dhe dokumentimin e tyre në regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale.
8	Nga intervistimi i punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër ku përfshihet dhe Drejtori i Spitalit, u konstatua problematikë mbi dypunësimin e disa punonjësve të Spitalit (mjek të urgjencës, mjek të përgjithshëm) të cilët gjatë orarit të punës kryenin vizita ndaj pacientëve të cilët janë të shtruar në ambientet e Hemodializës në D.V.0	29-30	E lartë	Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marri masa duke analizuar këtë situatë me qëllim shmangien e këtij fenomeni në të ardhmen.

	Sh.p.k. Pas intervistimit të këtyre mjekëve, ato pranuan para grupit të auditimit që kishin lidhur kontratë dhe me shoqërinë private të hemodializës në D.V. Sh.p.k kundrejt pagesës. Megjithatë pretendimet e tyre për një kontratë part time (e cila nuk na u vu në dispozicion) dhe e cila është e pavlefshme në momentin që Titullari i Institucionit nuk është zyrtarisht në dijeni për shërbimet që këto mjek bëjnë në ambientet e kësaj shoqërie private si edhe pasi orari zyrtar i vizitave dhe konsultave në ambientet e Hemodializës është nga ora 07:00-16:00. Nga vetë deklaratat e këtyre punonjësve rezulton se gjatë orarit zyrtar, për të cilin kanë lidhur dhe kontratën individuale me Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër, ata kryejnë shërbime të ndryshme dhe paguhen dhe nga shoqëria private në D.V. sh.p.k veprime këto në kundërshtim me Nenin nr.110 dhe nr.119 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.			
9	Nga auditimi i të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 31.12.2020, është konstatuar se është prokuruar për nëblerje ushqime 2020, (Loti 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Loti 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Loti 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Loti 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Loti 5 Fruta, perime, zarzavate etj. - REF-60469-06-08-2020). Autoriteti Kontraktor në titull i ka emërtuar si procedura me lote, por janë zhvilluar si procedura me nëblerje me vlerë të vogël dhe pavarësisht emërimit në përshkrimin e të dhënave rezultojnë se janë procedura pa lote. Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëtuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 5, nenin 29 dhe nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në për miratimin e rregullave të prokurimit publik.	109-110	E lartë	Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.
10	Kontraktori në Fas. ka dorëzuar pranë Spitalin Rajonal Shkodër 10 Lap Top, model në AC. A31...-C6FN. Nga verifikimi i specifikimeve teknike të tyre i realizuar nga grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore të tre laptop-ve mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet	113-114	E lartë	SRSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 35,395 lekë nga z. A. P., në cilësinë e përfaqësuesit të OE Fas. sh.a, si personi përgjegjës për dorëzimin e një malli me specifikime teknike të ndryshme nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm

	funksonit nëS. Inf.ò të SO Windows 10, në prezencë të anëtarëve të komisionit të prokurimit, ku në përbërjen e këtij komisioni ishte dhe specialistja e IT të SRSH. Pas verifikimit të specifikimeve teknike te tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që ka specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që:10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues nëF....òNdërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e F... janë dorëzuar 10 laptop-Model AC. A3...-C6FN me RAM-in 4 GB			nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST.
11	Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2018, të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 7,009,992 lekë dhe vlerë kontrate 6,921,840 lekë, ose më pak se fondi limit prej 88,152 lekë dhe OE fitues "SE. SG." SHPK, është konstatuar se nga KVO dhe Titullari i AK nuk është bërë shpallja fituese e ofertës më të favorshme ekonomike, duke u skualifikuar ajo, për të njëjta mangësi si dhe oferta e shpallur fituese. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike nëNI.ò SHPK & nëK.ò SHPK me vlerë oferte prej 6,850,400 lekë dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE nëSA. SG.ò SHPK me vlerë ofertë prej 6,921,740 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe SRSH për vlerën prej 71,440 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, veprime, në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.	59-60	E lartë	Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, si dhe të fillojë procedurat për arkëtimin e vlerës 71,440 lekë nga anëtarët e KVO të përbërë nga M. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A.I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. , shkaktuar si pasojë e mos shpalljes fituese të ofertës më të favorshme ekonomike.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i Auditimit

Auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko financiare të Spitalit Rajonal Shkodër, është bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, nëPër Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 154/2014, nëPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4000*, *ISSAI 4100* dhe *ISSAI 4200*. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se veprimtaria e aktivitetit të Spitalit Rajonal Shkodër, janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, kjo referuar kërkesave në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar; ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publik, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera rregullator në zbatim të veprimtarisë së institucionit, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **opinionit të kualifikuar**.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Strukturat përgjegjëse të Spitalit Rajonal Shkodër, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionin me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në parimet themelore të auditimit niveli 3 (*ISSAI 100 - 999*) të standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: *ISSAI 400* nëStandardet e Auditimit të Përputhshmërisë, *ISSAI 1500 (ISA 500)*¹ dhe *ISSAI 1530 (ISA 530)*² ; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionin në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionin të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

Mbështetur në gjetjet nga auditimi, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionin të kualifikuar, për aspekte të ndryshme, kryesisht të lidhura me shkelje të procedurave të prokurimit në shumën 50,362,661 lekë, të krijimit të stokut të barnave në shumën 11,116,722 leke, si dhe të rritjes së shpenzimeve operative kryesisht për energjinë elektrike dhe ujin, i konsumuar nga koncesionari S. S në shumën 9,599,040 leke, dhe mungesës së arkëtimit të të ardhurave nga përdorimi i ambientit nga koncesionari S. S. në shumën 1,598,400 leke. Gjithashtu dhe për shkak të pushimeve të

¹Objekti i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

²Objekti i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

pajustificuara nga puna të punonjësve, te cilët do te përfitojnë 2,299,192 lekë nga buxheti i shtetit mbi bazën e vendimeve gjyqësore., etj.

II.HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 131/1 prot., datë 28.01.2021 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.02.2021 deri më, datë 30.04.2021, në subjektin Spitali Rajonal Shkodër, për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 31.01.2021, u krye auditimi nëMbi zbatimin e përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. Xh. , Përgjegjës Grupi
2. A. L. , Auditues
3. A. A. , Auditues
4. S. H. , Auditues

1. Objektivi i auditimit:

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Spitali Rajonal Shkodër, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij.

2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme mbi administrimin e fondeve në përputhje me aktet ligjore, dhe njëkohësisht *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

3. Identifikimi i çështjes:

Spitali Rajonal Shkodër, si një institucion i ofrimit të kujdesit shëndetësor publik, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e shërbimeve spitalore duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

Strukturat drejtuese të Spitalit Rajonal Shkodër janë përgjegjëse për organizimin e duhur, funksionimin duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të spitalit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar te Spitalit Rajonal Shkodër. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të

respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 në Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 në Për prokurimin publik, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 në Për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, në Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve;

Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 në Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar;

Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003, në Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë;

Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 në Kodi i procedurave administrative, i ndryshuar;

VKM nr. 112, datë 22.2.2006 në Për kohën e punës dhe të pushimit në sistemin e shëndetësisë;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në Për miratimin e rregullave të prokurimit publik;

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 në Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore;

Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 në Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik;

Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 559, datë 26.10.2009 në Për aplikimin e tarifave për shërbimet mjekësore;

Urdhri i Ministrit nr. 526, datë 12.10.2009 në Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor;

Statuti dhe Rregullorja e Brendshme e Spitalit;

7. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)

- ISSAI 400 - (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).

- Kodi etik i KLSH.

8. Metodat e auditimit:

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{ssë} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 *ndokumentimi i Auditimit*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Spitali Rajonal i Shkodrës ofron kujdesin mjekësor me anë të poliklinikës së specialiteteve, shërbimin e pranim-urgjencës, laboratorin klinik-biokimik dhe bakteriologjik dhe shërbimin me shtretër në specialitetet e veta. Shërbimi i kirurgjisë në Spitalin Rajonal Shkodër ka statusin e klinikës universitare. Misioni i Spitalit Rajonal të Shkodrës është të përmirësojë shëndetin e komunitetit, duke ofruar një standard të ri në kujdesin shëndetësor, kujdesin klinik dhe ngritjen profesionale të mjekëve specialistë, duke siguruar një qendër mjekësore për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve. Rikthimi i besimit të qytetarëve për shërbimin shëndetësor, transformimi i kujdesit shëndetësor dhe krijimi i shpresës për komunitetin nëpërmjet rritjes së cilësisë dhe gamës së shërbimeve.

Në kushtet e nevojës së rritjes së autonomisë manexheriale, funksionaliteti i këshillit të administrimit do të shërbente në rritjen e disa treguesve të performancës së shërbimeve spitalore. Mungesa e tyre apo mosfunksionaliteti kanë ndikuar në zvogëlimin e autonomisë dhe kufizimin e vendimmarrjeve nga drejtuesit e institucioneve shëndetësore spitalore.

Objekti i auditimit është përputhshmëria e vendimmarrjeve nga strukturat përgjegjëse si dhe operacionet financiare të realizuara nga subjekti për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.01.2021

Qëllimi i auditimit është hartimi i projekt-raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të SRSH.

Auditimi i aktivitetit të SRSH është fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm, gjithashtu janë audituar shpenzime për personelin dhe paga, vendimet e marra nga Drejtoria e SRSH, të ardhurat, shpenzimet e realizuara, brenda periudhës së auditimit.

Janë audituar procedura prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave përkatëse, si dhe procedurat me blerje të vogël. Është audituar, dhënia me qira e ambienteve në dispozicion të SRSH, si dhe fondet e alokuara për përballimin e situatës së pandemisë COVID 19, etj.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 131/1 Prot., datë 28.01.2021, i ndryshuar *Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme* është pasqyruar niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH me nr. 40/11, datë 21.06.2018 të ushtruar në SRSH, ku janë lënë 56 rekomandime, nga të cilat:

- 31 masa organizative;

- 11 masa zhdëmtim dëmi;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare;
- 12 masa disiplinore.

Në mënyrë të përmbledhur gjendja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në SRSR paraqitet në tabelën nr.1 të aneksit nr.1.

Titulli i gjetjes:	Realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Situata:	Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SRSR, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë: Nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 56 rekomandime te pranuar plotësisht nga SRSR, nga te cilat : -31 masa organizative, 20 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 9 masa janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar. -Për zhdëmtim e dëmit ekonomik të shkaktuar janë rekomanduar 11 masa, 7 prej tyre janë ne proces, 1 është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar. -Për eliminimin e efekteve negative financiare ne buxhetin e shtetit, janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat 1 është zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim është proces zbatimi. -Për parregullsitë e konstatuara janë rekomanduar 12 masa disiplinore për personat përgjegjës, të cilat janë zbatuar plotësisht.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, neni 15, pika c.
Ndikimi/Efekti:	Zbatimi i plotë i rekomandimeve do të ndikojë në përmirësimin e aktivitetit të Spitalit Rajonal Shkodër.
Shkaku:	Nisur nga eksperiencia e zbatimit të rekomandimeve nga ky subjekt, konstatohet se rekomandimet nuk janë zbatuar plotësisht.
Rëndësia:	i mesëm
Rekomandime:	Nga Spitali Rajonal Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultojnë në proces, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Më hollësisht, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet në aneksin nr.1.1

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 nëPër shërbimin spitalor në RSHò dhe ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 nëPër funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publikeò, mbi ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Administrativ të Spitalit Rajonal Shkodër.
Situata:	Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Administrativ. Këshilli Administrativ megjithëse është ngritur me Vendim nr. 1716 prot., datë 15.05.2019, mbi bazën e rekomandimit te përsëritura te KLSH, rezulton që

	nuk është mbledhur dhe nuk ka vendimmarrje sipas parashikimeve të neneve 13, 14, 15 të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 në Për shërbimin spitalor në RSH. Në referim të dispozitës ligjore të sipërcituar KD, ka këto funksione, si me poshtë vijon: a) miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë; b) programon dhe i propozon Ministrit të Shëndetësisë ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut; c) propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij; ç) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra; d) i propozon Ministrit të Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të autoritetit spitalor të qarkut; dh) emëron dhe shkarkon drejtorët e spitaleve të qarkut, në bazë të propozimit të bërë nga drejtori ekzekutiv. Sipas ligjit organik, SRSH ka dy nivele drejtimi kolegjal dhe ekzekutiv. Drejtimi kolegjal realizohet nga KA i cili rezulton i pa mbledhur, pra, për periudhën 3-vjeçare e vlefshmërisë së anëtarit të KA, për një pjesë të anëtarëve ka skaduar, kurdo të ketë qenë i filluar ajo. Konkretisht përfundimi i vlefshmërisë së anëtarësisë në KA, vlen vetëm për 4 persona, përcaktuar sipas nenit 13 të ligjit nr. 9106 në Për shërbimet spitalore, (LSHP) që janë: • 2 anëtarë nga Këshilli i Qarkut Shkodër. • 1 anëtar nga Këshilli Bashkiak Shkodër, • 1 anëtar i autorizuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër. Përveç përcaktimit të mësipërm LSHP, neni 13, autorizon drejtpërdrejtë 4 anëtar të tjerë, <i>që nuk kanë nevojë për rizgjedhje</i> dhe konkretisht: • Drejtori Ekzekutiv i SRSH. • Presidenti i Urdhrit të Mjekut të Qarkut Shkodër. • Kryeinfermieri i Përgjithshëm i SRSH. • Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor të Qarkut Shkodër (DFSDKSHQSH) (ose një person i autorizuar prej tij). <i>Në këtë pikë, mos autorizimi nuk përjashton DFSDKSHQSH nga e detyrimi i tij ligjor të jetë anëtar i KA të SRSH.</i> Prefekti i Qarkut Shkodër, ka detyrim të përcaktuar ligjor, për përmbushjen e detyrave të tij, për KA të SRSH. Pavarësisht kësaj nuk vërtetohet në asnjë rast, që SRSH, tã jetë drejtuar Prefektit për të përmbushur detyrimin e tij, për caktimin e një përfaqësuesi, për në KA të Autoritetit Spitalor të Qarkut Shkodër (ASQSH). Në periudhën audituese nuk janë raportuar korrespondenca ndërmjet Prefektit Shkodër dhe SRSH, por pavarësisht sa sipër ka pasur një lloj llogaridhënie dhe konkretisht nga prefekti është kërkuar: -Probleme e detyra të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e SRSH. -Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale që rregullojnë veprimtarinë e SRSH. -Zgjidhja e ankesave kërkesave të ndryshme. -Raport përmbledhës, lidhur me evidencat për: (Zbatim buxheti të SRSH;
--	--

	Struktura organizative në SRSB; Numri i punonjësve në SRSB). Kërkesat e Prefektit përkojnë edhe me detyrat e KA, ku institucioni i Prefekturës, ka akses në këto informacione nëpërmjet përfaqësuesit të vet në KA të ASQSH, sipas LSHP, praktika të cilave SRSB nuk rezulton ti ketë trajtuar, duke kuptuar se SRSB nuk ka tentuar asnjëherë të realizoj mbledhje të KA. Përveç korrespondencave me Prefektin, SRSB po të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe me Urdhrin e Mjekut të Qarkut Shkodër (UMQSH), apo Bashkinë Shkodër, e cila po ashtu ka një përfaqësues të sajë në KA, si Këshillin e Qarkut Shkodër i cili ndryshe nga institucionet e mësipërme ka jo një po dy anëtarë KA, dhe nga ku nuk rezulton ti ketë kthyer përgjigje kërkesave të UMQSH. Mungesa e komunikimit për periudhën nën auditim, me Prefektin, Presidentin e UMQSH, DFSDKSHQSH për çështjen e mbledhjes së KA, tregon se edhe pse në çdo moment ka qenë mundësia për të mbledhur 5 nga 8 anëtarët e KA, të cilët përbëjnë mbi gjysmën e anëtarëve të KA, që mund të thërrisnin mbledhje të jashtëzakonshme të këshillit, nuk është bërë asnjë përpjekje e tillë, duke e bërë këtë situatë të pa zakonshme. Po ashtu në korrespondencat ndërmjet MSH dhe SRSB, në asnjë rast nuk është relatuar për mos mbledhjen apo mos krijimin e funksionimit të KA, sipas LSHS nenit 15, pika 2. Mbledhja e parë sipas LSHS thirret nga DE. Siç edhe u theksua më lartë ngritja e KA rezulton të jetë bërë me rekomandim të KLSH-së n. 349/1, datë 05.4.2019 dhe 555/1, datë 08.4.2019, dhe caktuar me shkresën nr. 1716, datë 15.5.2019, miratuar nga Drejtori A. D., me përfaqësinë si më poshtë: -2 përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Shkodër; -1 përfaqësues nga Institucioni i Prefektit; -1 përfaqësues nga Këshilli Bashkiak Shkodër; -1 përfaqësues nga DRF; -1 Presidenti i Urdhrit të Mjekut; -1 Drejtori i SRSB -1 Kryeinfermieri i Përgjithshëm Po ashtu në referim të LSHP është detyrë funksionale e ZDE që si Sekretar i KA, të filloj procedurat për të njoftuar anëtarët e përcaktuar nga ligji për në KA dhe MSH, të kërkojë mbledhjen e jashtëzakonshme, nga ku çdo mbledhje, në kushtet e mos mbledhjes së këshillit, do të ishte mbledhje e parë. Detyrat e ZDE, si sekretar i KA, përveç ligjit organik, përcaktohen edhe nga ligji i përgjithshëm nr. 8480 datë 27.5.1999 për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike. Më poshtë sqarojmë 3 mënyrat që duhej të ishte thirrur KA janë: • Si mbledhje e parë nga Drejtori Ekzekutiv. • Si mbledhje e jashtëzakonshme nga Ministri i Shëndetësisë. • Si mbledhje e jashtëzakonshme nga më shumë se ½ e anëtarëve. Të tre këto nñthirrje zhbllokuesë të mbledhjes, do të mund të realizoheshin pas konstatimit nga Sekretari i KA, dhe informimi përkatës drejt institucioneve, ku në çdo rast thirrja për mbledhje ju shkon institucioneve përbërës të KA, në rrugë zyrtare. Për aq kohë sa ftesa për mbledhje nuk ekziston, nuk mund të flitet për mos mbledhje të arsyeshme të KA në SRSB. Sipas strukturës së vitit 2018 e vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorëve. Në fakt, ligji organik specifikon përbërjen e
--	--

	Drejtorisë së SRSH, si më poshtë: • Drejtori Ekzekutiv • Zv. Drejtori Ekonomik • Zv. Drejtori Teknik. • Kryeinfermieri i Përgjithshëm. Pozicioni i dy ZV është riemërtuar ndryshe dhe konkretisht në Zv/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Zv/Drejtor i Shërbimeve Klinike, kur LSHS neni 18 pika 2 specifikon se: “<i>Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave</i>”. Ndryshimi në emërtesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emërtesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese, të SRSH, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas MFK, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, që në rastin e ndryshimit të emërtesave, pa VKM, ky pozicion nuk ekziston.
Kriteri:	Neni 13, 14, 15 dhe 18 i Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 nëPër shërbimin spitalor në RSH, si dhe ligji nr. 8480 datë 27.5.1999 nëPër funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LSHS.
Efekti:	Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Administrativ, duke cenuar sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe moszbatim të kuadrit ligjor rregullator në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa mbledhjen e menjëhershëm të Këshillit të Administrimit, si e vetmja strukturë vendimmarrëse

2.3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative

2.3.1. Hartimi i Projekt Buxhetit

Spitali Rajonal i Shkodrës ofron kujdesin mjekësor me anë të poliklinikës së specialiteteve, shërbimin e pranim-urgjencës, laboratorin klinik-biokimik dhe bakteriologjik dhe shërbimin me shtretër në specialitetet e veta. SRSH ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 9136, datë 17.07.2003 nëPër shërbimin spitalor në RSH, si dhe zhvillon veprimtarinë e tij financiare në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për institucionet me buxhet të pavarur. SRSH financohet nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet MSHMS dhe FSDKSH.

Projekt Buxheti i ndarë sipas zërave buxhetor është hartuar nga strukturat përgjegjëse të SRSH, në zbatim të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe i shoqëruar me evidencën dokumentare përkatëse.

Projekt buxheti për vitin 2018

Spitali Rajonal Shkodër nëpërmjet shkresës nr.1608 prot, datë 06.07.2017 nëMbi projekt buxhetin për vitin 2018 ka përcjellë në MSHMS projekt buxhetin për vitin 2018.

Projekt buxheti i vitit 2018 është hartuar nga strukturat përgjegjëse të SRSH, në përputhje me ligjin 9936 datë 26.06.2008 nëPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH si dhe udhëzimeve përkatëse të MF për hartimin e PBA 2018-2020. Llogaritja e fondit të pagave (llog.600) për vitin 2018 është bazuar në VKM-të përkatëse për pagat.

Për vitin 2018 nr. i punonjësve është parashikuar në përputhje me strukturën e miratuar nga MSHMS nr. 1306/1 datë 08.03.2017. Shpenzimet buxhetore për zërat 600, 601, 602, 606,

230, 231 janë planifikuar në shumën **1,115,312 mijë lekë**. Vlerat respektive të këtyre llogarive paraqiten në aneksin nr.3 tabela nr. 1

Projekt buxheti për vitin 2019

Spitali Rajonal Shkodër nëpërmjet shkresës nr.2268 prot., datë 20.06.2018 ka përcjell në MSHMS planifikimin buxhetor për vitin 2019.

Projekt buxheti i vitit 2019 është hartuar në përputhje me ligjin 9936 datë 26.06.2008 nëpër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH si dhe udhëzimeve përkatëse të MF për hartimin e PBA 2019-2021. Llogaritja e fondit të pagave (llog.600) për vitin 2019 është bazuar në VKM-në përkatëse për pagat.

Për vitin 2018 nr. i punonjësve është parashikuar në përputhje me strukturën e miratuar nga MSH nr. 1306/1 datë 08.03.2017. Shpenzimet buxhetore për zërat 600, 601, 602, 606, 230, 231 janë planifikuar në shumën **1,135,654 mijë lekë**. Vlerat respektive të këtyre llogarive paraqiten në aneksin nr.3 tabela nr. 2, bashkëlidhur Raportit përfundimtar

Projekt buxheti për vitin 2020

Spitali Rajonal Shkodër nëpërmjet shkresës nr.2334 prot, date 10.07.2019 ka përcjellë pranë FSDKSH planifikimin buxhetor për vitin 2020.

Projekt buxheti i vitit 2020 është hartuar në përputhje me ligjin 9936 datë 26.06.2008 nëpër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH si dhe udhëzimeve përkatëse të MF për hartimin e PBA 2019-2021. Llogaritja e fondit të pagave (llog.600) për vitin 2020 është bazuar në VKM përkatëse të pagave duke pasqyruar edhe ndryshimin e vjetërsisë në punë të punonjësve.

Shpenzimet buxhetore për zërat 600, 601, 602, 606, 230, 231 janë planifikuar në shumën **994,916 mijë lekë**. Vlerat respektive të këtyre llogarive paraqiten në aneksin nr.3 tabela nr. 3

2.3.2. Buxheti vjetor i alokuar:

Buxheti i miratuar për vitin 2018 për Spitalin e Shkodrës ka qenë në shumën 736,610,000 lekë i financuar nga FSDKSH mbi bazën e VKM nr. 17 datë 12.01.2018.

Në mënyrë të përmbledhur Buxheti për vitin 2018 i ndarë sipas zërave buxhetor 600, 601, 602 paraqitet në aneksin nr. 3 tabela nr. 4

Buxheti i miratuar për vitin 2019 për SRSH ka qenë në shumën 758,590,000 lekë i financuar nga FSDKSH mbi bazën e VKM nr.46, date 30.01.2019.

Në mënyrë të përmbledhur Buxheti për vitin 2019 i ndarë sipas zërave buxhetor 600, 601, 602 paraqitet në aneksin nr.3 tabela. 5

Buxheti i miratuar për vitin 2020 për SRSH ka qenë në shumën 830,602,500 lekë i financuar nga FSDKSH mbi bazën e VKM nr.260, datë 27.03.2020.

Në mënyrë të përmbledhur Buxheti për vitin 2020 i ndarë sipas zërave buxhetor 600, 601, 602 paraqitet në aneksin nr.3 tabelën nr. 6

Zbatimi i buxhetit vjetor

Nga verifikimi i situacioneve të shpenzimeve për vitet 2018/19/20, konstatohet se nuk ka tejkalim në realizimin e llogarive 600, 601 dhe 602.

Buxheti i viti 2018 është realizuar në masën 99%. Llogaria paga (llog. 600) është realizuar në masën 99%, llogaria 601 (sigurime) është realizuar në masën 97% si dhe llogaria shpenzime operative (602) është realizuar në masën 97%.

Buxheti i vitit 2019 është realizuar në masën 98%. Nga ku me 99% llogaria 600, 98% llogaria 601 dhe 97% llogaria 602.

Buxheti i vitit 2020 është realizuar në masën 100% për secilën llogari, përveç llog. 602 që është realizuar në masën 98%.

Nga krahasimi i tre viteve buxhetor, vihet re se buxheti i vitit 2020 është realizuar në shumën 825,313,613 lekë ose me 77,892,177 lekë më shumë se viti 2019 pra ka një rritje me 10% si pasojë e rritjes së shpenzimeve në llogarinë 600 dhe 602. Nga verifikimi i situacioneve të

shpenzimeve rezultojë se për llogarinë 600 janë rritur shpenzimet për zërin nështesë page si mjek rojë si dhe nështesë page për vjetërsi në punë si dhe shpërblim për stafin mjekësor dhe atë mbështetës të vijës së parë ndaj nëluftës kundër covid 19. Rritja e nevojës për mjek rojë dhe staf ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të pacientëve gjatë kësaj periudhe që korrespondojnë me pandeminë. Realizimi i buxhetit, sipas situacioneve progresive të miratuara në thesar për vitet 2018, 2019, 2020 paraqiten në mënyrë më të detajuar në *aneksin nr.3 tabela nr.7*.

Analiza e llogarisë 602 “mallra dhe shërbime të tjera”

Për vitin 2018: Për sa i përket shpenzimeve për zërin 602, mallra e shërbime të tjera, sipas situacioneve të shpenzimeve të miratuara nga thesari janë planifikuar 197,560,000 lekë dhe realizuar në shumën 192,323,716 lekë, sipas zërave kryesor:

“*Materiale dhe shërbime zyre*” përfshijnë shpenzimet e kancelarisë, pastrimit, dokumentacioni etj., ato kanë qenë të planifikuara në shumën 197,014 lekë dhe janë realizuar në shumën 197,014 lekë.

“*Materiale dhe Shërbime speciale*” përfshihen edhe shpenzimet për blerjen e barnave dhe materialet të mjekimit të cilat përbëjnë 90.94 % të shpenzimeve totale. Ato kanë qenë të planifikuara në shumën 111,269,777 lekë dhe janë realizuar në shumën 110,518,972 lekë. Ndërkohë edhe shpenzimet për furnizime dhe shërbime me ushqime për mensat, kanë zënë 9.056% të shpenzimeve totale për këtë zë.

“*Shërbime nga të tretë*” përfshin shpenzimet elektrike, ujë, ngrohje, posta, shërbime telefonike etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në shumën 54,011,501 lekë dhe janë realizuar në shumën 54,009,549 lekë.

“*Shpenzime transporti*” përfshihen shpenzimet për karburant dhe vaj, pjesë këmbimi etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 7,256,912 lekë dhe janë realizuar 7,249,669 lekë.

“*Shpenzime udhëtimi*” janë planifikuar 197,936 lekë dhe janë realizuar 197,936 lekë.

“*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*” janë planifikuar 16,548,747 leke nga ku janë shpenzuar 16,236,710 lekë.

Për vitin 2019: Për sa i përket shpenzimeve për zërin 602, mallra e shërbime të tjera, sipas situacioneve të shpenzimeve të miratuara nga thesari, janë planifikuar gjithsej 199,460,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 192,971,748 lekë, sipas zërave kryesor:

“*Materiale dhe shërbime zyre*” janë realizuar vetëm nga të ardhurat dytësore, ku përfshihen të gjitha shpenzimet e kancelarisë, pastrimit, blerje dokumentacioni etj., në vlerën 2,782,301 lekë.

“*Materiale dhe Shërbime speciale*” ka peshën më të madhe të shpenzimeve, nga ku për nëbarna dhe materialet mjekësore janë në masën 91.98 % dhe Furnizime dhe shërbime me ushqime për mensat zënë 8.02 % të shpenzimeve për këtë kategori.

Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 104,317,589 lekë dhe janë realizuar 100,810,191 lekë.

“*Shërbime nga të tretë*” përfshin shpenzimet për energji elektrike, ujë, ngrohje, posta, shërbime telefonike etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 64,812,367 lekë dhe janë realizuar 64,004,305 lekë.

“*Shpenzime transporti*” përfshin shpenzime për karburant dhe vaj, pjesë këmbimi etj.

Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 8,336,603 lekë dhe janë realizuar 8,314,267 lekë.

“*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*” janë planifikuar 14,558,400 leke dhe janë shpenzuar 12,433,344 leke.

Për vitin 2020: Për sa i përket shpenzimeve për zërin 602, mallra e shërbime të tjera, sipas situacioneve të thesarit, janë planifikuar gjithsej 238,757,500 lekë dhe realizuar në shumën 233,626,876 lekë, sipas zërave kryesor:

“Materiale dhe shërbime zyre” përfshin të gjitha shpenzimet e kancelarisë, pastrimit, dokumentacioni etj., për të cilat janë planifikuar 4,209,000 lekë dhe janë realizuar në shumën prej 4,145,157lekë.

“Materiale dhe Shërbime speciale”. Peshën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për ñBarna dhe materialet mjekësore të cilat janë në masën 95.3 %. Shpenzimet për blerje uniforma dhe te tjera veshje speciale janë në masën 0.46 %. Furnizime dhe shërbime me ushqime për mensat zënë 4.07 % dhe te tjera materiale dhe shërbime speciale zënë 0.16 %. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 143,366,166 lekë dhe janë realizuar 142,875,446 lekë.

“Shërbime nga të tretë” përfshin shpenzimet elektrike, ujë, ngrohje, posta, shërbime telefonike etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 51,458,643 lekë dhe janë realizuar 51,458,643 lekë.

“Shpenzime transporti” përfshin shpenzime për karburant dhe vaj, pjesë këmbimi etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 8,785,511 lekë dhe janë realizuar 8,737,107 lekë.

“Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” janë planifikuar 18,776,820 lekë dhe janë shpenzuar 18,647,450 lekë.

2.3.3. Planifikimi për barna dhe materiale mjekimi

Spitali Rajonal Shkodër ka 478 shtretër, 14 shërbime shëndetësore dhe 718 punonjës të përbërë nga stafi mjekësor, ndihmës mjekësor dhe administrata. SRSR ka një shkallë të ulët shfrytëzimi shtrati prej 24.2% ose me një mesatare prej 116 pacientesh të shtruar.

Spitalet publike, në varësi të nevojave të shërbimeve mjekësore që ofrojnë, referuar edhe numrit të pacienteve si dhe buxhetit të alokuar, planifikojnë për dy vitet pasardhëse sasinë dhe llojin për medikamente dhe pajisje mjekësore, sipas listës së miratuar nga MSHMS, në të cilën është përcaktuar: principi aktiv, formë doza, etj.

Lista e nevojave për medikamente dhe materiale mjekimi hartohet sipas kërkesave të shefave të shërbimit dhe gjendjes së medikamenteve dhe materialeve të mjekimit që gjenden në magazinën e farmacisë së SRSR.

Planifikimi i saktë i nevojave për barna dhe materiale mjekimi është hapi i parë dhe i rëndësishëm për optimizmin e burimeve financiare kundrejt një liste të konsoliduar barnash dhe materiale mjekimi që plotësojnë realisht kërkesat e shërbimit spitalor, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj pacientit dhe në përmirësimin e treguesve të performancës³ së tyre.

Planifikimi i nevojave për barnave dhe materialeve të konsumit për përdorim spitalor bazohet:

- në listën e barnave të miratuar nga MSHMS;
- në konsumin e barnave të realizuar të paktën tre vitet e fundit;
- në nevojat për vitin pasardhës të paraqitura nga çdo shërbim pranë strukturave drejtuese të shërbimit spitalor,
- dhe nga buxheti financiar në dispozicion (i alokuar nga FDSKSH)

Strukturat përgjegjëse për hartimin e PBA, duhet të bëjnë planifikimin e nevojave për barna dhe materialeve mjekësore për shërbimet spitalore për një periudhë dy vjeçare.

³Disa tregues të performancës janë: shkalla e shfrytëzimit të shtratis (%) , ditë qëndrimi mesatar, xhiro shtrati, etj.

Më poshtë në tabelën nr.1 është paraqitur: kërkesa buxhetore për medikamente dhe materiale mjekimi; plani i miratuar nga FDSKSH; dhe realizimi i tyre.

Vlera faktike e realizimit të shpenzimeve për barna dhe materiale mjekimi është marrë nga kontratat e realizuara me SRSH.

Pra siç vërehet, kërkesa buxhetore për medikamente dhe materiale mjekimi nga SRSH është më e madhe se buxheti i alokuar nga FDSKSH. Kjo e fundit e financon SRSH mesatarisht në masën 52% të kërkesës së pasqyruar në PBA-të respektiv për vitet 2018/19/20

Tabela nr.1. Kërkesa buxhetore për medikamente dhe materiale mjekimi (mijë lekë)

Viti	PBA	Plan pas miratimit të FDSKSH	Fondi I miratuar FDSKSH VS PBA (%)	Fakti
2018	188,322	101,258	54%	100,509
2019	260,829	95,173	36%	92,732
2020	213,509	136,170	64%	136,168

Burimi: SRSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Pas miratimit dhe disbursimit të buxhetit vjetor nga FDSKSH, strukturat përgjegjëse të ngritura nga titullari i institucionit bëjnë një riplanifikim të listës së medikamenteve dhe materialeve mjekësore duke përcjell një listë të konsoliduar kërkesave për barna dhe materiale mjekimi tashmë mbi buxhetin e miratuar nga FDSKSH dhe çmimet referente të Ministria e Shëndetësisë.

Bazuar në nenin 15 pika 2 e kontratës “për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” ndërmjet drejtorisë rajonale të fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, parashikohet se Lista përfundimtare e kërkesave për barna dhe materiale mjekimi duhet të hartohet nga një komision i veçantë i ngritur nga drejtuesi i spitalit.

Nga auditimi i praktikës së SRSH për hartimin dhe miratimin e listës për barna dhe materiale mjekimi për vitet 2018, 2019, 2020 rezulton se:

-Drejtori i SRSH nëpërmjet shkresës nr. 2646 prot. datë 19.12.2017 në Planifikimi për medikamente dhe materiale mjekimi për vitin 2018 dhe i ka përcjell MSHMS listën përfundimtare të kërkesave për barna dhe materiale mjekimi, për vitin 2018

-Drejtori i SRSH nëpërmjet shkresës nr.4648 prot. date 20.12.2018 në Planifikimi përfundimtar të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit për vitin 2019-2020 dhe i ka përcjell MSHMS listën përfundimtare për barna dhe materiale mjekimi, për vitin 2019

-Drejtori i SRSH nëpërmjet shkresës nr.44 prot. date 09.01.2020 në Mbi rishikimin e nevojave për barna për vitet 2020 dhe 2021 dhe konfirmimin e planifikimit përfundimtar të tyre nga Spitali Rajonal Shkodër dhe i ka përcjell MSHMS listën përfundimtare të kërkesave për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2020

Ngritja e komisionit për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit

Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e listës për barna dhe materiale mjekimi për vitet 2018, 2019, 2020 rezulton se:

Për vitin 2018, drejtuesi i institucionit ka ngritur grupin e punës për hartimin e listës për medikamente dhe materiale mjekimi me urdhrin e brendshëm nr.121 date 08.11.2017 të përberë nga: Dh.U. kryetare, N.S. , K. K. , A. L. , N.L. , L. D. shef i kardiologjisë, B. B. ish shef shërbimi i neurologjisë, G. G. shef shërbimi i kirurgjisë, B. K. shef shërbimi anestezi reaminacion, G. N. shefe e shërbimit të pediatriisë, S. H. shef i shërbimit obs-gjinekologjisë, B. T. përgjegjëse e sallave të operacioneve, Xh. H. , E. H. , L. M. . Në përfundim grupi i punës ka përpiluar listën përfundimtare për barna dhe materiale mjekimi sipas nevojave të paraqitura nga shërbimet për vitin 2018.

Për vitin 2019, drejtuesi i institucionit ka ngritur grupin e punës për hartimin e listës për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2019-2020 me urdhrin e brendshëm nr. 207 date 07.12.2018 të përberë nga: N. S. Kryetare, B. T. , A. Sh. , V. B. , N.Gj. anëtarë kanë hartuar listën përfundimtare për medikamente dhe materiale mjekimi për vitin 2019

Për vitin 2020, drejtuesi i institucionit nuk ka ngritur komision të veçantë për hartimin dhe miratimin e listës për barna dhe materiale mjekimi. Titullari i institucionit i ka përcjell MSHMS listën përfundimtare për barna dhe materiale mjekimi, për vitin 2020-2021 me shkresat nr.44 prot., datë 09.01.2020 dhe nr.158 prot., datë 20.01.2020.

Titulli i gjetjes:	Lista e barnave dhe materiale mjekimi për vitin 2020 nuk është miratuar dhe hartuar nga komisioni <i>ñad hoc</i> ”.
Situata:	Bazuar në nenin 15 pika 2 e Kontratës /S me nr. 45/2 date 13.01.2020, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, për vitin 2020nuk ka ngritur komision <i>ñad hoc</i> për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit, i cili duhet të hartojë në bazë të kërkesave të shefave të shërbimit, listën vjetore të nevojave për barnave dhe materialeve të mjekimit për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit normal të shërbimeve spitalore deri në realizimin e procedurave të blerjes për vitin pasardhës. Lista e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit duhet të jetë e saktë dhe realiste për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e stokut të barnave të skaduara. Drejtori i SRSH Z. A. D. me shkresën nr.44 prot. date 09.01.2020 dhe nr.158 date 20.01.2020, ka përcjell në MSHMS listën me kërkesa për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2020-2021. Por kjo listë nuk është hartuar nga asnjë komision. Veprime këto në mospërputhje me Kontrata/S nr. 45/2 date 13.01.2020, neni 15 pika 2 të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020 ndërmjet FDSKSH dhe SRSH, ku përcaktohet se: <i>“Lista e barnave që propozohet për planifikim për blerje për vitin ushtrimor, miratohet fillimisht nga grupi teknik i ngritur “Ad hoc” nga drejtori i spitalit dhe më pas dërgohet për miratim në MSHMS”</i>
Kriteri:	Ligji 9106 date 17.07.2013 ñPër shërbimin Spitalor ne Republikën e Shqipërisë, Kontrata/S nr. 45/2 date 13.01.2020, neni 15, pika 2, të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020 ndërmjet FDSKSH dhe SRSH.
Ndikimi/Efekti:	Ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe premisë për të krijuara barna stok në magazinën e farmacisë së SRSH
Shkaku:	Mungesa e ngritjes së grupit të punës dhe koordinimit me kërkesat e shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi.
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	1.Drejtori i Spitalit të përcjell pranë MSHMS, listën e barnave dhe materialeve të mjekimit për vitin ushtrimor, vetëm pas miratimit paraprak nga grupi teknik i ngriturpër planifikimin e tyre. 2.SRSH të filloj hartimin e rregullores për shërbimin farmaceutik duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. D. , me detyrë Drejtor i SRSH (14.04.2019 në vazhdim)

Barna dhe materiale mjekimi të skaduara

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe nga të dhënat e marra nga sistemi informarik (SIIS) i farmacisë së SRSH, rezulton se deri në fund të periudhës së auditimit në magazinën e farmacisë gjendet një stok i konsiderueshëm medikamente dhe materiale mjekimi të skaduara, të cilat janë shkaktuara si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo eficient nga strukturat përgjegjëse të SRSH dhe kërkesave jo realiste të shefave të shërbimit.

Barnat dhe materialet e mjekimit të skaduar në SRSH i përkasin periudhës 2015-2020. Nga të dhënat e marra nëpërmjet programit informatik të farmacisë, më datë 23.02.2021 në magazinën e farmacisë së Spitalit gjenden të skaduara medikamente dhe materiale të mjekimit në vlerën totale 11,116,722 lekë. Lloji dhe vlera e barnave dhe materialeve të mjekimit të ndarë për grupin e medikamenteve, materialeve të mjekimit dhe hemodinamikës paraqiten në tabelën nr.8 në *aneksin nr.3*.

Titulli i gjetjes:	Barnat dhe materialet e mjekimit të skaduara
Situata:	Në periudhën përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 (brenda periudhës së auditimit) kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi për shkak të mos përdorimit të tyre, por dhe të planifikimit të gabuar dhe menaxhimit jo efektiv të medikamente dhe materiale mjekimi nga strukturat përgjegjëse pranë SRSH, si më poshtë: 1. Gjatë vitit 2018 në farmacinë e SRSH janë krijuar barna dhe materiale të skaduara në vlerë <u>4,952,140.30 lekë</u> 2. Gjatë vitit 2019 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi stok të skaduara në vlerë <u>5,747,180.76 lekë</u> 3. Gjatë vitit 2020 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerë <u>169,326.00 lekë</u>. 4. Përgjatë viteve 2015/16/17 të marra sëbashku janë krijuar barna dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerën <u>248,075.24 lekë</u>. 5. Në total në magazinën e farmacisë së Spitalit, gjenden të skaduar medikamente dhe materiale të mjekimit në vlerë <u>11,116,722 lekë</u>. <u>Konkluzion:</u>Gjatë vitit 2018 dhe 2019 është krijuar vlera më e madhe stokut të medikamenteve materialeve të mjekimit, të cilat kanë skaduar në farmacinë e Spitalit Rajonal të Shkodrës, si rezultat i kërkesave jo reale të shërbimeve dhe të planifikimit dhe menaxhimit jo eficient të tyre nga strukturat përgjegjëse të SRSH, duke shkaktuar një efekt negativ në buxhetin e SRSH. Si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë përgjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të Spitalit Rajonal Shkodër barna dhe materiale mjekimi në vlerën totale 11,116,722 leke. Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse. Grupi i punës për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura

nga shefat e shërbimit pa analizuar gjendjen në magazinën e farmacisë dhe të qarkullimit të tyre në dy vitet e fundit.

Veprime këto në mospërputhje me ligjin nr. 9106 datë 17.07.2013 nëpër shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 nëpër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzim e MF nr. 30, datë 27.12.2011 nëpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe kontratat për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin ndërmjet FDSKSH dhe SRSH, për vitet 2018/19/20/21, respektivisht me nr. 181 prot. datë 21.01.2020, nr. 653 prot. datë 20.02.2019, nr. 100 prot. datë 13.01.2021.

Për sa më lart, gjatë planifikimit të nevojave për barna dhe materiale mjekimi në SRSH për vitet 2018/19/20 vërehet që ky proces zhvillohet si një procedurë rutine pa reflektuar dhe analizuar tregues të rëndësishëm, si; konsumin mesatar vjetor, mujor apo priorizimin e listës duke e pasuruar atë në bazë të analizave statistikore për trendet e ndjekura të konsumit të barnave ndër vite.

Pasi duhet të theksohet se planifikimi është hapi më i rëndësishëm për optimizuar burimet financiare kundrejt hartimit të një liste të konsoliduar barnash dhe materiale mjekimi që të shërbej dhe të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj pacientit dhe në përmirësimin e treguesve të performancës⁴ së tyre.

Në menaxhimin e barnave dhe materialeve të mjekimit një rol shumë të rëndësishëm ka edhe shërbimi farmaceutik, i cili funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të SRSH. Mungesa e koordinimit të grupit të punës me shefat e shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre, ka patur ndikim në reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve mjekësore të SRSH. Grupi i punës për hartimin e nevojave për barna dhe materiale mjekimi është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura prej shefave të shërbimeve pa i analizuar dhe konsultuar me ta.

Nga analizimi i evidencës dokumentare të vendosur në dispozicion për periudhën në auditim, konstatohet se nga drejtuesit e institucionit nuk janë marrë masat e nevojshme për mos krijimin e stokut të barna dhe materiale të skaduara, veprime në mospërputhje me rregulloren e spitalit dhe kontratën Spitalore me FSDKSH.

Gjithashtu mungesa e kontratës me shefat e shërbimeve të emëruar nga titullari I institucionit ka bërë që sasia e barnave të skaduara në shërbimet që ata drejtojnë, evidentohet vetëm si fakt por jo të ngarkoj me përgjegjësi shkaktarët që i kanë krijuar. Në mungesë të protokolleve mjekësore dhe praktikave të mira të miratuara, shefat e shërbimeve shpeshherë paraqesin kërkesa të ndryshme për barna për të njëjtën diagnozë.

Në magazinën e farmacisë së SRSH deri në fund të periudhës së auditimit, gjendet një sasinë me medikamente dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerën totale 11,116,722 leke, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ

⁴ Disa tregues të performancës janë: shkalla e shfrytëzimit të shtratis (%) , ditë qëndrimi mesatar, xhiro shtrati, etj.

	<i>për buxhetin e shtetit.</i>
Kriteri:	Ligji 9106 17.07.2013 nëPër shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010 nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 nëpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe kontratat për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin ndërmjet FDSKSH dhe SRSB, për vitet 2018/19/20/21, respektivisht me nr. 181 prot. datë 21.01.2020, nr.653 prot. datë 20.02.2019, nr. 100 prot. datë 13.01.2021.
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në shumën 11,116,722 lekë
Shkaku:	Planifikimi jo i drejtë nga shefat e shërbimeve dhe mungesa e kontrollit nga drejtuesit e spitalit për qarkullimin e barnave dhe sinjalizimi nga drejtuesi i farmacistë për barnat në prag të skadencës
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	1. Drejtoria e SRSB të analizojë shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar dhe të nxjerrëpërgjegjësitëpër stokun në vlerën 11,116,722 lekë, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SRSB duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen. 2. Drejtori i SRSB të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduar të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozoj masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V.M., me detyrë ish Drejtor i SRSB(05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , me detyrë ish nëpunës i autorizuar i deleguar i SRSB (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A. D. , me detyrë Drejtor i SRSB (14.04.2019 në vazhdim)

2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Për auditimin e kësaj pika u audituan :

- Pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019 të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës.
- Situacionet e thesarit mujore dhe progresive të vitit 2018, 2019 dhe 2020 të rakorduara me buxhetin e miratuar vjetor.
- Listëpagesat dhe listëprezencat e punonjësve të Spitalit për vitin 2018,2019 dhe 2020
- Dokumentacione plotësuese

Spitali Rajonal Shkodër është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit të Shërbimit Shëndetësor, ligjit të Shërbimit Spitalor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjit të Shëndetit Mendor.

Rregullorja e brendshme e Spitalit Rajonal Shkodër me nr.882 prot, datë 19.09.2011 është miratuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal ku jepet përshkrimi i detyrave dhe kompetencave për çdo pozicion pune të përcaktuar në strukturë për atë periudhë, gjithsesi nuk përputhet dhe ka mangësi për pozicionet e punës për periudhën e auditimit.

Struktura e planifikuar e Spitalit Rajonal Shkodër për vitin 2018 është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë datë 08.03.2017 me nr. 1306 Prot dhe përmban 718 persona të punësuar. Më

pas me vendimin e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1704/1 prot,datë 18.04.2018 struktura e Spitalit Rajonal Shkodër u ndryshua ku nr. i personave të punësuar mbeti i njëjtë me 718 të punësuar por janë bërë disa ndryshime në strukturën e disa reparteve të caktuar të Spitalit. Më pas me vendimin e Zëvendës Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1587/1 prot,datë 26.03.2019 struktura e Spitalit Rajonal Shkodër u ndryshua ku nr. i personave të punësuar mbeti i njëjtë me 718 të punësuar por janë bërë disa ndryshime në strukturën e disa reparteve të caktuar të Spitalit Struktura është e ndarë si më poshtë:

	2018	2019	2020
Janar	700	693	703
Shkurt	702	695	705
Mars	702	699	708
Prill	700	698	706
Maj	703	704	706
Qershor	701	709	705
Korrik	699	710	705
Gusht	698	707	707
Shtator	693	705	705
Tetor	696	708	693
Nëntor	697	710	694
Dhjetor	697	704	701

Nga auditimi i strukturës organizative është konstatuar se numri i miratuar i punonjësve nuk është tejkaluar . Lidhur me Shërbimin Spitalor të SRSH në pjesën më të madhe të reparteve të shërbimit spitalor ka mangësi personeli në pozicionin e mjekut dhe kjo është zëvendësuar me rritjen e numrit të infermierëve dhe laborantëve duke bërë kështu që të devijohet nga struktura e miratuar nga MSH. Mungesa e mjekëve specialist në reparte të rëndësishme mund të shkaktojë probleme të rënda në mbarëvajtjen e këtij shërbimi. Devijimi nga struktura nuk është bërë me miratim nga Ministria e linjës por vetëm me urdhër të titullarëve.

Për emërimet e reja janë krijuar komisionet e vlerësimit me urdhëratë e brendshëm me përbërjen si më poshtë, të pasqyruar në aneksin nr.4 tabela nr.1

Të dhënat e përmbledhura për shpenzimet e pagave paraqiten në aneksin nr.4 tabela nr.2.

Në mbështetje të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.207 datë 10.3.2020 nëpërmjet shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë, për vitin 2020-31 janar 2021 duke u bazuar te lista emërore e punonjësve të cilët kanë punuar gjatë periudhës së pandemisë, punonjësit e Spitalit Rajonal Shkodër kanë marrë në total vlerën prej 44,911,456 lekë si shpërblim.

Lidhur me auditimin e listëpagesave në llogaritjen e pagave është respektuar VKM nr.1035 datë 27.11.2013 për disa shtesa e ndryshime në VKM nr.555 datë 11.08.2011 Për miratimin e strukturës dhe pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermierisë së Sistemit të MSH, VKM nr.690 datë 09.10.2012 nëpërmjet disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.717 datë 23.06.2009 nëpërmjet pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore, I ndryshuar, ligji nr.7703 datë 11.05.1993 nëpërmjet sigurimet Shoqërore, I ndryshuar dhe ligji nr.8438 datë 28.12.1998 nëpërmjet tatimit mbi të ardhurat I ndryshuar. Lidhur me dokumentacionin justifikues janë plotësuar gjithë listë prezencat mujore dhe listë pagesat janë firmosur nga specialistja e pagave, specialistja e burimeve njerëzore , shefja e financës dhe drejtori I institucionit. Gjithashtu në çdo listëpagesë janë evidentuar bashkëlidhur urdhrat e titullarit lidhur me rekrutimet e reja ose shkëputjet e marrëdhënieve financiare (për listë pagesat e vitit 2018 grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë e tyre dhe hartimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor, pasi ato nuk disponoheshin fizikisht nga ana e Spitalit

Rajonal Shkodër, pasi janë sekuestruar nga Krimi Ekonomik dhe ende nuk i janë kthyer administratës së Spitalit).

Nga intervistimi i punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër ku përfshihet dhe Drejtori i Spitalit, u konstatua një problematik mbi dypunësimin e disa punonjësve të Spitalit (Mjek të urgjencës, mjek të përgjithshëm) të cilët gjatë orarit të punës kryenin vizita ndaj pacientëve të cilët janë të shtruar në ambientet e Hemodializës në D.V. Sh.p.k. Pas intervistimit të këtyre mjekëve, ato pranuan para grupit të auditimit që kishin lidhur kontratë dhe me shoqërinë private të hemodializës në D.V. Sh.p.k kundrejt pagesës. Megjithë pretendimet e tyre për një kontratë part time (e cila nuk na u vu në dispozicion) dhe e cila është e pavlefshme në momentin që Titullari i Institucionit nuk është zyrtarisht në dijeni për shërbimet që këto mjek bëjnë në ambientet e kësaj shoqërie private si edhe pasi orari zyrtar i vizitave dhe konsultave në ambientet e Hemodializës është nga ora 07:00-16:00.

Nga vetë deklaratat e këtyre punonjësve rezulton se gjatë orarit zyrtar , për të cilin kanë lidhur dhe kontratën individuale me Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër, ata kryejnë shërbime të ndryshme dhe paguhen dhe nga shoqëria private në D.V. Sh.p.k, veprim ky në kundërshtim me nenin nr.110 dhe nr.119 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Grupi i auditimit nuk mund të shprehet për shkeljet në vlera , pasi nuk na u vu në dispozicion kontrata e këtyre mjekëve me shoqërinë në D.V. Sh.p.k si dhe nuk mund të japim opinion nëse kanë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për pagën që përfitojnë nga në D.V. Sh.p.k.

Largimet nga puna.

Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj.

Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste , ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**. Vendimet gjyqësore për 2 punonjësit të cilët kanë paditur Spitalin Rajonal Shkodër janë si më poshtë :

Emri i punonjësit	Pozicioni	Viti i largimit	Vendimi i gjykatës	Nr. i pagave të fituara	Likuidimi
A.M.	Sp/finance	2018	Nr.411,date 17.06.2019	16	818,474 leke
A.O.	Kuzhinier	2018	Nr.454,date03.07.2019	29.5	1,480,718 leke

Vlera prej **2,299,192 lekë përbën efekt negativ financiar** për buxhetin e Spitalit Rajonal Shkodër. Ky efekt negativ ka ardhur si rrjedhojë e largimit të këtyre punonjësve në shkelje të kuadrit ligjor nga ana e ish Administratorit të Spitalit Rajonal Shkodër z.V.M. i cili ngarkohet me përgjegjësinë për këtë veprim.

Në lidhje me dosjet e personelit, u kërkuan me zgjedhje 40 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua mungesa e dokumentacionit duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, nëPër kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publikò. Emërimet dhe largimet e punonjësve në SRGJ janë në mospërputhje me Urdhrin Nr.506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë nëPër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera

të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore pika 1 dhe 2. Më konkretisht në tabelën e më poshtme rezultatet e dosjeve:

Nr.	Emri	Pozicioni	Problematika e dokumentacionit
1	K. C.	Infermiere, Reanimacion	Kërkesa për punësim e pafirmosur nga e interesuara, si dhe shpallja e vendit vakant nga ana e Spitalit.
2	B. M.	Infermiere, Pediatri	Kërkesa për punësim e pafirmosur nga e interesuara, si dhe shpallja e vendit vakant nga ana e Spitalit.
3	I. C.	Mjeko sp/ORL.	Mungon lista e noterizuar e notave të shkollës së lartë.
4	E. K.	Sp/ e lartë në shërbimin e mjedisit	Mungon dëshmia e penalitetit.
5	R. M.	Mjeko e Përgjithshme	Mungon Certifikata familjare, raporti mjeko ligjor i aftësisë për punë, dëshmia e penalitetit, Specializimet (fotokopje e pa noterizuar) si edhe detyrat dhe përgjegjësitë themelore të pozicionit të punës.
6	E. V.	Sp/auditi	Mungon dokumentacioni mbi arsimimin për shkollën e mesme, gjithashtu mungon dokumentacioni për masterin shkencor, lista e notave të shkollës së lartë, kontrata individuale e punës.

Titulli i gjetjes:	Dypunësimi i disa punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër
Situata:	Nga intervistimi i punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër ku përfshihet dhe Drejtori i Spitalit, u konstatua një problematikë mbi dypunësimin e disa punonjësve të Spitalit (Mjek të urgjencës, mjek të përgjithshëm) të cilët gjatë orarit të punës kryenin vizita ndaj pacientëve të cilët janë të shtruar në ambientet e Hemodializës në D.V. të Sh.p.k. Pas intervistimit të këtyre mjekëve, ato pranuan para grupit të auditimit që kishin lidhur kontratë dhe me shoqërinë private të hemodializës në D.V. të Sh.p.k kundrejt pagesës. Megjithatë pretendimet e tyre për një kontratë part time (e cila nuk na u vu në dispozicion) dhe e cila është e pavlefshme në momentin që Titullari i Institucionit nuk është zyrtarisht në dijeni për shërbimet që këto mjek bëjnë në ambientet e kësaj shoqërie private si edhe pasi orari zyrtar i vizitave dhe konsultave në ambientet e Hemodializës është nga ora 07:00-16:00. Nga vetë deklaratat e këtyre punonjësve rezulton se gjatë orarit zyrtar, për të cilin kanë lidhur dhe kontratën individuale me Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër, ata kryejnë shërbime të ndryshme dhe paguhen dhe nga shoqëria private në D.V. të sh.p.k.
Kriteri:	Neni nr.110 dhe nr.119 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Pagesë e dyfishtë të disa punonjësve gjatë kryerjes së detyrës në orarin zyrtar të punës.
Shkaku:	Mos respektimi i detyrimeve ligjore të firmosura në kontratë dhe të përshkruara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marri masa duke analizuar këtë situatë me qëllim shmangien e këtij fenomeni në të ardhmen.

Titulli i gjetjes:	Detyrime të krijuara nga largimet nga detyra e punonjësve.
---------------------------	--

Situata:	Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj.) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj. Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste , ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej 2,299,192 lekë.
Kriteri:	Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i detyrimeve financiare për Spitalin Rajonal Shkodër në shumën 2,299,192 lekë.
Shkaku:	Mos respektimi i procedurave të caktuara në Kodin e Punës për largimin nga puna të punonjësve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Drejtoria e Spitalit Shkodër, të marri masa që në të ardhmen në rastin e vendimit për largimin nga detyra të ndonjë punonjësi , të ndiqen në mënyrë rigoroze të gjitha procedurat e përshkruara qartë në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e dokumentacionit në dosjet e punonjësve.
Situata:	Në lidhje me dosjet e personelit, u audituan me zgjedhje 40 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua mungesa e dokumentacionit në 6 raste.
Kriteri:	Urdhrit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, nëPër kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publikò, Urdhrin Nr.506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë nëPër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësoreò pika 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Marrja në punë jo në përputhje me kuadrin ligjor.
Shkaku:	Mos respektimi i procedurave të caktuara për punësimin dhe emërimin e punonjësve sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	Drejtoria e Spitalit Shkodër, të analizoj këtë situatë ku janë punësuar punonjës në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe të nxjerri përgjegjësitë për mungesën e dokumentacionit të konstatuar nga grupi i auditimit për këto punonjës në dosjet e tyre personale.

2.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit për vitin 2018.

Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë hartuar konform Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë në Mbi përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe janë miratuar me nr. 765 Prot. datë 28.02.2019 nga dega e thesarit Shkodër.

Më poshtë dhe në vijim paraqiten të dhëna dhe analiza e llogarive të ndryshme të pasqyrave financiare të vitit 2018 të pasqyruara në aneksin nr. 5.

2.5.1. Pozicioni financiar - Aktivet:

Gjendja në fund të vitit 2017 për Aktivet ka qene në vlerë 1,324,113,632 dhe në fund të vitit 2018 në vlerë 1,530,800,794 lekë. Pasqyruar sipas llogarive respektive në tabelën nr.1 të aneksit nr.5.

Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2018, rezulton që aktivet e qëndrueshme të paraqitura në aktiv të bilancit janë në vlerën 1,265,933,385 lekë. Në mënyrë të detajuar ato paraqiten, sa më poshtë vijon:

Tabela nr.2. Gjendja e aktiveve të qëndrueshme të SRSH në fund të vitit 2018

Llog .	Gjendja me 31.12.2017	Shtesa gjate vitit 2018	Pakësim amortizimi vjetor 2018	Pakësim Kalim kapital 2018	Gjendja me 31.12.2018
210	22,786,720	0	0	0	22,786,720
212	686,720,458	263,232	34,349,185		652,634,505
214	470,384,179	32,658,844	25,026,151	2,520,000	475,496,872
215	2,064,303	1,000,000	612,861		2,451,442
218	141,521,971	443,640	29,401,765		112,563,846
	1,323,477,631	34,365,716	89,389,962	2520000	1,265,933,385

Burimi: SRSH, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës financiare të vitit 2018, rezulton se në llog. 212 nëNdërtime dhe konstruksione, gjatë vitit 2018 ka pasur shtesa në vlerë 263,232 lekë, që korrespondon me bërjen e hidroizolimit të kuzhinës së SRSH, njëkohësisht kjo llogari ka pësuar pakësim në vlerë 34,349,185 leke për shkak të përlllogaritjes së vlerës së amortizimit vjetor.

Në fund të vitit 2018 gjendja e llogarisë 212 nëNdërtime dhe konstruksione rezulton në vlerën 652,634,505 lekë. Llog. 214 nëInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune gjatë vitit 2018 ka pasur shtesë në vlerë 32,568,844 lekë, nga këto 28,630,094 lekë janë pajisje mjekësore të blera nga MSHMS dhe 146,190 lekë donacione, ndërsa vlera 3,882,560 lekë janë blerje nga të ardhurat dytësore dhe është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor me 25,026,151 lekë edhe si rezultat i kalimit kapital të një pajisje mjekësore të SUSN me vlerën 2,520,000 lekë.

Në fund të vitit 2018 gjendja e llogarisë 214 është 475,496,872 lekë.

Llog. 215 nëMjete transporti gjatë vitit 2018, ka pasur shtesë në vlerë 1,000,000 lekë si rezultat i dhurimit të një autoambulance dhe pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor 612,861 lekë.

Në fund të vitit 2018 gjendja e llogarisë 215 është 2,451,442 lekë.

Llogaria 218 nëInventari ekonomik gjatë vitit 2018 ka pasur shtesë në vlerë 443,640 leke dhe ka të bëjë me blerjen e Lap Top nga të ardhurat dytësore dhe është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor 29,401,765 lekë.

Në fund të vitit 2018 gjendja e llogarisë 218 është 112,563,846 lekë.

Nga auditimi konstatohet se llogaritja e normave vjetore të amortizimit të aktiveve të qëndrueshme është bërë sipas përcaktimeve të udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018, në procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në postin "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" llogaria 231 pasqyron investimet në proces në shumën 636,000 lekë të 1(një) fature për investime nga viti 2011. Sipas SRSH, kjo është fatura e fundit e kontratës së regjistruar në degën e thesarit, pasi kjo procedurë ka qenë në proces gjyqësor. Më poshtë paraqiten aktivet në fund të vitit 2018

Tabela nr.3. Totali i aktiveve të SRSH në fund të vitit 2018

TOTAL I AKTIVEVE	Gjendje më 31.12.2018
Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	39,569,763
Gjendje Inventari qarkullues	133,549,049
Llogari te Arkëtushme	53,870,520
Aktivet Afat gjata	1,265,933,385
Për Aktive Afatgjata materiale ne proces	636,000
Te tjera aktive afatshkurtra	37,242,076
Totali	1,530,800,794

Burimi: SRSH, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Në fund të vitit 2018, mjetet monetare dhe ekuivalent të tyre, kanë qenë në vlerën 39,569,763 (llog.520 i disponibilitet në thesar). Në këtë llogari gjenden të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës në vlerën 36,537,980 leke dhe kreditor për mjete në ruajtje (466) në vlerën 3,031,783 lekë.

Aktivet Qarkulluese

Aktivet qarkulluese në bilancin e vitit 2018, paraqiten në vlerën 133,549,049 lekë, nga të cilat llogaritë e klasës 3 (tre) në Gjendje e inventarit janë në vlerën 20,211,308 lekë, ndërsa llogaritë e klasës 4 në Kërkesa arkëtimi mbi debitorët janë në vlerën 3,487,621 leke. Disponibiliteti në thesar është 39,569,763 lekë.

Evidenca analitike dhe dinamika e llogarisë në Gjendje inventari për vitin 2018, paraqitet në mënyrë analitike në tabelën nr.2 të aneksit nr.5

Tek llogaria 327 (inventari) ka pasur shtesa si pasojë e hyrjeve në vlerën 520,603 lekë të materialeve të imta. Si rezultat i asgjësimit të materialeve të imëta të inventarit në këtë llogari ka pësuar pakësim në vlerën 2,324,417 lekë dhe gjendja në fund të vitit 2018 është 20,211,308 lekë, paraqiten në mënyrë analitike në tabelën nr.3 të aneksit nr.5

Evidenca analitike dhe dinamika e llogarisë në Kërkesa arkëtimi mbi debitorët për vitin 2018, paraqitet në tabelën e mëposhtme nr.4.

Tabela nr.4. Kërkesa arkëtimi mbi debitorët për vitin 2018

Nr.	Nr. llog	Emri i llogarisë.	Gjendjeje me 31.12.2018	Gjendjeje me 31.12.2017
1	411-418	Klientë e llogari të ngjashme	189,296	189,296
2	423-429	Personeli, paradh.deficite e gjoba	3,487,621	3,494,127
2	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	50,178,987	51,518,616
3	468	Debitorë të ndryshëm	14,616	14,616
4	486	Shpenz. te periudhave te ardhshme	37,242,076	45,119,947
Totali			91,112,596	100,336,602

Burimi: SRSH, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Shumat 189,296 lekë (Klientë e llogari të ngjashme) dhe 14,616 leke (debitorë të ndryshëm) është e mbartur në bilanc para vitit 2013 pa asnjë shpjegim.

Shuma prej 3,487,621 lekë pasqyrojnë vlerën e debitorëve të lënë nga rekomandimet e grupeve të auditimit të kryer nga DRSKSH në vitin 2013 dhe MSHMS në vitin 2014.

Shuma 3,538 leke është krijuar gjatë vitit 2018 dhe është likuiduar në muajin Janar 2019.

Të dhënat analitike mbi këta debitor janë pasqyruar në tabelën nr.4 ë aneksit nr.5.

Shuma 50,178,987 lekë (operacione me shtetin-të drejta) përfaqësojnë detyrimet e muajit dhjetor 2018 për paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, tatime, energji, ujë etj.

Shuma 45,119,947 lekë tek llog.486 ñShpenzimet të periudhave të ardhshme (detyrime të prapambetura) pasqyrojnë detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2017.

Gjatë vitit 2018 nga ana SRSJ janë likuiduar 7,877,870 lekë ndaj UKSH dhe për pasoj është zvogëluar vlera e detyrimeve të prapambetura dhe për rrjedhim në fund të vitit 2018 vlera e detyrimeve të prapambetura shkon në shumën 37,242,077 lekë. Ky detyrim përbehet nga 12,927,312 leke detyrime të prapambetura ndaj subjekteve farmaceutik (të krijuara përgjatë vitit 2005-2011), për shkak të mos likuidimit të këtyre subjekteve për mungese paraqitje dokumentacioni të rregullt gjate dorëzimit të medikamente apo materiale mjekësore. Ndërsa pjesa tjetër e detyrimeve prej 24,314,765 lekë përfaqëson detyrimet e prapambetura ndaj ujësjellësit kanalizimeve në fund të vitit 2018.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e arkëtimit të shumës 3,487,621 lekë nga debitorët
Situata:	Deri në fund të vitit 2018 është akumuluar një debi nga punonjës ose ish punonjës së SRSJ, si detyrim ndaj institucionit në shumën që kap vlerën në fund të vitit 2018 me 3,487,621 lekë. Ky detyrim është konstatuar nga kontrollet e auditimit të ushtruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor Shkodër. Në lidhje me këto detyrime SRSJ nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve të punonjësve ndaj SRSJ. Institucioni u ka dërguar personave debitorë urdhër për arkëtim por nuk e ka vazhduar më tej me ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre. Gjithashtu nga drejtuesi aktual i SRSJ dhe titullarët e mëparshëm, nuk janë marrë masa për arkëtimin e këtij detyrimi. Përpos urdhrave të hartuar, institucioni nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar në mospërputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011, Pika IV ñSistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, shuma prej 3,487,621 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.
Kriteri:	Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, Pika IV ñSistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve
Ndikimi/Efekti:	Mungesë e arkëtimit të vlerës 3,487,621 lekë nga debitor të ndryshëm të SRSJ
Shkaku:	Nga Drejtuesi aktual dhe titullarët sipas secilës periudhë përkatëse nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës së debisë.
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, Sektori Juridik, të marrin masa, të analizojnë situatën e debitorëve dhe të ndjeke te gjitha hapat administrative dhe ligjor për arkëtimin e shumës 3,487,621 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Pozicioni financiar-Pasivet

Vlera prej 1,434,047,463 lekë në pasiv të bilancit shpreh vlerën e llogarisë në Fonde të veta për 17,457,487 lekë rezultatin e mbartur dhe 4,731,388 lekë rezultatin e ushtrimit (saldo kreditore) dhe teprica (fondi i akumuluar) me 1,411,858,588 lekë. Në total pasivët janë në shumën 1,530,800,794 lekë.

Të dhëna për totalin e pasivit janë pasqyruar në tabelën nr. 6 ë aneksit nr.5

Pasivet afatshkurtra paraqiten në pasiv të bilancit në vlerë 96,753,331 lekë, në këtë llogari paraqiten detyrimet për paga ,sigurime shoqërore, shëndetësore, tatimi detyrimet për energji, ujë, postë, telefon të muajit dhjetor 2018 të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2019, dhe detyrimet e prapambetura etj.

Pasqyra e shpenzimeve të ushtrimit - formati nr.3/1

Shpenzimet totale për vitin ushtrimor 2018, sipas pasqyrës së shpenzimeve në bilancin përfundimtar, janë në shumën 755,242,563 lekë.

Në totalin e shpenzimeve; shpenzimet për personelin, paga dhe sigurime shoqërore janë në vlerën 540,621,271 lekë, shpenzimet operative 213,844,812 lekë, ndryshimi i gjendjes të inventarit në shumën 12,376,152 lekë dhe ndihmat në vlerën 776,480 lekë. Të dhënat më të detajuara janë pasqyruara në tabelën nr.6 të aneksit nr.5

Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet - formati nr. 4

Në këtë format janë pasqyruar investimet e kryera për vitin 2018, sipas llojit të burimeve:

1. Grande të huaja kapitale	1,000,000 lekë
2. Grande të brendshme kapitale	28,776,284 lekë
3. Fonde të tjera të veta(a. të veta)	4,589,432 lekë
Totali	34,365,716 lekë

Gjendja dhe ndryshimet A.Q.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit të aktiveve qarkulluese është në shumën prej 12,376,152 lekë . Llogaria 327 “inventari i imët” gjatë vitit 2018 është shtuar me 520,603 lekë nga të cilat 483,204 lekë janë inventar i imët i sjellë nga QKUM. Diferenca prej 37,399 lekë përfaqëson vlerën e uniformave të blera për personelin shëndetësor nga të ardhurat dytësore. Llogaria 327 rezulton se është pakësuar me 2,324,417 lekë, si rezultat i asgjësimit të materialeve të ndryshme pjesë e këtij inventari. Në fund të vitit 2018 gjendja e nëllogarisë 327 është 20,211,308 lekë dhe llogaria 311 nëmateriale është shtuar në vlerë 136,449,510 lekë nga hyrjet dhe është pakësuar nga daljet në vlerë 147,021,848 lekë. Në fund të vitit 2018 gjendja e llogarisë nëmateriale është 113,337,740 lekë

2.5.2. Inventarizimi i aktiveve

Në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 në Përmendimin Financiar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në përmendimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ku parashikohet se:

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale.

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezultoi që: *Gjatë vitit 2018 janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale në vlerë 2,324,417 lekë (llog. 327) dhe 1,849,436 leke (llog.218), në total janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi materiale në vlerën 4,173,853.*

Me Urdhrin e brendshëm nr. 227 me dt. 31.12.2018 "Për çregjistrimin në kontabilitet të aktiveve të asgjësuar nga grupi i asgjësimit sipas PV nr. 4772 prot dt.31.12.2018", janë asgjësuar aktive në vlerën 2,324,417 lekë (llog.327) dhe 1,055,383 leke (llog.218)

Titulli i gjetjes:	Mos respektimi i afateve kohore për inventarizimin periodik vjetor
Situata:	Për inventarizimin e aktive për vitin 2018, është ngritur komisioni i inventarizimit me Urdhrin e Brendshëm nr. 09, date 16.01.2019 (nr154 prot. date 16.01.2019). Në cilësinë e nëpunëses autorizuese të deleguar znj. T. Rr. në Urdhrin e Brendshëm ka përcaktuar komisionet sipas shërbimeve e reparteve dhe komisionin qendror. Me Urdhër nr. 9/1 nr. prot 154/1 dt. 16.01.2019 është bërë një zëvendësim në komisionin nr.5 të inventarizimit duke zëvendësua Z. L. M. me Znj. S. K. Sipas UB, komisioni qendror përbehej nga; E. V. Kryetar (ekonomist), A. Gj. Anëtare (ekonomiste) dhe E. A. Anëtar(ekonomist). Për realizimin e inventarit të vitit 2018, përveç komisionit qendror ishin ngritur dhe 6 komisione të tjera të cilat duhej të bënin inventarin sipas reparteve të përcaktuara në UB nr. 09 datë 16.01.2019, në të cilin ishte parashikuar që: 1.Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit dhe dorëzimit të inventarëve pranë komisionit qendror nga komisionet për repartet dhe sektorët ishte data 01.02.2019. Brenda afatit ligjor të përcaktuar në Urdhrin e Brendshëm, kanë dorëzuar inventarët komisionet pranë komisionit qendror, si më poshtë: Komisioni nr. 1 dorëzuar inventarët me datë 01.02.2019 (Brenda afatit) Komisioni nr. 3 dorëzuar inventarët me datë 31.01.2019 (Brenda afatit) Komisioni nr. 4 dorëzuar inventarët me datë 01.02.2019 (Brenda afatit) Komisioni nr. 6 dorëzuar inventarët me datë 01.02.2019 (Brenda afatit) 2. Afati i dorëzimit të Relacioni përfundimtar të inventarizimit nga komisioni qendror pranë Drejtorisë së SRSH ka qenë data 08.02.2019. Me shkresën nr. 453 prot., datë 06.02.2019 komisioni qendror ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të inventarëve për komisionin nr.5, duke përcaktuar si afate të ri dorëzimin e inventarit, datën 12.02.2018. Për sa me lart, anëtarët e komisionit qendror për inventarizimin të ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 09 date 16.01.2019, ka marrë kompetencat e titullarit të institucionit, ku ky i fundit ka përcaktuar afatin e dorëzimit të inventarëve datën 01.02.2019 për të gjithë komisionet. Komisioni qendror i cili nuk është një organ epror që e njeh ligji, por ka vetëm atributet e organizimit dhe mirëmbajtjes së procesit të inventarizimit dhe ka detyrimin ligjore të respektoj afatet e

vendosura nga titullari i institucionit, ka marre një vendim të pa ligjshëm për shtyrjen e afatit të dorëzimit të inventarit për komisionit nr. 5 (pesë) në kundërshtim me Urdhërin e brendshëm nr. 09 date 16.01.2019

Për mos zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 09 date 16.01.2019 dhe tejkalim të kompetencave të anëtarëve të komisionit qendror, ngarkohen me përgjegjësi; Z. E. V. , Z. E. A. , Z. A. Gj. , ne cilësinë e anëtarëve të komisionit qendror për inventarizimin

Me Urdhërin e Brendshëm nr. 61 date 02.04.2019, anëtarja e komisionit qendror A.Gj. (për arsye të largimit nga puna) është zëvendësuar nga znj. A. I. .

Në kundërshtim me afatin e vendosur në Urdhërin e Brendshëm nr. 09 datë 16.01.2019, komisioni qendror ka dorëzuar relacionin pranë Drejtorisë së SRSH, më datë 30.04.2019 (shkresa nr. 1527 prot dt. 30.04.2019).

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit auditimit të KLSH, nuk ka asnjë argumentim, për vonesën e dërgimit të relacionit nga komisioni qendror mgjth-se komisionet i kanë dorëzuar ato në afat pranë komisionit qendror, konform përcaktimeve të Urdhrit të Brendshëm nr. 09 date 16.01.2019 dhe shkresës nr. 453 prot datë 06.02.2019 të Komisionit qendror.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Anëtarë të komisionit qendror; Z. E. V. , Z. E. A. , Z. A. Gj. . Në relacion e komisionit qendror cilësohet që; komisioni nr. 2 nuk ka përfunduar inventarizimin për shkak se anëtarja e komisionit M. K. ka qenë me raport mjekësor dhe gjate kësaj periudhe nuk është zëvendësuar me një anëtar tjetër dhe për këtë arsye, komisioni ka kërkuar titullarit të institucionit ngritjen e një komisioni të ri për inventarizimin në repartet poliklinikës, sanatoriumit, dispanserisë dhe laboratorit bakteriologjik. Mbi bazën e kërkesës, titullari i institucionit z. A. D. nëpërmjet urdhrit të brendshëm nr. 73 datë 07.05.2019, ka ngritur një komision të ri për kryerjen e inventarizimit për repartet poliklinikë, sanatorium, dispanseri, laborator bakteriologjik, me afat për përfundimin deri në datën 14.05.2019

Për sa më lart, znj. T. Rr. në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar për periudhën 03.07.2018 - 14.04.2019, ka vepruar në mospërputhje me rregulloren e spitalit, ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 nëpër menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: T. Rr. në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019)

Komisioni nr. 2 ka dorëzuar inventarët respektiv më date 14.05.2019 pranë komisionit qendror, ndërkohë komisioni qendror e ka dorëzuar relacionin për përfundimin e inventarizimit për repartet poliklinikë, sanatorium, dispanseri, laborator bakteriologjik më datën 14.05.2019 nëpërmjet shkresës nr. 1694/1 prot dt. 14.05.2019

Më pas nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative ka nxjerrë Urdhërin e Brendshëm nr. 114 date 08.07.2019 "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve të inventarit të imët dhe ekonomik të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi" me afat dorëzimi datën 15.07.2019.

	Në zbatim të këtij urdhri, komisioni i vlerësimit dorëzoi relacionin për përfundimin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi me nr. 2369 prot. më date 15.07.2019 (inventari i imët llog.327 dhe inventari ekonomik llog.218). Pas miratimit të relacionit Zv/Drejtori i shërbimeve administrative, nëpërmjet Urdhrit të brendshëm nr. 153 me date 27.08.2019 "Për asgjësimin e inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218)ò ka autorizuar asgjësimin e tyre, duke përjashtuar aktivet për skrap, te cilat do ti nënshtroheshin procedurës së ankandit. <i>Vlera e materialeve të asgjësuar sipas llog.218 është 2,947,407 leke dhe llog.327 në vlerën 1,606,206.</i> Nga evidenca dokumentare rezulton që, inventarët për vitin 2018 nuk kanë përfunduar brenda tremujorit të parë të vitit 2019 dhe si pasoj vlerat e materialeve të asgjësuar janë reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2019. <i>Materialet e vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi dhe shitjes së tyre nëpërmjet procedurës së ankandit, rezultojnë në vlerën 136,790 (llog.327) dhe 1,928,669 leke (llog. 218).</i> Nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është marrë asnjë masë disiplinore për strukturat e ngritura për mos realizimin e inventarizimit sipas afateve të vendosura nga vet drejtuesja e institucionit, për më tepër që nga ana e saj ka patur informacion për mos zbatim të UB nr. 09 date 16.01.2019, pasi me Urdhrin nr. 61 date 02.04.2019 ka bërë një ndryshim të një anëtarit të komisionit qendror të inventarizimit. Gjithashtu anëtarët e komisionit qendror që kanë patur detyrë të koordinojnë punën e 6 komisioneve, nuk kanë respektuar afatet e paraqitjes së relacionit përfundimtar për inventarizimin. Anëtarët e komisionit qendror për inventarizimin periodik të aktiveve për vitin 2018, nuk kanë zbatuar UB nr. 09 date 16.01.2019 dhe kanë tejkaluar kompetencat e përcaktuara në UB nr. 09 datë 16.01.2019 duke marrë kompetencat e titullarit të institucionit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të relacionit të inventarizimit për komisionin nr.5. Veprime këto në mospërputhje të Ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 nëpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò rregullores së Spitalit Rajonal Shkodër, Rregulloren e funksionimit Teknik (nr. 882 prot. Date 19.09.2011), Urdhrin e Brendshëm nr. 09 datë 16.01.2019 për inventarizimin periodik të aktiveve. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. E. V. , Z. E. A. , Znj. A. Gj. , në cilësinë e anëtarëve të komisionit qendror për inventarizimin për vitin 2018.
Kriteri:	Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Rregullorja e Spitalit Rajonal Shkodër, Rregullorja e funksionimit Teknik (nr. 882 prot. Date 19.09.2011), Urdhri i Brendshëm nr. 09 datë 16.01.2019 për inventarizimin periodik të aktiveve
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi real i gjendjes kontabël të inventarit fizikë të aktiveve.
Shkaku:	Mos realizimi i inventarizimit të aktiveve sipas përcaktimeve të

	Udhëzimit 30 datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò
Rëndësia:	e mesme
Rekomandime:	Drejtoria e SRSH-së të marrë masat që në të ardhmen procesi i inventarizimit periodik të aktiveve, të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara në aktet administrative të nxjerra nga vet institucioni, për të mundësuar që aktivet e propozuara jashtë përdorimit të reflektohen në evidencën kontabël të vitit ushtrimor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. E. V., Z. E. A. , Znj. A. Gj. , në cilësinë e anëtarëve të komisionit qendror për inventarizimin për vitin 2018.

Titulli i gjetjes:	Mos hartimi i regjistrit kontabël
Situata:	Për periudhën objekt auditimi nga auditimi rezultoi se Spitali Rajonal Shkodër, nuk ka hartuar regjistrë kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet) dhe pajisjet mjekësore diagnostikuese dhe laboratorike. Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i cili citon se: <i>“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”</i>
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30 i MF datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò
Ndikimi/Efekti:	Mos përditësimi i aktiveve që zotëron apo ka në administrim duke ndikuar në mos evidentimin e numrin e saktë të aktiveve.
Shkaku:	Mungesa e kryerjes së inventarizimit për mjetet themelore (asetet) dhe pajisjet mjekësore diagnostikuese dhe laboratorike.
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të marrë masat për hartimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël sipas standardeve ligjore të kërkuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim); Znj.M. N. , në cilësinë e nëpunësit zbatues (në vazhdim)
Ndërtesa dhe trojet e SRSH nuk kanë dokumenta pronësie

Titulli i gjetjes:	Ndërtesa dhe trojet e SRSH nuk kanë dokumente pronësie
---------------------------	--

Situata:	Në lidhje me zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRSB, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie. Nga ana e drejtuesve të këtij institucioni për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për t'ia regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, veprime të cilat janë në kundërshtim me: <i>Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74.</i>
Kriteri:	Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 nëpër regjistrimin e pasurive të paluajtshme, i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, nëpër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, kreu IV, pika 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndërtesa dhe trojet e SRSB nuk kanë dokumente pronësie
Shkaku:	Mungesa e regjistrimit në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër të ndërtesës dhe truallit të SRSB.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, t' marrë t' gjitha masat e nevojshme, për identifikimin, inventarizimin fizik dhe regjistrimin e aseteve në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër, si dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj.T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

2.5.3. Inventarizimi i pajisjeve mjekësore diagnostikuese dhe laboratorike

Të gjitha pajisjet mjekësore të SRSB duhet të regjistrohen sipas formularit tip të inventarizimit, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB). Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CL. .

Në mënyrë analitike gjendja dhe funksionaliteti i pajisjet mjekësore që posedon SRSB paraqiten në tabelën nr. 7. të aneksit nr.5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Titulli i gjetjes:	SRSB nuk ka bërë regjistrimin e plotë të pajisjeve mjekësore
Situata:	Me Urdhër Brendshëm për inventarizimin nr.87 date 29.05.2019 (nr.1924 prot. date 29.05.2019) nëngritja e komisionit për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm dhe vlerësimit të të gjitha aparaturave mjekësore, në të cilin është përcaktuar si datë e përfundimit të inventarizimit data 15.07.2019 Me Urdhër Brendshëm nr.159 datë 02.09.2019 (nr. 2779 prot. date 02.09.2019) është bërë një ndryshim i anëtarëve të komisionit sipas urdhrit 87 date 29.05.2019. Me Urdhër Brendshëm nr. 212 datë 28.10.2019 (nr. 3339 prot. datë 28.10.2019), nga ana e sektorit të menaxhimit të teknologjisë për të

gjitha aparaturat mjekësore që komisioni i inventarizimit ka vërtetuar që janë pa dokumentacion (fletë hyrje, fletë dalje, akt dhurimi) është kërkuar të bëhet vlerësimi i tyre duke vendosur çmime për njësi sipas elementeve specifike të tyre, çmimet e vendosura për këto aparatura të pasqyrohen në fletët e inventarit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se:

Grupi i inventarizimit të pajisjeve mjekësore nëpërmjet shkresës nr. 528 prot. date 20.02.2020 ka përcjell relacionin mbi inventarizimin e aparaturave mjekësore të strukturat përgjegjëse të SRSH (ky relacion nuk është miratuar nga zv. Drejtori i shërbimeve administrative).

Komisioni i mësipërm në bazë të listës së kartelave të degës biomedikale dhe gjendjes fizike në reparte ka hartuar fletët përkatëse të inventarit fizik.

Nga relacioni i grupit të inventarizimit rezulton se:

Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionojnë dhe për një pjesë të tyre, nga komisioni është propozuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe me pas asgjësimi i tyre, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Disa nga aparaturat mjekësore janë pa dokumente dhe disa të tjera nuk janë të regjistruar në inventarin e SRSH. Nga shqyrtimi i të dhënave mbi inventarin e pajisjeve mjekësore dhe përpunimit të tyre nga pikëpamja sasiore nga grupi i auditimit rezulton, që:

a. SRSH ka ose zotëron 471 pajisje mjekësore, nga këto 156 pajisje ose 33.1 % e tyre nuk funksionojnë dhe qëndrojnë prej vitesh në ambientet e brendshme të reparteve të SRSH duke ndikuar në ndotjen e ambientit për shkak të problematikave që ato kanë në drejtim të mundësisë së rrezatimit etj., duke ndikuar në cilësinë e shëndetit të pacienteve dhe personelit të spitalit.

b. Të gjitha pajisjet mjekësore nuk janë regjistruar sipas formularit tip të inventarizimit, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) të pasqyruar në udhëzuesin e saj.

c. Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CL. ., njësia e inxhinierisë klinike pranë SRSH ka regjistruar 287 pajisje ose 61 % të tyre.

Rezultatit e numrit të regjistrimit të pajisjeve mjekësore, grupi i auditimit e ka konstatuar pas kontrollit në sistemin e informatik të dedikuar për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në platformën Gl. që është një program i inventarizimit dhe monitorimit të pajisjeve mjekësore. Gjithashtu konstatohet se, një numër i konsiderueshëm pajisje mjekësore që janë jashtë funksionimit por që ende nuk janë nxjerr jashtë përdorimit kanë rritur në mënyrë fiktive ñaktivetò në evidencën kontabël në llogarinë pajisje.

Për sa me lart, arrihet në konkluzionin se:

Në SRSH një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor. Gjithashtu vërehet se pajisjet nuk janë regjistruar në inventarin e SRSH dhe si të tilla nuk janë të regjistruar në evidencën kontabël. Të gjithë titullarët e institucionit dhe ata të periudhës së auditimit, nuk

	kanë zbatuar dhe ndjekur politikat kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri, që janë të përcaktuara qartë tek Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë me nr. 3272, datë 11.09.2007 në Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri o ku përcaktohet, se: <i>“Drejtori i spitalit ka përgjegjësin për zhvillimin e procedurës për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura</i>
Kriteri:	Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë me nr. 3272, datë 11.09.2007 në Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri o
Ndikimi/Efekti:	Një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor
Shkaku:	Mos regjistrimi i pajisjeve mjekësore sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB)
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	SRSH në bashkëpunim me Qendra Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bëjë vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SRSH të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

2.5.4.Mbi Zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit për vitin 2019.

Në zbatim të pikës 5, të programit të auditimit në Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit o.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 në Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, pika 4 e nenit 11 dhe të pikës 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në të cilin përcaktohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, Spitali Rajonal Shkodër ka kryer;

Për vitin 2019;

Për vitin 2019 Spitali Rajonal Shkodër nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar saktë numrin e aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike të mjeteve themelore (asetet) , si dhe të gjitha objektet që në kontabilitet janë regjistruar në kundërshtim me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, në Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 në Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26-33, i cili citon se;

Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit përfshijnë : datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Përsa i përket vitit 2019 ,nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër nuk është kryer inventarizimi i përgjithshëm i vlerësimit të aktiveve të inventarit ekonomik dhe të imët, por është kryer inventarizimi vetëm për grupe artikujsh të caktuar, veprim ky në kundërshtim të Ligjit Nr. 10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, Udhëzimin Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Arsyeja pse nuk është kryer inventarizimi i përgjithshëm është se inventarizimi i aktiveve për vitin 2018 ka mbaruar jashtë afateve të parashikuara në ligj, dhe ka përfunduar me datë 14.05.2019. Komisioni i vlerësimit e dorëzoi relacionin për përfundimin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi, me nr 2369 prot, datë 15.07.2019, (inventari i imët 327 dhe inventari ekonomik 218), i cili u miratua nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. . Po gjatë vitit 2019 janë kryer asgjësimet e aktiveve të vitit 2018 të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, veprime këto të pasqyruara në bilancin ekonomik të vitit 2019.

Kronologjia e të gjithë urdhrave të brendshëm për inventarizimin e aktiveve që janë kryer për këtë vit paraqiten si më poshtë;

- Për inventarizimin dhe vlerësimin e autoambulancave u ngrit komisioni i inventarizimit i përbërë nga A. I. ,V. F. ,Dh. K. ,B. L. , I. C.) me Urdhrin e brendshëm të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. nr 88 me nr prot 1925, datë 29.05.2019 .
- Në datën 20.06.2019 ky komision ka hartuar relacionin për inventarizimin dhe vlerësimin autoambulancave të SRSH, nr 2181.

Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit dhe dorëzimit të inventarit nga komisioni ka qenë data 20.06.2019. Ky inventar është kryer brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e brendshëm.

- Komisioni i inventarizimit ka kryer verifikimin e gjendjes fizike të automjeteve dhe dokumentacionin shoqërues të tyre. Inxhinieret pjesë përbërëse e komisionit(V. F. , Dh. K. dhe I. C.) kanë kryer vlerësimin e autoambulancave të Spitalit Rajonal Shkodër me relacionin nr. 2181prot., datë 20.06.2019. Në këtë relacion është konstatuar se 8 (tetë) automjete kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit, janë plotësisht të amortizuara dhe kryerja e riparimeve nuk mund të ketë efekt ekonomik pasi kostoja e riparimit mund të kalojë blerjen e në mjeti të ri. Gjithashtu nga pjesëtarët e zyrës së financës në këtë komision është bërë përlllogaritja e vlerës kontabël të këtyre automjeteve (0 lekë) duke u bazuar te vlera fillestare e blerjes dhe duke i zbritur normën e amortizimit në përputhje me ligjin.
- Me Vendimin nr. 2 me nr 2262/1prot., datë 01.07.2019 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër është miratuar nëNxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimin e 8 (tetë) automjeteve me vlerë 11, 849,986 lekë.
- Me shkresën nr 2324prot., datë 09.07.2019 Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër i ka kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë, miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve.
- Me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë znj.G.P. ,nr. 3653/1 prot, datë 22.07.2019 protokolluar pranë SRSH-së me nr. 2449 prot., datë

23.07.2019 është dhënë miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre autoambulancave duke kryer të gjitha veprimet në përputhje me kuadrin ligjor.

Me Urdhrin e brendshëm nr.114 me nr 2308prot., datë 08.07.2019 nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve të inventarit të imët dhe ekonomik të vitit 2018, të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi", me afat dorëzimi 15.07.2019. *Ky komision ka bërë vlerësimin e inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218) pas përfundimit të inventarit për llogari të vitit 2018 me datë 14.05.2019.*

- Komisioni i vlerësimit ka dorëzuar relacionin nr 2369 prot., datë 15.07.2019, (inventari i imët 327 dhe inventari ekonomik 218) për përfundimin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi, i miratuar nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. .
- Me urdhrin e brendshëm me nr.153 ,datë 27.08.2019 të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M.është ngritur komisioni për asgjësimin e automjeteve (llog 215), inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218).

Afati i dorëzimit të relacionit të asgjësimit nga komisioni ka qënë data 15.09.2019. Komisioni ka kërkuar shtyrje afati me shkresën nr 2890/1 prot., datë 13.09.2019 (për arsye të kohëzgjatjes së procedurës së asgjësimit të materialeve për skrap.

Shtyrja është miratuar nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. i cili ka lëshuar urdhrin e brendshëm me nr.153,datë 27.08.2019 për asgjësimin e inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218) përjashtuar aktivet për skrap që do të nënshtrohen procedurës së ankandit, me afat dorëzimi 15.09.2019.Materialet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi në prani të personave me përgjegjësi materiale u morën në dorëzim nga komisioni i asgjësimit duke u vendosur në një ambient të veçantë. Materialet u transportuan në landfillin e Bushatit me automjetin me kamionçinë tip Kama me targë SH 8835 A .

Vlera e materialeve të asgjësuara sipas personave me përgjegjësi materiale paraqitet si më poshtë.

Personi me Përgjegjësi materiale	llogaria218	llogaria 327
H. H. (Neurologji)	94,052	1,800
M. N. (Poliklinike)	64,500	7,022
Zh. N.	228,000	
V. Gj. (neorologji)		73,529
V. L. (infektiv)		49,506
D. D. (Neonatologji)	1,306,537	103,204
A. D. (Radiologji)		17,028
E. Gj. (Urgjence)	168,572	443,409
F. H. (Obstetrikë)	863,324	412,934
V. B. (Pediatri)		79,152
H. N. (Kardiologji)	54,000	
Dh. T. (Morgu)		12,000
A. M.		13,440
P. K.		75,300
S. D. (Gjinekologji)	159,932	71,070
M. S. (dermatologji)	8,490	20,430
T. Xh. (Sanatorium)		196,981

A. K. (kuzhina)		29,400
	2,947,407	1,606,206

Vlerat e mësipërme janë reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2019.

Materialet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi i janë nënshtruar procedurës së ankandit duke u shitur për skrap.

- Për aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi për tu shitur për skrap, pasi janë peshuar nga komisioni i asgjësimit, janë nënshtruar procedurës së ankandit.
- Pas përfundimit të procedurës së ankandit është lidhur kontrata nr. 572 prot, datë 26.02.2020, me subjektin A. A. .
- Me datë 05.03.2020 u mbajt proces verbali në prani të komisionit dhe subjektit A. A. mbi dorëzimin e skrapit sipas tabelës së mëposhtme:
- Në prani të komisionit në baze të nenit të 4 të kontratës, subjekti bëri shkatërimin dhe ndarjen e pjesëve jo metalike si, plastike, gome, qelq.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera
Lot 1	Skrup H.1&2 metal pa ngjyre	Kg	17 330	17.97219	311 458
Lot 2	Baker	Kg	15	406.396	6 095.94
Lot 3	Alumin	Kg	0.595	123.866	73.7
Vlera totale me 2%e hapit					6 352.55
	TOTALI/lek				323 0.19

Aparaturat mjekësore

Me Urdhrin e brendshëm nr.87, datë 25.05.2019, të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. është krijuar komisioni për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të gjitha aparaturave mjekësore. Komisioni përbëhet nga Gj. B. , G. U. , P. N. , A. B. , A. M.

Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit dhe dorëzimit të inventarit nga komisioni ka qenë data 15.07.2019.

Si rezultat i zvarritjes dhe mos mbarimit në afat të inventarizimit të dhe vlerësimit të të gjitha aparaturave mjekësore me urdhrin e brendshëm nr.159, datë 02.09.2019 të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. , në përbërje të komisionit janë shtuar dhe A. I. dhe B. L. . Edhe pse nuk ka asnjë shpjegim dhe arsye për mos kryerjen brenda afatit të inventarizimit, nga ana e stafit drejtues të SRSH nuk është ndërmarrë asnjë masë administrative ose disiplinore. Gjithashtu shtimi i anëtarëve të grupit të komisionit është bërë në datën 02.09.2019, pra vetëm pas 1 muaj e 17 ditë nga përfundimi i afatit të inventarizimit të përcaktuar në urdhrin e brendshëm nr.87, datë 25.05.2019, veprim ky që ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër z.A. D. dhe Zv/Drejtorin e shërbimeve administrative z.L. M..

Nga komisioni u dorëzua relacioni nr.528, datë 20.02.2020 për inventarizimin dhe vlerësimin e aparaturave mjekësore të SRSH. Specialistët Gj. B. , G. U. dhe A. M. , bënë vlerësimin e pajisjeve mjekësore duke propozuar nxjerrjen e tyre për jashtë përdorimi sipas listës së mëposhtme, pasi aparaturat nuk janë në gjendje pune dhe të amortizuara totalisht

Pra edhe për aparaturat mjekësore nuk është kryer brenda vitit 2019 inventarizimi i tyre , por ky proces ka përfunduar në vitin 2020, veprim ky në kundërshtim të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Në aneksin në.5 tabela nr.7. pasqyrohen te dhëna për komisionet e inventarizimit për vitin 2019

Me shkresën nr.1287 prot.,datë 19.06.2020 Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër i është drejtuar qendrës kombëtare mjekësore për miratim për nxjerrje jashtë përdorimit të aparaturave mjekësore.

Në lidhje me mbajtjen e evidencës kontabile, respektimin e afateve për nxjerrjen e bilancit, dërgimin në organet e varësisë, analizën e debitorëve, kreditorëve rezultoi:

Spitalin Rajonal Shkodër, gjatë periudhës objekt auditimi ka zhvilluar një aktivitet normal në menaxhimin e fondeve publike. Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar. Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë regjistruar në regjistrat kontabël dhe mbahen në programin excel.

-Bilancet e çdo viti janë përgatitur brenda datës së fundit të muajit shkurt të vitit pasardhës dhe janë dërguar brenda afatit ligjor në Degën e Thesarit(DTH) Shkodër, shoqëruar me shkresat përcjellëse respektive për secilin vit dhe janë dërguar gjithashtu Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Shëndetësisë(MSH), konkretisht me shkresën nr. 597 prot, datë 27.02.2020 i janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2019 në MSH në DTH.

-Të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin excel pasi institucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar duke vazhduar duke vepruar në mospërpunje dhe kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 nëPër dokumentin elektronik, i ndryshuar.

Për këto veprime dhe mosveprime mbajnë përgjegjësi ish-drejtori z.V. M. , ish-drejtori znj.T. Rr. , , sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe drejtori aktual z.A. D. .

Të dhënat kryesore të Bilancit të vitit 2019 pasqyrohen si më poshtë :

Aktivitet e qëndrueshme paraqiten në aktiv të bilancit në vlerën 1,419,684,364 lekë e cila përbëhet nga aktive të qëndrueshme të trupëzuara në vlerë neto të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Nr	Nr llog	Emri i Aktiveve të Qënd. të Trupëzuara	Gjendje më 31.12.2019	Gjendje më 31.12.2018
1	210	Toka, Troje, Terrene	22,786,720	22,786,720
2	212	Ndërtime e konstruksione	620,002,780	652,634,506
3	213	Rrugë, rrjetë e vepra ujore		
4	214	Insta. tek .makineri e pajisje	479,934,026	475,496,872
5	215	Mjete transporti	7,197,714	2,451,442
6	231	Shpenzime në proces për rritjen e AQT	636,000	636,000
7	218	Inventar ekonomik	86,027,448	112,563,846
8	24	AQT të dëmtuara		
9	520	Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	50,254,747	39,569,763
10	312	Gjendje Inventari qarkullues	71,850,430	133,549,049
11	411-432	Llogari te Arketushme	50,489,690	53,870,520

12	486	Te tjera aktive afatshkurtra	30,504,809	37,242,077
Totali(aktivit)			1,419,684,364	1,530,800,795

Emërimi i llogarive	Gjendja me 31.12.2018(Neto)	Shtesa gjate vitit 2019	Pakësim amortizimi vjetor 2019	Gjendja me 31.12.2019(Neto)
210	22,786,720	0	0	22,786,720
212	652,634,505	0	32,631,725	620,002,780
214	475,496,872	28,211,998	23,774,844	479,934,026
215	2,451,442	6,545,700	1,799,428	7,197,714
218	112,563,846	1,156,949	27,693,347	86,027,448
	1,265,933,385	35,914,647	85,899,344	1,215,948,688

1.Në lidhje me llogarinë 210, zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRSB, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie, nga ana e drejtuesve të këtij institucioni për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për ti regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 nëPër regjistrimin e pasurive të paluajtshme, i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Për këto veprime dhe mosveprime mbajnë përgjegjësi ish-drejtori z.V. M. , ish-drejtori znj.T. Rr. , sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe drejtori aktual z.A. D. .

2. Llogaria 212 ndërtime dhe konstruksione gjatë vitit 2019 nuk ka pasur shtesë, është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor me vlerë 32,631,705 lekë . Në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 212 është 620,002,780 lekë.

3. Llogaria 214 Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune etj., gjatë vitit 2019 ka pasur shtesë në vlerën 28,211,998 lekë, ku nga këto

- 26,795,453 lekë është hidroklavë e dhuruar nga Spitali nëMbretëresha Geraldinë ,
- 180,000 lekë donacion për 1 EKO,
- 1,056,545 lekë janë blerje nga të ardhurat dytësore.

Llogaria 214 është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor me vlerë 23,774,844 lekë. Në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 214 është 479,934,026(vlerë neto) lekë.

4. Llogaria 215 Mjete transporti gjatë vitit 2019 ka pasur shtesë në vlerën 6,545,700 lekë si rezultat i ardhjes së një autoambulance nga QKUM dhe është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor 1,799,428 lekë. Ne fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 215 është 7,197,714 lekë.

5. Llogaria 218 Inventari ekonomik gjatë vitit 2019 ka pasur shtesë në vlerën 1,156,949 lekë nga të cilat 813,588 lekë nga të ardhurat dytësore dhe 343,631 lekë donacion nga Kuvendi i Shqipërisë.

Llogaria 218 është pakësuar për vlerën e amortizimit vjetor 27,693,347 lekë. Në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 218 është 86,027,448 lekë.Në postin 5-"Shpenzime proces për rritjen e AQT", llogaria 231 janë investime në proces e përbëre nga shuma 636,000 lekë, e cila përfaqëson 1(një) faturë për investime, që nga viti 2011e cila nuk është likuiduar pasi ka qenë në proces gjyqësor.

6. Llogaritja e normave vjetore të amortizimit të aktiveve të qëndrueshme është bërë sipas udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018, në Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e qeverisjes së Përgjithshme.
7. Ndryshimi i gjendjes së inventarit të aktiveve qarkulluese është 61,698,619 lekë. Llogaria 327 inventari i imët gjatë vitit 2019 është shtuar me vlerën 7,011,264 lekë nga të cilat 7,011,264 lekë për veshje për urgjencën sjellë nga QKUM dhe 18,360 lekë blerje nga të ardhurat dytësore. Llogaria 327 është pakësuar në vlerën 1,606,206 lekë si rezultat i asgjësimit të materialeve të ndryshme pjesë e këtij inventari. Në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 327 është 25,634,726 lekë.

Llogaria 311 materiale është shtuar për hyrjet me vlerën 136,831,217 lekë dhe është pakësuar për daljet me vlerën 122,052,211 lekë si dhe asgjësimin e mbetjeve farmaceutike në vlerën 51,919,624 lekë. Në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë materiale është 46,215,704 lekë

Inventari (imët)				
Llogaria	Gjendja 31.12.2018	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2019
3270100	20,211,308	7,029,624	1,606,206	25,634,726
Inventari(materiale)				
Llogaria	Gjendja 31.12.2018	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2019
3110100	113,337,741	136,831,217	203,953,254	46,215,704

Formati 1 Pozicioni financiar

Pasivi

Emri i llogarisë.	Gjendje më 31.12.2019	Gjendje më 31.12.2018
Te tjera pasive afatshkurtra	636,000	636,000
.Pasivet afat shkurtra	96,117,331	96,117,331
Teprica(Fondi akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,361,873,891	1,411,858,588
Rezultatet e mbartura	11,022,512	17,457,487
Rezultatet e veprimtarisë ushtrimore	-38,506,402	4,731,388
Totali i pasivit	1,419,684,364	1,530,800,794

Evidenca analitike dhe dinamika e llogarisë “Te drejtat” për vitin 2019, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Nr. Llog.	Emri i llogarisë.	Gjendjeje me 31.12.2018	Gjendjeje me 31.12.2018
1	411-418	Klientë e llogari të ngjashme	189,296	189,296
2	423-429	Personeli, paradh.deficite e gjoba	3,537,175	3,487,621
2	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	46,748,603	50,178,987
3	468	Debitorë të ndryshëm	14,616	14,616
4	486	Shpenz. te periudhave te ardhshme	30,504,809	37,242,076

Totali	91,112,597	91,112,597
---------------	-------------------	-------------------

Shumat 189,296 lekë (Klientë e llogari të ngjashme) dhe 14,616 lekë (debitorë të ndryshëm) është e mbartur në bilanc para vitit 2013 pa asnjë shpjegim .

Shuma 3,537,175 lekë janë debitorë të lënë nga DRSKSH në vitin 2013 dhe MSHMS në vitin 2014. Shuma 53,092 lekë është krijuar gjatë vitit 2019 dhe është likuiduar në janar 2020. Përsa i përket debitorëve nga viti 2013 dhe 2014 nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër e vetmja masë që është ndërmarrë është lajmërimi i këtyre personave me shkresë të firmosur nga titullari i institucionit ,por nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe shuma prej 3,537,175 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit. Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi ish drejtori i Spitalit z.V. M. , ish-drejtori znj.T. Rr. , sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe drejtori aktual z.A. D. .

Shuma 46,748,603 lekë operacione me shtetin(të drejta) janë detyrimet e dhjetorit 2019 për paga,sigurime shoqërore,shëndetësore,tatime, etj., detyrimet e muajit dhjetor 2019 për mallra eshërbime në vlerë 171,400 lekë. Shuma 30,504,809 lekë paraqet detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2019. Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2018 kanë qenë 37,242,076 lekë. Kjo llogari ka pësuar ulje pasi në fund të vitit 2019 janë likuiduar detyrime të prapambetura ndaj ujësjellësit në vlerë 6,737,267 lekë. Deri në fund të vitit 2019 kur ka filluar likuidimi i detyrimeve për UKSH, nuk është marrë asnjë masë për likuidimin e kësaj vlere në periudhën më përpara, veprim ky që e ka rritur më shume vlerën e detyrimit fillestar ,pasi është rritur dhe vlera e kamatës. Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi ish drejtori i Spitalit z.V.M. , ish-drejtori znj.T. Rr. , , sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe drejtori aktual z.A. D. . Lista e debitorëve paraqitet në tabelën nr.8 të aneksit nr.5

Titulli i gjetjes:	Mos respektimi i afateve kohore për inventarizimin periodik vjetor
Situata:	Përsa i përket vitit 2019, nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër nuk është kryer inventarizimi i përgjithshëm i vlerësimit të aktiveve të inventarit ekonomik dhe të imët, por është kryer inventarizimi vetëm për grupe artikujsh të caktuar.Arsyeja pse nuk është kryer inventarizimi i përgjithshëm është se inventarizimi i aktiveve për vitin 2018 ka mbaruar jashtë afateve të parashikuar në ligj, dhe ka përfunduar me datë 14.05.2019. Komisioni i vlerësimit e ka dorëzuar relacionin për përfundimin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi, me nr. 2369 prot., datë 15.07.2019, (inventari i imët 327 dhe inventari ekonomik 218), i cili u miratua nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. . Po gjatë vitit 2019 janë kryer asgjësimet e aktiveve të vitit 2018 të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, veprime këto të pasqyruara në bilancin ekonomik të vitit 2019. Kronologjia e të gjithë urdhrave të brendshëm për inventarizimin e aktiveve që janë kryer për këtë vit paraqiten si më poshtë; ● Për inventarizimin dhe vlerësimin e autoambulancave u ngrit komisioni I inventarizimit i përbërë nga A. I. ,V. F. ,Dh. K. ,B. L. , I. C.) me Urdhrin e brendshëm të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. nr 88 me nr prot 1925, datë 29.05.2019 .

- Në datën 20.06.2019 ky komision ka hartuar relacionin për inventarizimin dhe vlerësimin autoambulancave të SRSH, nr 2181.

Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit dhe dorëzimit të inventarit nga komisioni ka qenë data 20.06.2019. Ky inventar është kryer brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e brendshëm.

- Komisioni i inventarizimit ka bërë verifikimin e gjendjes fizike të automjeteve dhe dokumentacionin shoqërues të tyre. Inxhinieret pjesë përbërëse e komisionit(V. F. , Dh. K. dhe I. C.) kanë kryer vlerësimin e autoambulancave të Spitalit Rajonal Shkodër me relacionin nr.2181prot., datë 20.06.2019. Në këtë relacion u konstatua se 8 (tetë) automjete kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit, janë plotësisht të amortizuara dhe kryerja e riparimeve nuk mund të ketë efekt ekonomik pasi kostoja e riparimit mund të kalojë blerjen e në mjeti të ri. Gjithashtu nga pjesëtarët e zyrës së financës në këtë komision është bërë përlllogaritja e vlerës kontabël të këtyre automjeteve (0 lekë) duke u bazuar te vlera fillestare e blerjes dhe duke i zbritur normën e amortizimit në përputhje me ligjin.
- Me Vendimin nr. 2 me nr. 2262/1 prot., datë 01.07.2019 të drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimin e 8 (tetë) automjeteve me vlerë 11, 849,986 lekë.
- Me shkresën nr 2324 prot, datë 09.07.2019 Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër i ka kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë, miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve.
- Me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë znj.G.P.,nr 3653/1prot., datë 22.07.2019 protokolluar pranë SRSH-së me nr. 2449 prot., datë 23.07.2019 është dhënë miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre autoambulancave duke kryer të gjitha veprimet në përputhje me kuadrin ligjor.

Me Urdhrin e brendshëm nr.114 me nr. 2308prot., datë 08.07.2019 nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve të inventarit të imët dhe ekonomik të vitit 2018, të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi", me afat dorëzimi 15.07.2019 është krijuar komisioni i përbërë nga M. N. , J. Zh. ,K. M. , L. Z. , L. Gj. .

Ky komision ka bërë vlerësimin e inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218) pas përfundimit të inventarit për llogari të vitit 2018 me datë 14.05.2019.

- Komisioni i vlerësimit ka dorëzuar relacionin nr 2369 prot., datë 15.07.2019, (inventari i imët 327 dhe inventari ekonomik 218) për përfundimin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi, akt i miratuar nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. .
- Me urdhrin e brendshëm me nr.153 ,datë 27.08.2019 të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M.është ngritur komisioni për asgjësimin e automjeteve (llog 215), inventarit të imët (llog 327) dhe inventarit ekonomik (llog 218) i përbërë nga

M. Zh. , A. B. , N. A. ,E. A. dhe B. B. .

Afati i dorëzimit të relacionit të asgjësimit nga komisioni ka qënë data 15.09.2019. Komisioni ka kërkuar shtyrje afati me shkresën nr 2890/1, datë 13.09.2019 (për arsye të kohëzgjatjes së procedurës së asgjësimit të materialeve për skrap.

Shtyrja është miratuar nga Zv/Drejtor i shërbimeve administrative z.L. M. i cili ka lëshuar urdhrin e brendshëm me nr.153, datë 27.08.2019 për asgjësimin e inventarit të imët (llog. 327) dhe inventarit ekonomik (llog. 218) përjashtuar aktivet për skrap që do të nënshtrohen procedurës së ankandit, me afat dorëzimi 15.09.2019. Materialet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi në prani të personave me përgjegjësi materiale janë marrë në dorëzim nga komisioni i asgjësimit dhe vendosur në një ambient të veçantë. Materialet janë transportuar në landfillin e Bushatit me automjetin me kamionçinë tip Kama me targë SH 8835 A .

Vlerat e mësipërme janë reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2019.

Materialet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi i janë nënshtruar procedurës së ankandit duke u shitur për skrap.

- Për aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi për tu shitur për skrap, pasi janë peshuar nga komisioni i asgjësimit, janë nënshtruar procedurës së ankandit.
- Pas përfundimit të procedurës së ankandit është lidhur kontrata nr. 572 prot., datë 26.02.2020, me subjektin A. A. .
- Me datë 05.03.2020 është mbajtur proces verbal në prani të komisionit dhe subjektit A. A. mbi dorëzimin e skrapit sipas tabelës së mëposhtme:
- Në prani të komisionit në baze të nenit të 4 të kontratës, subjekti ka bërëshkatërimin dhe ndarjen e pjesëve jo metalike si, plastikë, gomë dhe qelq.

Aparaturat mjekësore

Me Urdhrin e brendshëm nr.87, datë 25.05.2019, të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. është krijuar komisioni për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të gjitha aparaturave mjekësore. Komisioni përbëhet nga Gj. B. , G. U. , P. N. , A. B. , A. M.

Afati i kryerjes së procesit të inventarizimit dhe dorëzimit të inventarit nga komisioni ka qënë data 15.07.2019.

Si rezultat i zvarritjes dhe mos mbarimit në afat të inventarizimit të dhe vlerësimit të të gjitha aparaturave mjekësore me urdhrin e brendshëm nr.159, datë 02.09.2019 të Zv/Drejtorit të shërbimeve administrative z.L. M. , në përbërje të komisionit janë shtuar dhe A. I. dhe B. L . Edhe pse nuk ka asnjë shpjegim dhe arsye për mos kryerjen brenda afatit të inventarizimit, nga ana e stafit drejtues të SRSH nuk është ndërmarrë asnjë masë administrative ose disiplinore. Gjithashtu shtimi i anëtarëve të grupit të komisionit është bërë në datën 02.09.2019, pra vetëm pas 1 muaj e 17 ditë nga përfundimi i afatit të inventarizimit të përcaktuar në urdhrin e brendshëm nr.87, datë 25.05.2019, veprim ky që ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër z.A. D. dhe Zv/Drejtorin e shërbimeve administrative z.L. M. .

	Nga komisioni është dorëzuar relacioni nr.528,datë 20.02.2020 për inventarizimin dhe vlerësimin e aparaturave mjekësore të SRSH. Specialistët Gj. B. ,G. U. dhe A. M. , i cili ka bërë vlerësimin e pajisjeve mjekësore duke propozuar nxjerrjen e tyre jashtë përdorimi (sipas listës), pasi aparaturat nuk janë në gjendje pune dhe të amortizuara totalisht. Pra edhe për aparaturat mjekësore nuk është kryer brenda vitit 2019 inventarizimi i tyre , por ky proces ka përfunduar në vitin 2020.
Kriteri:	Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Rregullorja e Spitalit Rajonal Shkodër, Rregullorja e funksionimit Teknik (nr. 882 prot. Date 19.09.2011)
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi real i gjendjes kontabël të inventarit fizik të aktiveve.
Shkaku:	Mos realizimi i inventarizimit të aktiveve sipas përcaktimeve të Udhëzimit datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik
Rëndësia:	e mesme
Rekomandime:	Drejtoria e SRSH-së të marrë masat që në të ardhmen procesi i inventarizimit periodik të aktiveve, të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara në aktet administrative të nxjerra nga vet institucioni, për të mundësuar që aktivet e propozuara jashtë përdorimit të reflektohen në evidencën kontabël të vitit ushtrimor.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e programeve financiare për mbajtjen e evidencës kontabile.
Situata:	Të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin excel pasi institucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar.
Kriteri:	Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 nëPër dokumentin elektronik, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mundësia e krijimit të pasaktësive në mbajtjen e evidencës kontabile
Shkaku:	Mos respektimi i Ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010 nëPër dokumentin elektronik, i ndryshuar.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga drejtori i Spitalit të merren masa që drejtoria e financës të pajiset me një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij.

Për këto veprime dhe mosveprime mbajnë përgjegjësi ish-drejtori z.V. M. , ish-drejtori znj.T. Rr. , sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar dhe drejtori aktual z.A. D. .

2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.

Për vitin 2018, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2018 - 31.12.2018;
- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);
- Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/ dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila strukturë përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka SRSH për punë, shërbime e mallra, të cilat janë miratuar nga Drejtori i SRSH, për çdo vit, referuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publikò, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si më poshtë vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2018 i 31.12.2018, auditohet 8 procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa tvsh.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varion nga 1 deri në 2 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesimin e paktë të OE edhe pse kriteret që aplikohen nga AK përgjithësisht janë në përputhje me ligjin, llojin dhe natyrën e prokurimit..

-Nga auditimin i 8 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 nëPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveò, ku;

a- Në 1 (një) procedurë, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b- Në 3 (tre) procedura, OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike, për vlerën e kontratave prej 9,036,290 lekë dhe dëm ekonomik në vlerën 71,440 lekë.

Procedurat e audituara janë:

Nr .	Objekt prokurimit	Lloji procedurë	Vlera e prokurimit	OE shpallur fitues	Shkelje të LPP	Prokurim fondeve kundërshti 3E ^{-të} të në me	Dëm Ekonomik
1	Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në 2 lote	Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës	14,166,666	Gr.	PO	JO	JO
2	Blerje medikamente e ndarë në 95 lote	Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës	19,731,322	Tr.& CFO Ph.	JO	JO	JO
3	Blerje	Negocim pa botim	10,076,407	Ph. Plus	JO	JO	JO

	medikamente e ndarë në 64 lote	paraparak të njoftimit të kontratës					
4	Blerje oksigjen i lëngët	Negocim pa botim paraparak të njoftimit të kontratës	5,959,602	Jo. Fi. Gas	PO	JO	JO
5	Blerje ushqimesh	Kërkesë për propozim	7,009,992	SE. SGS	PO	6,921,840	71,440
6	Riparim, mirëmbajtje automjetesh	Kërkesë për propozim	1,000,000	KA.	PO	990,000	JO
7	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike nga roje private	Kërkesë për propozim	7,980,000	MI.	PO	JO	JO
8	Blerje Medikamente-Marrëveshje kuadër e ndarë në 23 lote	Kërkesë për propozim	22,588,665		PO	1,124,450	JO
	Totali		88,512,654			9,036,290	71,400

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

I-Tenderi me objekt: Blerje materiale konsumi mjekësore e ndare ne 2 lote, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje materiale konsumi mjekësore, 2 lote		
1.Urdhër Prokurimi Nr.655 Datë 15.02.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.3 dt.15.02.2018 1. Xh. H. jurist e NJP 2. V. B.- eko/anëtare 3 B. T.- Mjek/anetar	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.671. Dt 16.02.2018 (loti 1) 1. L. Gj. Kryetar 2. N. Th. Anetare 3 .G. G. Anetar U. Nr.671/1. Dt 16.02.2018 (loti 2) 1. N. Th. 2. A. M. Anetare 3 .G. G. Anetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Negocim pa botim paraparak të njoftimit të kontratës		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 14,041,568 leke Loti 1= 6,788,655 lekë Loti 2= 7,252,913 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 13,991,818 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 49,750 lekë Loti 1= 6,763,655 lekë Loti 2= 7,228,163 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.02..2018	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit (FSDKSH)	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.2 OE b) Sëkualifikuar IR. OE, Shpallur Fitues :GR.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, sipas shkesës nr. 2395/1, datë 08.11.2017, drejtuar SRSB nga grupi i punës ngritur me urdhrin nr. 2395, datë 08.11.2017 për nënprocedurën e planifikimit të nevojave spitalore; Urdhër i brendshëm për nënprocedurën e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit...; nr. 28, datë 01.02.2018; urdhër i brendshëm nr. 30, datë 02.02.2018 në Kërkesë për materiale konsumi mjekësore; shkresës së SRSB drejtuar MSHMS nr. 358, datë 14.01.2018 në Planifikimi për medikamente dhe materiale mjekimi 2018; lista e medikamenteve të miratuara për përdorim spitalor me çmimet e miratuara për vitin 2018; relacioni nr. 499, datë 05.02.2018 drejtuar SRSB nga Përgjegjësi i Farmacisë; si dhe shkresa nr. 652, datë 15.02.2018 drejtuar SRSB, nga Sektori i Planifikimit të Prokurimeve, për nënargumentimin e fondit limit

Procedura rezulton të jetë kryer pas rekomandimit të MSHMS për shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2018, e cila me shkresën nr. 771, datë 30.01.2018, i ka dhënë të drejtën

SRSH të prokurimit të Barnave dhe medikamenteve, për nëlejin e institucioneve spitalore për kryerjen e procedurave të prokurimit për nevojat urgjente për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2018, shkresë e protokolluar nga SHRS me nr. 458, datë 01.02.2018

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

Lidhur me OE të ftuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe konkretisht: Gre.; Ge. dhe I., miratuar me urdhrin nr. 653, datë 15.02.2018, hartuar nga NJP Xh. H., V. B. dhe B. T. dhe miratuar nga Titullari I AK V. M., rezulton se është kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 08.01.2018, pika 6, pasi në dosje nuk ka asnjë procedurë apo dokument që mundëson argumentimin për ftesë të operatorëve të sipërcituar, si dhe nuk ka asnjë dokument të shkruar apo printuar nga llogaria mail që të dokumentojë mënyrën e ftesës së tyre, marrjen dijeni të OE dhe pranimin apo jo prej tyre të ftesës për pjesëmarrje, si dhe nenin 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, sipas të cilit: n1. Autoriteti kontraktor, për kontratat me vlerë mbi ose nën⁵ kufirin e ulët monetar, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe në rregullat e prokurimit publik.

-Zhvillimi i procedurës.

Nga KVO, me nr. 16, datë 19.02.2018, është mbajtur Proces-Verbali i hapjes së ofertave, për Lotin 1 dhe (A. M., L. Gj. dhe G. K.), me nr. 17, datë 19.02.2018, si dhe procesverbali i vlerësimit nr. 21, datë 27.02.2018, për lotin nr. 1 dhe nr. 22, datë 27.02.2018, për lotin nr. 2. është mbajtur Proces-Verbali i hapjes së ofertave, për Lotin 2, si dhe është mbajtur Raporti përmbledhës nr. 760 dhe 760/1 datë 27.02.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës, ka rezultuar se për secilin lot janë paraqitur nga 2 oferta, nga ku OE GR. është shpallur fitues si i vetmi OE me ofertë ekonomike të paraqitur.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 27.02.2018, dhe Vendimit të Titullarit të AK datë 27.02.2018, janë miratuar dhe shpallur fitues për të dy lotët OE nGRE.ò shpk, dhe skualifikuar OE nIR.ò.

Loti nr. 1

Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se për **Lotin nr. 1**, kanë marrë pjesë 2 (dy) operator pjesëmarrës janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE, dhe konkretisht:

Nr.	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	IR.	0	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar nga AK, përveç ekstraktit historik të regjistrit tregtar, nga QKB
2.	GR.	6,763,655	Kualifikuar dhe Shpallur Fitues

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE nGR.ò SHPK, me vlerë oferte prej 6,763,655 lekë pa TVSH, nga 6,788,655 lekë të prokuruar, ose më pak për vlerën prej 25,000 lekë.

Loti nr. 2

⁵Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 nëPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 nëPër Prokurimin Publikò

Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se për **Lotin nr. 1**, kanë marrë pjesë 2 (dy) operator pjesëmarrës janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE, dhe konkretisht:

Nr.	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	IR.	0	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar nga AK, përveç ekstraktit historik të regjistrat tregtar, nga QKB
2.	GR.	7,228,163	Kualifikuar dhe Shpallur Fitues

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñGR.ò SHPK, me vlerë oferte prej 7,228,163 lekë pa TVSH, nga 7,252,913 lekë të prokuruar, ose më pak për vlerën prej 24,750 lekë.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 27.02.2018, me njoftimet nr. 757 dhe 758 ka shpallur fituese OE ñGR.ò shpk, me vlerë oferte prej 13,911,818 lekë pa TVSH dhe lidhur kontrata nr. 881, datë 05.03.2018, me afat deri më 15.04.2018.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues ñGR. ò SHPK, LOTI nr. 1**, rezulton se ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve të prokurimit ñ Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në 2 lote ò.
Situata:	Njësia e Prokurimit ka ftuar të marrë pjesë në procedurën e prokurimit OE Gr. ; Ge. dhe I. , miratuar me urdhrin nr. 653, datë 15.02.2018, veprim i cili ka rezultuar se është kryer në mospërputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 08.01.2018, pika 6, pasi në dosje nuk ka asnjë procedurë apo dokument që mundëson argumentimin për ftesë të operatorëve të sipërcituar, si dhe nuk ka asnjë dokument të shkruar apo printuar nga llogaria mail që të dokumentojë mënyrën e ftesës së tyre, marrjen dijeni të OE dhe pranimin apo jo prej tyre të ftesës për pjesëmarrje, si dhe nenin 33 “ <i>Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit</i> ”, sipas të cilit: ñ1. Autoriteti kontraktor, për kontratat me vlerë mbi ose nën ⁶ kufirin e ulët monetar, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe në rregullat e prokurimit publik. <i>Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës ose në diskriminimin e kandidatëve</i> ò.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Udhëzimin nr. 2, datë 08.01.2018 të APP, pika 6, pasi në dosje nuk ka asnjë procedurë apo dokument që mundëson argumentimin për ftesë të operatorëve të sipërcituar, si dhe nuk ka asnjë dokument të shkruar apo printuar nga llogaria mail që të dokumentojë mënyrën e ftesës së tyre, marrjen dijeni të OE dhe pranimin apo jo prej tyre të ftesës për pjesëmarrje, si dhe nenin 33 “ <i>Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të</i>

⁶Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 ñPër Prokurimin Publikò

	<i>njoftimit</i> ”, sipas të cilit: n1. Autoriteti kontraktor, për kontratat me vlerë mbi ose nën ⁷ kufirin e ulët monetar, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe në rregullat e prokurimit publik.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Ulje e pjesëmarrjes/konkurimit në procedurën e prokurimit
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në përcaktimin e kriterëve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të marrë masa për vendosjen e tyre në përputhje me llojin e saj si dhe në respektimin të referencave ligjore në fuqi me qëllim rritjen e konkurrencës dhe mos diskriminimin e Operatorëve Ekonomik të fushës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/59-61 datë 23.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/6, datë 27.05.2021 në Mbi Projektraportin e Auditimit nga L. Gj. , N. Th. dhe G. G. (Loti 1) dhe L. Gj. , A. M. dhe G. K. (Loti 2), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në kriteret e DST pika 2.3.7, KVO është bazuar në formularin e ofertës ekonomike të operatorit “Gr. ”, si dhe në deklaratën e origjinës së mallit dhe kompanisë prodhuese duke i marrë për të mirëqenë artikujt e ofruar.

-Bazuar në kriteret e DST pika 2.3.7, KVO është bazuar në formularin e ofertës ekonomike të operatorit “Gr. ”, nga ku rezulton se katalogët e ngarkuar në SEP janë listuar dhe markuar artikujt e kërkuar, gjithashtu OE ka plotësuar të dhënat për specifikimet teknike të të gjithë artikujve dhe dorëzuar në SEP deklaratën e Origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për gjithë artikujt e ofruar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për të dykundërshtimet e bëra nga KVO për lotin 1 dhe 2, punonjësit pretendojnë se dokumentet janë në përputhje me DST. Nga grupi i auditimit kundërshtimet dhe argumentet e paraqitura, pas rivlerësimit janë marrë në konsideratë si përsa i përket deklaratës mbi origjinën e mallit apo formularit të ofertës ashtu edhe katalogëve për produktet e ofertuara, prandaj observacionet e bëra janë marrë në konsideratë duke bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II-Tenderi me objekt: Blerje ushqimesh, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje ushqimesh		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1382 Datë 18.04.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.1382 dt.18.04.2018 1 G. N. - sp/prok /eko kryetare 2 V. B. - sp/ anetare 3 A. B. i pergj hotelierie/ anëtar	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.977. Dt 13.03.2018 1.M. K. Kryetar)-sp.kosto 2.A. I. -Anëtare (sekretare) 3.P. N. - Anetar (sp prok)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për Propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7 009 992 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 6,921,840 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 88,152 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 24.4..2018	9.Burimi Financimit Te ardhura dytësore	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.2 OE b) Sëkualifikuar 1, c) Kualifikuar 1 Shpallur Fitues: SAED SGS

⁷ Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 në Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 në Për Prokurimin Publiko

Hartimi fondit limit:

1. Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nëMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 21.05.2018, sipas UB Nr. 1579 prot., datë 15.05.2018. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

2. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 17.04.2018 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me Nr. 1464 prot., datë 10.04.2018.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk çenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **24.04.2018**, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	ñSE. S.ò SHPK	6,921,840	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2	ñNI.ò SHPK & ñK.ò SHPK	6,850,400	<i>Arsyet e mos kualifikimit:</i> Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar nga AK BOE ñNI.ò SHPK & ñK.ò SHPK nuk plotëson kriterin: ñOperatori ekonomik duhet te ketë te përfshirë ne listë pagesa për gjashtëmujorin e fundit një specialist veterinar dhe specialist teknolog te vërtetuar kjo me kontrata te rregullta pune, CV, Diplomeò sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për veteriner.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 26.04.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar 1 operator, është tërhequr nga gara 0 OE dhe është kualifikuar 1 ofertë. Është ankuar në KPP BOE i skualifikuar dhe më datë 04.05.2018 ka dalë dhe vendimi i KPP i cili ka rrëzuar kërkesën e ankuesit.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñSE. S.ò SHPK, me vlerë kontrate 6,921,840 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 08.05.2018 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñSE. S.ò SHPK me vlerë kontrate 6,921,840 lekë, si dhe lidhur kontrata me nr. 1495, datë 08.05.2018, me afat 365 ditë kalendarike.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues** ñSE. S.ò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.11 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: ñOperatori ekonomik duhet te paraqesin njëvërtetim qe vërteton se subjekti është i regjistruar pranë AKUò.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, Si operatori ekonomik i skualifikuar BOE ñNI.ò SHPK & ñK.ò SHPK, ashtu dhe OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñSE. S.ò SHPK, (dokumenti nr. 356, datë 15.03.2018) kane paraqitur te njëjtin format për plotësimin e kriterit 11, kur sipas kriterit duhet që Operatori ekonomik duhet te paraqesin një **vërtetim qe vërteton se subjekti**

është i regjistruar pranë AKU, ndërkohë që në sistem është ngarkuar Raport Prove, lëshuar nga MBZHR, AKU, Drejtoria Rajonale Shkodër, Sektori i Shërbimeve Laboratorike (shih dokumentin në aneksin bashkëlidhur)

Për të njëjtat mungesa njëri OE është skualifikuar ndërsa tjetri jo, duke u shpallur fitues.

-Mungesë e vërtetimit të regjistrimit pranë AKU. Ekziston vetëm një vërtetim inspektimi për magazinë ushqimore të vitit 2017.

-Mungesë e një specialist veteriner në listëpagesat për 6 mujorin e fundit, shoqëruar me kontratë të rregullt pune CV dhe diplome.

Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike në SHPK & në SHPK me vlerë oferte prej 6,850,400 lekë dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE në SHPK me vlerë ofertë prej 6,921,740 lekë, **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe SRSH për vlerën prej 71,440 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, veprime **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: M. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .**

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga M. K., në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SE. S.”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 6,921,840lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{të}), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: M. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .**

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Blerje Ushqimesh.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 24.04.2018, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure në SHPK dhe BOE në SHPK. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 26.04.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas

	këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është skualifikuar 1 operator dhe është kualifikuar 1 ofertë. Është ankuar në KPP BOE i skualifikuar dhe më datë 04.05.2018 nga ku ka dalë dhe vendimi i KPP i cili ka rrëzuar kërkesën e ankuesit. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñSE. S.ò SHPK, me vlerë kontrate 6,921,840 lekë dhe lidhur kontrata me nr. 1495, datë 08.05.2018, me afat 365 ditë kalendarike. **** Lidhur me OE të shpallur fitues ñSE. S.ò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.11</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: ñOperatori ekonomik duhet të paraqesin njëvërtetim që vërteton se subjekti është i regjistruar pranë AKUò. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, Si operatori ekonomik i skualifikuar BOE ñNI.ò SHPK & ñK.ò SHPK, ashtu dhe OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñSE. S.ò SHPK, (dokumenti nr. 356, datë 15.03.2018) kane paraqitur të njëjtin format për plotësimin e kriterit 11, kur sipas kriterit duhet që Operatori ekonomik duhet të paraqesin një vërtetim që vërteton se subjekti është i regjistruar pranë AKU, ndërkohë që në sistem është ngarkuar Raport Prove, lëshuar nga MBZHR, AKU, Drejtoria Rajonale Shkodër, Sektori i Shërbimeve Laboratorike (shih dokumentin në aneksin bashkëlidhur). <u>Për të njëjtat mungesa njëri OE është skualifikuar ndërsa tjetri jo, duke u shpallur fitues.</u> -Mungesë e vërtetimit të regjistrimit pranë AKU. Ekziston vetëm një vërtetim inspektimi për magazinë ushqimore të vitit 2017. -Mungesë e një specialist veteriner në listpagesat për 6 mujorin e fundit, shoqëruar me kontratë të rregullt pune CV dhe diplome. <u>Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike “NI.” SHPK & “K.” SHPK me vlerë oferte prej 6,850,400 lekë dhe shpalljen fitues të OE “SA. S.” SHPK, me vlerë ofertë prej 6,921,740 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe SRSH për vlerën prej 71,440 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët.</u> Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñSE. S.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SE. S.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e
--	--

	<i>saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 6,921,840 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të}).</i>
Kriteri:	Mos referim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> "; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> "; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.</i>
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të ofertës më të disfavorshme ekonomike dhe skualifikim të ofertës më të favorshme për të njëjtat shkaqe e mangësi të rezultuara edhe në dokumentacionin e ofertës të shpallur fituese, me dëm ekonomik për buxhetin e institucionit në vlerën prej 71,440 lekë , (diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët), si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 6,921,840 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të})
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të kërkojë në rrugë ligjore nga KVO dhe Titullari i AK, shpërblimin e dëmit në vlerën prej 71,440 lekë, krijuar nga skualifikimi i ofertës më të favorshme ekonomike, për të njëjtat shkaqe e mangësi të konstatuara edhe në dokumentacionin e ofertës të shpallur fitues, si dhe nxjerrjen e përgjegjësi konkrete për vlerën e kontraktuar 6,921,840 lekë , si prokurim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të}) .

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë M. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullari i autoritetit kontraktor z. V. M. , në cilësiën e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/48, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 23.09.2021 në Mbi Projektraportin e Auditimit nga znj M. K. dhe znj. A. I. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka skualifikuar të 2 OE apo BOE pjesëmarrës dhe se ka qenë KPP e cila me vendimin nr. 272/2018, datë 03.05.2018 ka vendosur që AK të anullojnë vendimin e KVO për skualifikimin e "SE." SHPK, duke e kualifikuar këtë OE.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, mbi vendimin e KPP, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë përsa është në kompetencë të KVO ta vlerësojë apo rivlerësojë të gjithë dokumentacionin dhe procedurën, pas vendimit respektiv të KPP. Në këto kushte, pavarësisht ankesës së bërë nga OE, trajtimit dhe pranimi të saj nga KPP, AK duhet që brenda 10 ditëve të bënte me dije KPP për shkaqet për të cilat nuk mund ta shpallte fitues OE, si dhe për vijueshmërinë e procedurës, prandaj observacioni i risjell nuk do të merret në konsideratë.

III-Tenderi me objekt: Blerje oksigjen i lëngshëm, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje oksigjen i lëngshëm			
1.Urdhër Prokurimi Nr.675 Datë 16.02.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Negocim pa shpallje paraprake	Urdhër Nr.675 dt.16.02.2018 1 Xh. H. - sp/prok /jur kryetare 2 E. H. - sp/eko anetare 3 A. M. i infermier/ anetar	Urdhër Nr.676. Dt 16.02.2018 1.B. B. Kryetar)-juriste 2.J. Zh. -Anëtare (sp hoteleri) 3.V. F. - Anetar (ing)	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,959,602 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 4,345,000 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,614,602 lekë	
8. Data e hapjes së tenderit 20.02.2018	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S kualifikuar 0, c) Shpallur Fitues: Jovan Filo Gas	

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni i Mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 07.02.2018, sipas UB Nr. 474 prot., datë 01.02.2018. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 16.02.2018 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me Nr. 474 prot., datë 01.02.2018.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **20.02.2018**, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	ñJo. Fi. G.ò SHPK	4,345,000	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 23.02.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti

përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 1 operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñJo. Fi. G.ò SHPK, me vlerë kontrate 4,345,000 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 26.02.2018 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñJo. Fi. G.ò SHPK me vlerë kontrate 4,345,000 lekë, si dhe lidhur kontrata me nr. 816, datë 01.03.2018, me afat duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me përfundim në 15.04.2018.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues** ñJo. Fi. G.ò SHPK, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/51, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 23.09.2021 ñMbi Projekt raportin e Auditimit nga znj. B. B. dhe z. V. F. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi procedura e prokuruar në mënyrë elektronike është e rregullt, si dhe OE i shpallur fitues disponon dokumentin e ngarkuar në SEP për autorizim të prodhuesit, duke i bashkëlidhur edhe autorizimin nga prodhuesi, datë 22.01.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit e ka marrë në konsideratë edhe pse autorizimi i lëshuar nga prodhuesi nukkonfirmon se ofertuesi autorizohet të tregtojë mallin e tij në këtë procedurë prokurimi, por procedurë të hapur dhe pa emërtim se për cilin AK. Po ashtu ky sqarim merret parasysh edhe për faktin se kontrata e lidhur me këtë operator (çmim/sasi) rezulton të jetë shumë me e favorshme se ato të lidhura me OE të më para por dhe pas kësaj procedure prokurimi, nga ku rezulton se çmimi i ofertuar nga kjo shoqëri në krahasim me operatorët e tjerë është ndjeshëm shumë më i favorshëm ekonomikisht. Theksojmë gjithashtu se kontratat e lidhura nga SRSH me OE të tjerë janë afërsisht në çmimin 135 lekë/litër, ndërsa ajo me OE ñFI.ò me çmim 100 lekë/litër është, referim të cilin SRSH duhet ta ketë në konsideratë në përlllogaritjen e fondit për procedurat e prokurimit në vijim, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

IV-Tenderi me objekt: Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, me afat 1 vjeçar (12 muaj), me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë me roje private.		
1.Urdhër Prokurimi Nr.40 Datë 16.02.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit	Urdhër Nr.40 dt.16.02.2018	Urdhër Nr.737. Dt 26.06.2018
Kërkesë me propozim-marrëveshje kuadër	1 E. A. 2 G. N. - sp/jurist/anetare 3 P. P. N. - /anetar	1.K. M. Kryetar 2.V. B. Anetare 3.A. I. Anetar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,984,763 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 7,968,000 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 16,763 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 01.03..2018	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.1 OE Shpallur Fitues: MI.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 351, datë 24.01.2018 dhe procesverbal datë 25.01.2018, sipas të cilit është realizuar përlllogaritja e fondit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 16.02.2018 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

**** **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.01.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës, ka rezultuar se ka paraqitur ofertë vetëm OE i shpallur fitues dhe konkretisht ñMI.ò SHPSF.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 07.02.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 07.02.2019, janë miratuar procedurat duke shpallur fituese OE dhe lidhur kontrata, për vlerën prej 7,968,000 lekë, me afat 365 ditë kalendarike.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** ñMI.ò SHPSF, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar si duhet të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik ka paraqitur dy formularë të ofertave ekonomike me ofertë të ndryshme:
Vlera 2 656 000 lekë pa TVSH.

Vlera 7 968 000 lekë pa TVSH.

Ndryshon emërtimi por jo sasia.

(Shih foto nr.1, nr. 2 dhe nr. 3 në aneksin bashkëlidhur RPA)

Sa sipër, Formulari i ofertës nuk përputhet me formularin e marrë në konsideratë për vlerën e ofertës dhe në këto kushte ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñMI.ò SHPSF. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga K. M. në cilësinë e kryetarit të KVO A. I. dhe V. B. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .

SIPAS DST është kërkuar:Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i kontratës/marrëveshjes kuadër:

ñShërbimi i rojeve civileò,

Ruajtja me roje të shërbimit civil të ambienteve spitalore:

-Godinave të Kompleksit qendror dhe ambientet rrethuese: 1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje

-Poliklinika dhe ambientet rrethuese :1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje

-Senatoriumit dhe ambienteve rrethuese 1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje ò

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me

specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga K. M. në cilësinë e kryetarit të KVO A. I. dhe V. B. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .

Konkluzioni: *Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SHPSF”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO e përbërë nga: K. M. në cilësinë e kryetarit të KVO A. I. dhe V. B. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. .*

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, me afat 1 vjeçar (12 muaj) ò.
Situata:	-Zhvillimi i procedurës. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.01.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se ka paraqitur ofertë vetëm OE i shpallur fitues dhe konkretisht në MIRIò SHPSF. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 07.02.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 07.02.2019, janë miratuar proceduat dhe lidhur kontrata, për vlerën prej 7,968,000 lekë, me afat 365 ditë kalendarike. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në MIRIò SHPSF, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar si duhet të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK pasi ky OE ka paraqitur dy formularë të ofertave ekonomike me ofertë të ndryshme: Vlera 2 656 000 lekë pa TVSH. Vlera 7 968 000 lekë pa TVSH. Ndryshon emërtimi por jo sasia. Sa sipër, Formulari i ofertës nuk përputhet me formularin e marrë në konsideratë për vlerën e ofertës dhe në këto kushte ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në MIRIò SHPSF. SIPAS DST është kërkuar:Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i kontratës/marrëveshjes kuadër: Shërbimi i rojeve civileò, Ruajtja me roje të shërbimit civil të ambienteve spitalore: -Godinave të Kompleksit qendror dhe ambientet rrethuese: 1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje -Poliklinika dhe ambientet rrethuese :1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje -Senatoriumit dhe ambienteve rrethuese 1 vendroje me 3 turne me 4.98 roje Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i>ò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për</i>

	prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SHP.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 ñObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit plotësisht të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga K. M. në cilësinë e kryetarit të KVO A. I. dhe V. B. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. V. M. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/44, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 23.0.2021 ñMbi Projekt raportin e Auditimitò nga K. M. , V. B. dhe A.I. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi formulari i ofertës është plotësuar sipas DST-ve të tenderit, e cila është specifikuar vlera e shërbimit për një vend roje si dhe vlera totale për tre vend roje.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk e ka marrë në konsideratë për faktin se ashtu si dhe është trajtuar në akt konstatim dhe projekt-raport, në SEP, OE ka ngarkuar dy oferta të ndryshme nga ku vetëm njëra është sipër përcaktimeve të DST dhe tjetra jo, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

V-Tenderi me objekt: Blerje medikamente MK e ndare ne 23 lote - ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara -me afat 1 vjeçar (12 muaj), me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje medikamente - Marrëveshje Kuadër me nje operatore ekonomik - ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara -me afat 1 vjeçar (12 muaj).		
1.Urdhër Prokurimi Nr4645 Datë 20.12.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë me propozim	Urdhër Nr.4645 dt.27.12.2018 1 V. B. - pegj/prok/ekon 2 G. N. - sp/jurist/anetare 3 B.B.- Mjek/anetar	Urdhër Nr.128. Dt 14.01.2019 1.E. V. Kryetar -(Zv/dr) 2.A. I. Anetare (sp.prok) 3.A. H. Anetar (Mjek)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 22 588 665.93 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) _____ <i>leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) _____ <i>lekë</i>
8. Data e hapjes së tenderit 23.04..2019	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.22 OE b) Sëkualifikuar I., E. OE, Shpallur Fitues : c) Kualifikuar Lot 20 Medic. Kualifikuar lot 12 Medic. Kualifikuar lot 4 Alb.Fa. Kualifikuar lot 18 Alb.fa. Kualifikuar lot 2 Re. farma Kualifikuar lot 5 Re. farma Kualifikuar lot 6 Re. Farma Kualifikuar lot 9 Re. Farma Kualifikuar lot 1 CF.farma Kualifikuar lot 22 Fl.farma Kualifikuar Lot 13 Me.farma Kualifikuar Lot 7 A. Kualifikuar lot 11 BOE Le.&Me.ph. Kualifikuar lot 19 Rani. Kualifikuar lot 10 Ev. Kualifikuar lot 21 Al.farma Kualifikuar lot 16 Al.farma Kualifikuar lot 15 Ator. Kualifikuar lot 13 Tri. Kualifikuar lot 17 Fl.farma Kualifikuar lot 5 Me.pharma Kualifikuar lot 19 Tri.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 4618, datë 18.12.2018 dhe procesverbal datë 18.12.2018, sipas të cilit është realizuar përlllogaritja e fondit. Procedura rezulton të jetë kryer pas rekomandimit të MSHMS për shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2019, e cila me shkresën nr. 4364, datë 04.12.2018, i ka dhënë të drejtën SRSH të prokurimit të Barnave, si rezultat i mos mbulimit të nevojave nga marrëveshja kuadër aktuale.

**** **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.01.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës, ka rezultuar se janë paraqitur 22 oferta për 23 lote, duke mbetur pa realizuar vetëm loti nr. 3, për medikamentin paracetamol.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 07.02.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 07.02.2019, janë miratuar procedurat duke u shpallur fituese 20 OE dhe lidhur kontrata me afat 365 ditë kalendarike.

Për këtë prokurim ka pasur vetëm një ankesë nga Operatori nëv.ò SHPK, me adresë: Shkodër, paraqitur nëpërmjet SPE dhe e-mail në datë 05.02.2019 dhe protokoll nr.438, datë 05.02.2019, ankim për të cilin me urdhër të Titullarit të AK me nr.461, datë 06.02.2019, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave të cilët kanë shqyrtuar ankesat pasqyruar në proces-verbal datë 11.02.2019, pjesë e dosjes së tenderit dhe kthyer përgjigje ankuesit me nr. 543/ prot, date 12.02.2019.

Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur për tu audituar 8 lote dhe konkretisht: loti 1, 3, 5, 8, 11, 15, 16 dhe 19, duke rezultuar me mangësi lotët si vijon:

Loti nr. 1

Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se për **Lotin nr. 1 “Cefazolinë”** kanë marrë pjesë 2 (dy) operator pjesëmarrës janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE, dhe konkretisht:

Nr.	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	INC.	0	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar nga AK, përveç ekstraktit historik të regjistrit tregtar, nga QKB
2.	CF. Ph.	600,000	Kualifikuar dhe Shpallur Fitues

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE nëCF. Ph. .ò SHPK, me vlerë oferte prej 600,000 lekë pa TVSH, nga 601,576 lekë të prokuruar, ose më pak për vlerën prej 1,576 lekë.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 26.4.2019 ka shpallur fituese 20 OE e shoqërisë OE nëCF. Ph. .ò SHPK, me vlerë oferte prej 600,000 lekë pa TVSH dhe lidhur kontrata me afat 365 ditë kalendarike.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues nëCF. Ph. .ò SHPK**, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kandidati/ofertuesi duhet të 2.3 duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga OE rezulton se është ngarkuar në SEP faturën tatimore të shitjes nr. 57112, datë 01.02.2018, për vlerën prej 120 milion lekë, për palën blerëse PH. PL. . Kjo faturë nuk përbën furnizime të mëparshme të ngjashme përsa artikulli CEFA. nuk përfshihet në faturë, apo anti-infektivë të përgjithshëm të së njëjtës familje apo grup familje.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në CF. PH. SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “CF. PH. .”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të KISHTE anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, **si dhe vlera e kontraktuar prej 600,000 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te})**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr.

Loti nr. 3 dhe nr. 8

Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se për **Lotin nr. 3 “Ge. Sul.” dhe nr. 8 Ca. Chl.** ka marrë pjesë një operator pjesëmarrës i kualifikuar, dhe konkretisht:

Nr.	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	Me.ph.	524,450	Kualifikuar dhe Shpallur Fitues

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** në Me. Ph. SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kandidati/ofertuesi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në

rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga OE rezulton se është ngarkuar në SEP dokumentin nr. 877/1, datë 09.2.2017, lëshuar për shoqërinë nMe. Ph.ò nga Drejtori i Përgjithshëm i QSU nNënë Terezaò, për zbatimin e kontratës nr. 912/32, datë 19.2.2017. Kjo faturë nuk përbën furnizime të mëparshme të ngjashme përse artikulli Gen.Sulph. nuk përfshihet në faturë.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE nMe. PHA.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 nShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 nPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet nAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “ME. PH.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të KISHTE anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, **si dhe vlera e kontraktuar prej 524,450 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të})**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr.

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit nBlerje medikamente MK e ndare në 23 lote - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara -me afat 1 vjeçar (12 muaj)ò.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.01.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit/ve. Sipas këtij Raporti përmbledhës, ka rezultuar se janë paraqitur 22 oferta për 23 lote, duke mbetur pa realizuar vetëm loti nr. 3, për medikamentin paracetamol. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 07.02.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 07.02.2019, janë miratuar procedurat duke u shpallur fituese 20 OE dhe lidhur kontrata me afat 365 ditë kalendarike. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur për tu audituar 8 lote dhe konkretisht: loti 1, 3, 5, 8, 11, 15, 16 dhe 19, nga ku ka rezultuar se për lotin 1, 3 dhe 8 OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kërkesat sipër DST dhe konkretisht: Loti nr. 1 Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se për Lotin nr. 1 “Cef.” kanë marrë pjesë 2 (dy) operator pjesëmarrës janë skualifikuar 1 OE (IN.) dhe kualifikuar 1 OE (C. Pha.), dhe konkretisht:

	Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñC. Pha.ò SHPK dhe lidhur kontrata me vlerë oferte prej 600,000 lekë pa TVSH, nga 601,576 lekë të prokuruar, ose më pak për vlerën prej 1,576 lekë, me afat 365 ditë kalendarike. **** Lidhur me OE të shpallur fitues ñC. Pha. .ò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të 2.3 duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Nga OE rezulton se është ngarkuar në SEP faturën tatimore të shitjes nr. 57112, datë 01.02.2018, për vlerën prej 120 milion lekë, për palën blerëse PHA. PL. . Kjo faturë nuk përbën furnizime të mëparshme të ngjashme përsa artikulli CEFA. nuk përfshihet në faturë, apo anti-infektivë të përgjithshëm të së njëjtës familje apo grup familje. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñC.PH.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 <i>“Shqyrtimi i ofertave”</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 <i>“Për prokurimin publik”</i>, i ndryshuar ku citohet <i>“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”</i> dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “CF. PH. .”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të KISHTE anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar prej 600,000lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E të), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” Loti nr. 3 dhe nr. 8 Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton
--	---

	se për Lotin nr. 3 “Ge. S.” dhe nr. 8 C. Ch. ka marrë pjesë një operator pjesëmarrës i kualifikuar (ME.PHARMA). **** Lidhur me OE të shpallur fitues nëM. Pò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të 2.3 duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Nga OE rezulton se është ngarkuar në SEP dokumentin nr. 877/1, datë 09.2.2017, lëshuar për shoqërinë nëMega Pharma nga Drejtori i Përgjithshëm i QSU nëNënë Tereza, për zbatimin e kontratës nr. 912/32, datë 19.2.2017. Kjo faturë nuk përbën furnizime të mëparshme të ngjashme përse artikulli Gentamicine Sulphate nuk përfshihet në faturë. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE nëM. Pò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në<i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në<i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet në<i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “M. P.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të KISHTE anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar prej 524,450 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E të).
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në<i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në<i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet në<i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në<i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet në<i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; si dhe neni 1

	Objekti dhe qëllimi: pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 Parimet e përzgjedhjes: germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 1,124,450 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) .
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 1,124,450 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}).

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga B. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, z. E. V. në cilësinë e kryetarit të KVO znj. A. I. dhe z. A. H. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr., në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/53, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021 në Mbi Projekt raportin e Auditimit nga E. V. , A. I. dhe A. H. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi OE për plotësimin e kriterit për medikamentin Cefaz.ka paraqitur faturë tatimore shitje medikamentesh, si dhe Cefaz. i përket gjeneratës së parë ndërsa Nipo. (nr. 47 në faturë) gjeneratës së dytë dhe bëjnë pjesë te grupi i cefalosporëve, pra e njëjta grup familje.

Për lotet e tjera dokumentacioni i Me.pharma është në përputhje me LPP dhe DST pasi Ge. Sulph. është antibiotic, pra e ngjashme me lotin 10, 21 dhe 244, sipas kontratës paraqitur nga OE.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Lidhur me risqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj mbetet deklarativ, duke mos pasur asnjë dokument që përfshin këto produkte në të njëjtën grup apo familje, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

VI-Tenderi me objekt: Riparim Mirëmbajtje Automjetesh, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Riparim, mirëmbajtje automjetesh		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 4283 Datë 22.11.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.428 dt.27.11.2018	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.4326. Dt 27.11.2018 1.V. B. Kryetar)-juriste

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Negocim pa shpallje paraprake	1 G. N. - sp/prok /ekokryetare 2 V. F. - sp/anetar 3 A. I. i sp/ anetare	2.G. K. -Anëtare (sp jurist) 3.I. C. - Anetar (ing)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,000,000 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 999,000 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 03.12.2018	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S kualifikuar 0, c) Shpallur Fitues: K.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limitn me procesverbal datë 22.08.2018, sipas UB Nr. 2996 prot., datë 15.08.2018. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 22.11.2018 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me Nr. 2996 prot., datë 15.08.2018.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **04.12.2018**, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr.	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	nKA.ò SHPK	990,000	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.12.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 1 operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE nKA.ò SHPK, me vlerë kontrate 990,000 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 12.12.2018 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë nKA.ò SHPK me vlerë kontrate 990,000 lekë, si dhe lidhur kontrata me nr. 4539, datë 13.12.2018, me afat 12 muaj.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues nKA.ò SHPK**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet te ketë karotrec për transportimin e automjeteve me defekt,ne pronësi, ose me qera, i pajisur me (leje qarkullim),akt kolaudimi, policën e sigurimit te mjetit, taksat .

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues nKa.ò SHPK, ka paraqitur kontratën e qirasë, bërë para noterit Hoxha, me nr. rep. 441 dhe kol. 110/1, datë 12.02.2018, lidhur ndërmjet qiradhënësit nB.Z.ò, dhe qiramarrësit nKA.ò SHA, me objekt,

Ë marrjen me qira të mjetit me targa AA771IXò, me afat qiraje 5 vjet. Dokumenti i ngarkuar në SEP është i pa shoqëruar me dokument e përcaktuara në DST si akt kolaudimi, policen e sigurimit të mjetit, taksat, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK në DST.

Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet të vërtetojnë me një deklaratë që disponojnë makineri pajisje të nevojshme bashkohore përrealizim të kontratës, si vijon:

- Ure ngritëse me lartësi të përshtatshme me autoambulanca
- Te këtë repart për punimet elektrike (elektroauto)
- Te këtë repart për punime gjenerike
- Te këtë repart motorist-pompist
- Te këtë pajisje elektronike për kontrollin teknik të mjeteve.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues në KA.ò SHPK, ka paraqitur deklaratën datë 03.12.2018, por sipas deklaratës sa kërkuar nga AK në DST disponohen prej OE vetëm në 3 pika të cilat nuk kanë lidhje apo afërsi me SRSH dhe konkretisht 2 pika në Tiranë dhe 1 në Elbasan, duke mos u kuptuar se si do realizohet zbatimi i kontratës të riparimit të mjeteve.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në KA.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në Shqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në Për prokurimin publik, i ndryshuar ku citohet në Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, G. K. dhe I. C. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. RR. .

Konkluzioni: Referuar sa më sipër, kualifikimi i shoqërisë “KA.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 999,000 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të}), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, G. K. dhe I. Ç. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. RR. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Riparim Mirëmbajtje Automjeteshò.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 04.12.2018, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor). Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.12.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se ka pasur vetëm 1 operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE në KA.ò SHPK, me vlerë kontrate

	990,000 lekë dhe lidhur kontrata me nr. 4539, datë 13.12.2018, me afat 12 muaj. **** Lidhur me OE të shpallur fitues ñKA.ò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet te ketë karotrec për transportimin e automjeteve me defekt, ne pronësi, ose me qera, i pajisur me (leje qarkullim),akt kolaudimi, policën e sigurimit te mjetit, taksat. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñKa.ò SHPK, ka paraqitur kontratën e qirasë, bërë para noterit H., me nr. rep. 441 dhe kol. 110/1, datë 12.02.2018, lidhur ndërmjet qiradhënësit ñB. ZA.ò, dhe qiramarrësit ñKA.ò SHA, me objekt, ñMarrjen me qira të mjetit me targa AA...IXò, me afat qiraje 5 vjet. Dokumenti i ngarkuar në SEP është i pa shoqëruar me dokument e përcaktuara në DST si akt kolaudimi, policen e sigurimit te mjetit, taksat, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK në DST. <u>Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet te vërtetojnë me një deklaratë qe disponojnë makineri pajisje te nevojshme bashkohore për realizimin e kontratës, si vijon: - Ure ngritëse me lartësi te përshtatshme me autoambulanca - Te ketë repart për punimet elektrike(elektroauto) - Te ketë reparte për punime gjenerike - Te ketë repart motorist-pompist - Te ketë pajisje elektronike për kontrollin teknik te mjeteve. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñK.ò SHPK, ka paraqitur deklaratën datë 03.12.2018, por sipas deklaratës sa kërkuar nga AK në DST disponohen prej OE vetëm në 3 pika të cilat nuk kanë lidhje apo afërsi me SRSH dhe konkretisht 2 pika në Tiranë dhe 1 në Elbasan, duke mos u kuptuar se si do realizohet zbatimi i kontratës të riparimit të mjeteve. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñKA.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “KA. ”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e
--	--

	<i>saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 999,000lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{te}), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.</i>
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> ; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> ; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> , të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 990,000 lekë, për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{te}) .
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 990,000 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{te}) .

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, G. K. dhe I. Ç. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. T. Rr. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për vitin 2019, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2019 - 31.12.2019;
- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);
- Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/ dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila strukturë përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka SRSB për punë, shërbime e mallra, të cilat janë miratuar nga Drejtori i SRSB, për çdo vit, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 në *Për prokurimin publik*, nenet 23 dhe 28; si dhe

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si më poshtë vijon:*

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2019 i 31.12.2019, auditoi 8 procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa tvsh.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varion nga 1 deri në 2 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesimin e paktë të OE edhe pse kriteret që aplikohen nga AK përgjithësisht janë në përputhje me ligjin, llojin dhe natyrën e prokurimit..

-Nga auditimin i 8 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 nëPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveò, ku;

-Në 5 (pesë) procedura, OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike, për vlerën e kontratave prej 14,655,553 lekë.

Procedurat e audituara janë:

Nr.	Objekt prokurimit	Lloji procedurë	Vlera e prokurimit	OE shpallur fitues	Shkelje të LPP	Prokurim të fondeve në kundërshti me 3E ^{-të}	Dëm Ekonomik
1	Blerje ushqimesh	E Hapur	8,883,208	SE. S.	PO	8,194,820	-
2	Blerje kite dhe reagent për SRSH e ndarë në 2 lote	E Hapur	6,299,675	Eu.	JO		-
3	Riparim, mirëmbajta automjetesh	Kërkesë për propozim	2,078,000	KA.	PO	1,980,500	-
4	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike nga roje private	Kërkesë për propozim	6,141,012	MI.	JO		-
5	Blerje shtypshkrime	Kërkesë për propozim	1,249,999	RA.-GR.	PO	JO	-
6	Shërbimi i Impiantistikës	Kërkesë për propozim	4,496,261	N. 2014 & NI.	PO	4,480,233	-
7	Blerje kite dhe reagent për SRSH e ndarë në 2 lote	Kërkesë për propozim	4,982,626	S.	JO		-
8	Blerje detergjentë të ndryshëm	Kërkesë për propozim	2,496,261	Di.	PO	JO	-
	Totali		36,627,042			14,655,553	-

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

I-Tenderi me objekt: “Riparim, mirembajtje automjetesh”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Riparim, mirembajtje automjetesh per Spitalin Rajonal Shkoder		
1.Urdhër Prokurimi Nr 3619 Datë 27.11.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.3619 dt.27.11.2019	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.3723. Dt 12.12.2019 1.E. V. Kryetar -(Ekonomiste) 2.V. F. Anetar (Inxhinier) 3.E. H. - Anetare (Ekonomiste)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kerkese me propozim	1.V. B. - Ekonomiste 2.S. K. - Juriste 3.I. C.İ Inxhinier	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2 078 000 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) Lot 2 :1 980 500 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 97 500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.12.2019	9.Burimi Financimit Të ardhurat dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.2 (dy)OE b)Skualifikuar 0 OE a) Kualifikuar 1(nje) OE ôôKa. sh.a ôô

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nëMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 18.08.2019, sipas UB nr. 3216 prot., datë 15.08.2019. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 27.11.2019 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me Nr. 3216 prot., datë 15.08.2019.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **13.12.2019**, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	ñKA.ò SHPK	1,980,500	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 24.12.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 1 operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñKA.ò SHPK, me vlerë kontrate 1,980,500 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 26.12.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñKA.ò SHPK me vlerë kontrate 1,980,500 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 97,500 lekë si dhe lidhur kontrata me nr. 3704, datë 10.12.2019, me afat 12 muaj.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues** ñKA.ò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi shoqëruar me (Certifikatëpronësisë)ose me qera shoqëruar me(kontrate qeraje e noterizuar),ambiente për ushtrimin e aktivitetit të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) në qytetin e Shkodrës ose pike kontakti (servis)në kete qytet shoqëruar me dokumentetpërkatëse.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñKa.ò SHPK, ka paraqitur kontratën e qirasë, bërë para noterit M. P. , me nr. rep. 552 dhe kol. 119/1, datë 25.02.2017, lidhur ndërmjet qiradhënësit ñS.-Se.ò SHPK, dhe qiramarrësit ñKA.ò SHA, me objekt, ñMarrjen me qira të repartit të autoriparimit të mjeteve me motor në servis që ndodhet në adresën Shkodër Bushat, ndërtesa me nr. 87/64, zk nr. 1329ò, me afat qiraje deri më 04.01.2020. Dokumenti është i pa shoqëruar me dokument pronësie, si dhe në kontratë nuk bëhet përshkrimi i tij, duke mos u kuptuar se cilin ambient ka marrë me qira OE, a është qiradhënësi pronar i tij, i vetëm apo nëse e ka me qira a i lejohet atij nënkontraktimi.

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet të ketë karrotrec për transportimin e automjeteve me defekt,në pronësi, ose me qera, i pajisur me (leje qarkullim),akt kolaudimi,policen e sigurimit të mjetit, taksat.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñKa.ò SHPK, ka paraqitur kontratën e qirasë, bërë para noterit H. , me nr. rep. 441 dhe kol. 110/1, datë 12.02.2018, lidhur ndërmjet qiradhënësit ñB. ZA.ò, dhe qiramarrësit ñKA.ò SHA, me objekt, ñMarrjen me qira të mjetit me targa AA...IXò, me afat qiraje 5 vjet. Dokumenti i ngarkuar në SEP është i pa shoqëruar me dokument e përcaktuara në DST si akt kolaudimi, policen e sigurimit të mjetit, taksat, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK në DST.

Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet të vërtetojnë me një deklaratë që disponojnë makineri pajisje të nevojshme bashkohore përrealiziminë kontratës, si vijon:

- Urëngritëse me lartësi të përshtatshme me autoambulanca
- Te këtë repart për punimet elektrike(elektroauto)
- Te këtë reparte për punime gjenerike
- Te këtë repart motorist-pompist
- Te këtë pajisje elektronike për kontrollin teknik të mjeteve.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñKa.ò SHPK, ka paraqitur deklaratën datë 03.12.2018, por sipas deklaratës sa kërkuar nga AK në DST disponohen prej OE vetëm në 3 pika të cilat nuk kanë lidhje apo afërsi me SRSH dhe konkretisht 2 pika në Tiranë dhe 1 në Elbasan, duke mos u kuptuar se si do realizohet zbatimi i kontratës të riparimit të mjeteve.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñKA.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertave” të ligjit

9643, datë 20.11.2006 në *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet në *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga E. V. , në cilësinë e kryetarit të KVO, V. F. dhe E. H. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “KA.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, **si dhe vlera e kontraktuar prej 1,980,500 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te})**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: E. V. , në cilësinë e kryetarit të KVO, V. F. dhe E. H. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A.D. .**

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Riparim, mirëmbajtje automjesh .
Situata:	Me procesverbalin e datës 13.12.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 24.12.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se ka pasur vetëm 1 operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE në KA.0 SHPK, me vlerë kontrate 1,980,500 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 97,500 lekë si dhe lidhur kontrata me nr. 3704, datë 10.12.2019, me afat 12 muaj. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në KA.0 SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet të ketë karotrec për transportimin e automjeteve me defekt, ne pronësi, ose me qera, i pajisur me (leje qarkullim), akt kolaudimi, policen e sigurimit të mjetit, taksat. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues në KA.0 SHPK, ka paraqitur kontratën e qirasë, bërë para noterit H. , me nr. rep. 441 dhe kol. 110/1, datë 12.02.2018, lidhur ndërmjet qiradhënësit në B. ZA.0, dhe qiramarrësit në KA.0 SHA, me objekt, në Marrjen me qira të mjetit me targa AA...IX0, me afat qiraje 5 vjet. Dokumenti i ngarkuar në SEP është i pa shoqëruar me dokument e përcaktuara në DST si akt kolaudimi, policen e sigurimit të mjetit, taksat, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar nga AK në DST. <u>Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika</u>

	2.3. “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet të vërtetojnë me një deklaratë që disponojnë makineri pajisje të nevojshme bashkohore për realizimin e kontratës, si vijon: - Ure ngritëse me lartësi të përshtatshme me autoambulanca - Te këtë repart për punimet elektrike(elektroauto) - Te këtë repart për punime gjenerike - Te këtë repart motorist-pompist - Te këtë pajisje elektronike për kontrollin teknik të mjeteve. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues në KA.0 SHPK, ka paraqitur deklaratën datë 03.12.2018, por sipas deklaratës së kërkuar nga AK në DST disponohen prej OE vetëm në 3 pika të cilat nuk kanë lidhje apo afërsi me SRSH dhe konkretisht 2 pika në Tiranë dhe 1 në Elbasan, duke mos u kuptuar se si do realizohet zbatimi i kontratës të riparimit të mjeteve. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titulli nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në KA.0 SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i>” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “KA.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 1,980,500 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> të pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> të germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave</i>, të miratimit të rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të

	përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 1,980,500 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te})
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijo me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 1,980,500 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}) .

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga E. V. , në cilësinë e kryetarit të KVO, V. F. dhe E.H. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/57, datë 21.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.05.2021 “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga E. V. , V. F. dhe E. H. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prentedimi i subjektit:KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi OE për plotësimin e kriterit për ambientin me qira OE ka paraqitur kontratë qiraje me nr. 2730 rep dhe 623/2 kol, datë 30.10.2009; për karoatrec ka paraqitur kontratë qiraje me “Be. Z.”, ndërsa për vërtetimin e disponimet të makinerive ka paraqitur deklaratën e disponimit nr. 13.12.2019.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me ri sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit referuar dokumentacionit të paraqitur në këtë fazë por dhe gjatë kundërshtimit të akt konstatimit, eka marrë pjesërisht në konsideratë për servisin e marrë me qira nga ñS. Se.ò, përse i përket dokumentacionit dhe nuk i ka marrë në konsideratë për dy mangësitë e tjera për të cilat përsëri nuk keni sjellë asnjë dokument, duke mbetur në nivel deklarativ.

Observacioni i bërë nuk merret në konsideratë.

II-Tenderi me objekt: Blerje ushqime per Spitalin Rajonal Shkodër, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje ushqime per Spitalin Rajonal ShkoderMarrëveshjeKudër me një operatore ekonomik -me afat 1 vjeçar (12 muaj)		
1.Urdhër Prokurimi nr. 33 datë 01.02.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit 1.G. N. -Kryetare sp/prokurimesh/ Juriste 2.P. N.- Anetare sp/prokurimesh/ekonomiste 3.N. Sh. Anetare sp/sektori hotelerie	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.778. Dt 28.02.2019 1.V. B. (Kryetare) pergj/prokurimesh 2. E. A. Anetar sp/sektori statistikave 3 N. B. Anetar infermier /kujdesi palativ
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedur e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8 883 208 leke Shumatorja e çmimeve per	6.Oferta fituese (pa tvsh) 8 194 820 <i>leke</i> Shumatorja e cmimeve per njesi 3072	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 688 388 lekë

njesi 3958.5		
8. Data e hapjes së tenderit 04.03.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Nr. 2OE b) Sëkualifikuar NI. SHPK c) Kualifikuar në SE. S.ò
11. Ankimime AK-ka; DATE 11.03.2019 APPi saka/ka; KPP-saka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. 949 prot, date 13.03.2019 Nr. ____/____ prot, date _____.20__	13. Përgjigje Ankesës nga APP nr. Prot _____, date _____.20__ apo KKP nr. prot, date _____, date _____.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 4594, datë 17.12.2018 dhe urdhrin nr. 4644, datë 20.12.2018, sipas të cilit është realizuar përlllogaritja e fondit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 07.02.2019 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

**** **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 24.03.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	në SE. S.ò SHPK	8,194,820	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	NI.	7,289,570	Skualifikuar Arsyet e Skualifikimit: -Formulari i ofertes jo sipas DST -Mungese e kontrollit të fundit nga AKU -Mungese e dokumentacioni që verteton që automjeti është frigoriferik). -Mungese e Xhiros 2018 -Certifikata e dezefektimit jo për të gjithë ambientet .Etj.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 04.03.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës, ka rezultuar se ka paraqitur ofertë vetëm 2 OE, është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar OE i shpallur fitues dhe konkretisht në SE. S.ò SHPK.

Mbi vlerësimin e KVO ka paraqitur ankesë OE në NI.ò SHPK, me **nr.915, date 11.03.2019, ankesë për të cilën Titullari i AK me Urdhrin e Brendshëm nr. 296, datë 11.3.2019** ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesave të cilët kanë shqyrtuar ankesat pasqyruar në proces-verbal datë 13.03.2019 pjesë e dosjes së tenderit dhe është kthyer përgjigje me nr. 949 prot, date 13.03.2019.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 27.03.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 27.03.2019, janë miratuar procedurat duke shpallur fituese OE dhe lidhur kontrata, nr. 1251, datë 02.04.2019 për vlerën prej 8,194,820 lekë, ose më pak se fondi limit prej 688,388 lekë, me afat 365 ditë kalendarike.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** ñSE. S.ò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 20000:2018.

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñS. S.ò SHPK, ka certifikatën ISO 20000:2005 të lëshuar nga AQSCERT, datë 16.02.2017, certifikim i cili është i të njëjtit grup por me standard më të vjetër se ai i kërkuar nga AK në DST, duke mos plotësuar kriterin për ISO ISO 20000:2018

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Për artikullin Vezë, OE duhet të paraqesë kontratë furnizimi me shoqërinë prodhuese të produktit. Leja Higjeno Sanitare dhe Licenca nga QKL.

Për plotësimin e këtij kriteri OE i shpallur fitues nuk ka ngarkuar në SEP asnjë dokument të vlefshëm. Tre kontrata furnizimi konkretisht me òAD.ò, òEL. 1ò dhe òB. G.ò, asnjë nuk përshkruan artikullin e përcaktuar veças në DST, duke mos plotësuar këtë kriter të AK.

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.Operatori ekonomik i kualifikuar ñSE.-S.ò SHPK, nuk plotëson kriterin:

Magazinë ushqimore në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale,e përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuar të pajisur me leje Higjeno-Sanitare, tekniko teknologjike si dhe Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Magazina nuk është e pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñSA. S.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A. dhe N. B. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SA. S.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, si dhe skualifikimi i OE me ofertë më të favorshme por me të njëjta kushte përsa i përket mangësive në dokumentacion ka sjellë për **pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{të})**, për vlerën prej 8,194,820lekë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A. dhe N. B. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit ñBlerje ushqime për Spitalin Rajonal Shkodërò.
-------------------------	---

Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 24.03.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 04.03.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë vetëm 2 OE, është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës 27.03.2019, dhe Vendimit të titullarit të AK datë 27.03.2019, janë miratuar procedurat duke shpallur fituese OE në SE. S.ò SHPK dhe lidhur kontrata, nr. 1251, datë 02.04.2019 për vlerën prej 8,194,820 lekë, me afat 365 ditë kalendarike. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në SE. S.ò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë të sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 20000:2018. Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues në SA. S.ò SHPK, ka certifikatën ISO 20000:2005 të lëshuar nga AQSCERT, datë 16.02.2017, certifikim i cili është i të njëjtit grup por me standard më të vjetër se ai i kërkuar nga AK në DST, duke mos plotësuar kriterin për ISO 20000:2018 <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Për artikullin Vezë, OE duhet të paraqesë kontratë furnizimi me shoqërinë prodhuese të produktit. Leja Higjieno Sanitare dhe Licenca nga QKL. Për plotësimin e këtij kriteri OE i shpallur fitues nuk ka ngarkuar në SEP asnjë dokument të vlefshëm. Tre kontrata furnizimi konkretisht me 0AD.ò, 0ELL. 1ò dhe 0B. G.ò, asnjë nuk përshkruan artikullin e përcaktuar veças në DST, duke mos plotësuar këtë kriter të AK. <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.</u> Operatori ekonomik i kualifikuar në SE.-S.ò SHPK, nuk plotëson kriterin: Magazinë ushqimore në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale, e përshatshme për magazinimin e mallrave të kërkuar të pajisur me leje Higjieno-Sanitare, tekniko teknologjike si dhe Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Magazina nuk është e pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në SA. S.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53
------------------------	--

	Shqyrtimi i ofertave të ligjit 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publik, i ndryshuar ku citohet Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SA. S.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, si dhe skualifikimi i OE me ofertë më të favorshme por me të njëjta kushte përsa i përket mangësive në dokumentacion ka sjellë për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}), për vlerën prej 8,194,820 lekë.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 Shqyrtimi i ofertave të ligjit 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publik, i ndryshuar ku citohet Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publik, i ndryshuar ku citohet Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 Objekti dhe qëllimi pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 Parimet e përzgjedhjes germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 8,194,820 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}) .
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSH, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSH, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 8,194,820 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}).

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga V. B. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A. dhe N. B. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/56, datë 21.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021 në Mbi Projekt raportin e Auditimit nga V. B. dhe E. A. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi OE ka certifikim ISO të të njëjtit grup, por me standart më të vjetër se ai i kërkuar nga AK në DST; në lidhje me plotësimin e pikës 2.3.7, OE ka ngarkuar në SEP të gjithë dokumentacionin e kërkuar; si dhe në lidhje me magazinën ushqimore, OE ka paraqitur kontratë qiraje, dokument nga QKB dhe Akti miratimi Higjeno-Sanitar me aktivitet magazinë ushqimore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit si për certifikimin ISO ashtu edhe për mungesën e licencimit për magazinën të lëshuar nga QKL, nga nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj vijon të mbetet deklarativ, duke mos u mbështetur në dokumente konkrete, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

III-Tenderi me objekt: Blerje shtypshkrime, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje shtypshkrime		
1.Urdhër Prokurimi Nr.65 datë	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kerkese me propozim	Urdhër Nr.65 dt.05.04.2019 1 V. B.- pegj/prok /eko 2 G. N. - sp/jurist/anetare 3 B. J.- inf/ anetar	Urdhër Nr.1433. Dt 18.04.2019 1S. K. .Kryetar -(sp/prok) 2.E. P. Anetare (inf) 3 L. Z. Anetare (eko)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,249,999 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 1,150,215 leke	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 99,784 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.04..2019	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.4 OE b) Sëkualifikuar Ad., c) Kualifikuar Inp. c Kualifikuar Kr.-KH d) Shpallur Fitues OE/ RA.-GR.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni në Mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe për llogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 29.03.2019, sipas UB nr. 861 prot., datë 06.03.2019. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 10.04.2019 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me 861 prot., datë 06.03.2019.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të prokurimit.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 23.04.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
----	----------	--------	--------------------------

1.	ñRA.-GR.ò SHPK	1,150,216	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	Ad. CO SHPK	Ska ofertë	Skualifikuar
3.	KR. K. SHPK	813,001	Kualifikuar
4.	IN. SHPK	1,248,953	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 06.5.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur 4 operatorë pjesëmarrës, duke skualifikuar 1 dhe kualifikuar 3 OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñRA.-GR.ò SHPK, me vlerë kontratë 1,150,215 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 06.05.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñRA.-GR.ò SHPK me vlerë kontrate 1,150,216 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 99,784 lekë si dhe lidhur kontrata me nr1654, datë 10.05.2019, me afat 12 muaj.

Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike ñKRI. KHò SHPK me vlerë oferte prej 813,001 dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE ñRA.-GR.ò SHPK me vlerë ofertë prej 1,150,216 lekë, ***përbën efekt financiar negativ për SRSB në vlerën 337,215 lekë***, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, veprime ***të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: S. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. P. dhe L. Z. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .***

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** ñRA.-GR.ò SHPK, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik fitues RA.GR. nuk ka plotësuar Shtojcën mbi **Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.**

(Shih foto nr. 4 dhe nr. 5 në aneksin bashkëlidhur RPA)

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñRA.GR.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga S. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. P. dhe L. Z., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “RA.-GR.”, ***nuk*** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet KVO, duhet të kishte propozuar OE të radhës apo në mungesë të garës duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ***të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: S. K. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. P. dhe L. Z. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .***

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Blerje shtypshkrime .
Situata:	-Zhvillimi i procedurës. Me procesverbalin e datës 23.04.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 06.5.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 3 operatorë pjesëmarrës dhe skualifikuar 1 OE. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE në RA.-GR.ò SHPK, me vlerë kontrate 1,150,215 lekë dhe lidhur kontrata me nr. 1654, datë 10.05.2019, me afat 12 muaj. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike në KR. KHò SHPK me vlerë oferte prej 813,001 dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE në RA.-GR.ò SHPK me vlerë ofertë prej 1,150,216 lekë, përbën efekt financiar negativ për SRSH në vlerën 337,215 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në RA.-GR.ò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: Operatori ekonomik fitues RA.GR. nuk duhet të ishte kualifikuar sepse nuk ka plotësuar sakte Shtojcën mbi Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, është e paplotësuar. <i>(Shih foto nr. 4 dhe nr. 5 në aneksin bashkëlidhur)</i> Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në RA.GR.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publikò</i>, i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa më sipërm, kualifikimi i shoqërisë “RA.-GR.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, si dhe shpallje fitues në procedurë duhet të ishte bërë për OE me ofertë më të favorshme ekonomike në K. K.ò SHPK.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publikò</i>, i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e</i>

	<i>përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në Për prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet në Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 në Objekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në Parimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.</i>
Shkak:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet kur oferta ekonomike e paraqitur rezulton më e lartë se një tjetër operatori të kualifikuar, me arsyetimin se shumatorja e çmimeve për njësi e OE të shpallur fitues është më e ulët, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ, përbën efekt financiar negativ për SRSH në vlerën prej 337,215 lekë (si diferencë ndërmjet ofertës ekonomike të OE të shpallur fitues në RA.-GR.ò SHPK dhe asaj më të favorshme në K. Kò SHPK).
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSH, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSH, të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të analizoj efektin financiar negativ për SRSH në vlerën prej 337,215 lekë.

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga S. K., në cilësinë e kryetarit të KVO, E. P. dhe L. Z., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D., në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/47, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021 në Mbi Projekt raportin e Auditimitò nga L. Z. , E. P. dhe ish-Titullari i AK z. A. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, duke ju referuar udhëzimit të APP nr. 15, datë 26.11.2018, pika 1, sipas të cilit “Në rastet kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj oferta nga OE do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi për efekt krahasimi vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlllogaritur për çdo artikull apo shërbim. Referuar udhëzimit OE RA.-GR. paraqitet me ofertë më të ulët me shumatoren e çmimeve për njësi 2975 lekë, krahasuar kjo me ofertën e shumatores së çmimeve për njësi 5481.4 lekë të OE K.-K.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, përsa i përket dëmit ekonomik të shkaktuar, grupi i auditimit e ka marrë në konsideratë duke e vlerësuar dhe trajtuar si **efekt financiar negativ për SRSH në vlerën 337,215 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi pavarësisht se për çmimin për njësi oferta ka rezultuar më e ulët në total rezulton më e lartë se ajo e kualifikuar por jo e shpallur si më e favorshme ekonomikisht. Përsa i përket mosplotësimit të **Deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të**

përgjithshme, kundërshtimi nuk është marrë në konsideratë për faktin se vijon të mbetet deklarativ, duke mos pasur asnjë dokument apo referim konkret, prandaj observacioni do të merret pjesërisht në konsideratë duke bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

IV-Tenderi me objekt: “Shërbim i impiantistikes”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim i impiantistikes” Marrëveshje kuadër me një operatore ekonomik, ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara , me afat 12 muaj.		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kerkese me propozim	Urdhër Nr.168 dt.18.09.2019 1I. C. - Ing 2 V. B. -Pergj/ Ekonomist 3G. N. sp/- Jurist	Urdhër Nr.3036. Dt 26.09.2019 1 E. V. Kryetar -(sp./prokurimesh) 2.N. Sh. Anetare (sp/hoteleie) 3 Dh. K. Anetare (ing)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,496,261 leke pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) 4,480,233 leke pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 16,028 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit 30.09.2019	9.Burimi Financimit Te ardhura dytesore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.4 OE b) Sëkualifikuar Bl. OE, c) Sëkualifikuar D.Im. OE ç)Sëkualifiku BOE Rr. Gu.&V.A.S Kon. d) Shpallur Fitues/BOENdë. 2014 &Ni. Shpk
11.Ankimime AK-sëka/ka; APPi ka rekomandim; 2988 prot.date 20.09.2019 KPP-sëka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK shtojce ne DST Nr. prot,2999 date 23.09.2019 Nr.____/____ prot, date _____.20__	13.Përgjigje Ankesës nga APP nr. Prot _____, date _____.20__ apo KKP nr. prot, date _____, date _____.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nëmbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 24.05.2019, sipas UB nr. 1993 prot., datë 03.06.2019 dhe 1993/1, datë 28.6.2019. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 10.04.2019 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me UB nr. 1993 prot., datë 03.06.2019 dhe 1993/1, datë 28.6.2019.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të prokurimit.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 30.09.2019, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	N 2014 & N.	4,480,233	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	Bl.	3,585,622	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit

			Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
3.	De. Im.	3,940,000	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
4.	Rr. Gu.& VA. Kon.	3,761,555	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 10.10.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 4 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 3 dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm 1 OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE ñN.& NI.ò SHPK, me vlerë kontrate 4,480,233 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 09.08.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñN.& NI.ò SHPK me vlerë kontrate 4,480,233 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 16,028 lekë si dhe lidhur kontrata me nr. 3437, datë 04.11.2029, me afat 12 muaj, për vlerën 2 620 348.75 lekë pa TVSH dhe vlera 3 144 418.50lekë me TVSH dhe nr. prot,1219 datë 10.06.2019 për vlerën 1 812 833.75lekë pa TVSH dhe vlera 2 175 400.50lekë me TVSH.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues ñN.& NI.ò SHPK,** pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listpagesa përperiudhën Janar i Korrik 2019 punonjës të pajisur me kontratë pune, me dëshmi kualifikimi të lëshuara nga organizma të akredituar përkëtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jete të paktën.

1(një) elektrikist

1(një) hidraulik

1(një) teknik ndërtimi

1(një) murator

Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues ñN.& NI.ò SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion për dëshmi kualifikimi të lëshuara nga organizma të akredituar si IQT, por nga trupë certifikuese i cili nuk është institucion i akredituar, duke mosplotësuar kriterin e vendosur nga AK në DST. Specialistët e paraqitur nga NI. , nuk kanë dëshmi kualifikimi për profesionet e tyre por vetëm dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik në punë.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñN.& NI.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñ*Shqyrtimi i ofertave*” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar ku citohet ñ*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga E. V. , në cilësinë e

kryetarit të KVO, N.Sh. dhe Dh. K. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “Ndërt.& NI.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), për vlerën prej 4,480,233 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: E. V. , në cilësinë e kryetarit të KVO, N. Sh. dhe Dh.K. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A.D. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit në Shërbim i impiantistikes .
Situata:	<u>Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 30.09.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 10.10.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 4 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 3 dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm 1 OE. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE në N. & NI. SHPK, me vlerë kontrate 4,480,233 lekë dhe lidhur kontrata me nr. 3437, datë 04.11.2029, me afat 12 muaj, për vlerën 2 620 348.75 lekë pa TVSH dhe vlera 3 144 418.50 lekë me TVSH dhe nr. prot.1219 datë 10.06.2019 për vlerën 1 812 833.75 lekë pa TVSH dhe vlera 2 175 400.50 lekë me TVSH. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në N. & NI. SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: <u>-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5</u> “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: Operatori ekonomik duhet të ketë ne stafin e punonjësve të pasqyruar në listpagesa përperiudhën Janar i Korrik 2019 punonjës të pajisur me kontratë pune , me dëshmi kualifikimi të lëshuara nga organizma të akredituar përkëtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jete të paktën. 1(një) elektrikist 1(një) hidraulik 1(një) teknik ndërtimi 1(një) murator Për plotësimin e këtij kriteri të DST, OE i kualifikuar dhe shpallur fitues në N. & NI. SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion për dëshmi kualifikimi të lëshuara nga organizma të akredituar si IQT, por nga trupë certifikuese i cili nuk është institucion i akredituar, duke mosplotësuar kriterin e vendosur nga AK në DST. Specialistët e paraqitur nga NI. , nuk kanë dëshmi kualifikimi

	për profesionet e tyre por vetëm dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik në punë. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në N. & NI. SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa më sipërm, kualifikimi i shoqërisë “Ndërt. & NI.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), për vlerën prej 4,480,233 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 4,480,233 lekë përprokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) .
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSH, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSH, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 4,480,233 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}).

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga E. V. , në cilësinë e kryetarit të KVO, N.Sh. dhe Dh. K. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/49, datë 20.09.2021 nga E.V. e Dh. K. , dhe nr. 230/52, datë 20.09.2021, nga N. Sh. të administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021. Mbi Projekt raportin e Auditimit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi OE për plotësimin e kriterit ka paraqitur Dëshmi kualifikimi të certifikuar nga TCPE, i cili është i akredituar nga institucionet Shqiptare, <https://tcpe.al/>; si dhe N.Sh. , sipas të cilës me PV. 3036/3, datë 10.10.2019, ka skualifikuar të gjithë OE apo BOE pjesëmarrëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj mbetet deklarativ, duke mos pasur asnjë dokument që Trupa Certifikuese është akredituar apo jo, si dhe për sa i përket deklarimit të N.Sh. , rezulton se (po sipas PV. 3036/3, datë 10.10.2019) ka vlerësuar duke kualifikuar dy OE (përfshirë këtu OE të shpallur fitues) dhe skualifikuar dy të tjerët, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

V-Tenderi me objekt: “Blerje kite dhe reagente për Spitalin Rajonal Shkodër”, me këto të dhëna:

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje kite dhe reagente për Spitalin Rajonal Shkodër		
1.Urdhër Prokurimi Nr 1590 Datë 07.05.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedura e hapur	Urdhër Nr.1590 dt.07.05.2019 1.V. B. - Ekonomiste 2.S. K. - Juriste 3.R. S. i Mjeke laborator	Urdhër Nr.2478. Dt 12.03.2020 1.P. N. Kryetar -(Ekonomiste) 2.E. A. Anëtar (ekonomist) 3.M. S. - Anëtar (Shefe Sherb.Laboratorit)
5.Fondi Limit (pa tvsh) Loti 1: 1 317 050 leke Loti 2: 4 982 625 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 644,845	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 672,205 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.03.2020	9.Burimi Financimit Te ardhurat dytësore	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.3 (kater)OE b) Sëkualifikuar K. c) Sëkualifikuar S. ç) Sëkualifikuar ç) Shpallur Fitues EUR.
11.Ankimime AK-së/ka/ka;Po APPi së/ka/ka; KPP-së/ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. 2231 /__ prot, date 27.06.2019 Nr.____/__ prot, date __.__.20__	13.Përgjigje Ankesës nga APP nr. Prot ____, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date ____, date __.__.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe për llogaritjen e vlerës së fondit limit me procesverbal datë 24.05.2019, sipas UB nr. 1772 prot., datë 20.05.2019. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 24.05.2019 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në

dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me UB nr. 1993 prot., datë 03.06.2019 dhe 1993/1, datë 28.6.2019.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato janë ndryshuar me procesverbalin datë 11.6.2019, sipas rekomandimeve të APP. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të prokurimit.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 13.06.2019, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	EUR.	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	KRI.	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
3.	Sô .	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 13.06.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 3 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 2 dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm 1 OE, për lotin 1 dhe marrë pjesë dy dhe skualifikuar 1 për lotin 2.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñE.ò SHPK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.4.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ñE.ò SHPK me vlerë kontrate 644,845 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 672,205 lekë si dhe lidhur kontrata me nr. 2322, datë 09.7.2020, me afat 12 muaj.

Për këtë procedurë ka ushtruar të drejtën e ankimit edhe OE S., shkresa nr, 2185, datë 24.06.2019, për të cilën Titullari i AK më datë, 25.06.2019 me nr. 2223 prot, ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesave të cilët kanë shqyrtuar ankesat pasqyruar në procesverbal datë 27.06.2019 pjesë e dosjes së tenderit dhe është kthyer përgjigje me shkresën nr. 2231, datë 27.06.2019.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues ñE.ò SHPK**, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për këtë procedurë ka rezultuar së është zhvilluar në 2 lote, nga ku është shpallur fitues i njëjti OE pjesëmarrës, kur si për lotin e parë ashtu edhe për lotin e dytë të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë ñKr.òSHPK dhe ñE.ò SHPK kanë paraqitur dokumentacion dhe ofertë ekonomike të njëjtë, pra të njëjtë si në lotin 1 dhe 2, në këto kushte tenderi duhej të ishte anuluar.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñE.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në

dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga P. N. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A.dhe M. S. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “Euromed”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, të kualifikuar KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: P. N. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A. dhe M. S. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit ñBlerje kite dhe reagente për Spitalin Rajonal Shkodër.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 13.06.2019, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë: Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 13.06.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se ka pasur 3 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 2 dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm 1 OE, për lotin 1 dhe marrë pjesë 2 OE dhe skualifikuar 1 për lotin 2. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ñE.ò SHPK, me vlerë 644,845 lekë, dhe lidhur kontrata me nr. 2322, datë 09.7.2020, me afat 12 muaj. **** Lidhur me OE të shpallur fitues ñE.ò SHPK, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: Për këtë procedurë ka rezultuar së është zhvilluar në 2 lote, nga ku është shpallur fitues i njëjti OE pjesëmarrës, kur si për lotin e parë ashtu edhe për lotin e dytë të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë ñK.ò SHPK dhe ñE.ò SHPK kanë paraqitur dokumentacion dhe ofertë ekonomike të njëjtë, pra të njëjtë si në lotin 1 dhe 2, në këto kushte tenderi duhej të ishte anuluar. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ñE.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ñShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet ñAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. <u>Konkluzioni:</u> Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “E.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, të kualifikuar KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.

Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> "; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i> , i ndryshuar ku citohet në <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i> "; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.</i>
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga P. N. , në cilësinë e kryetarit të KVO, E. A. dhe M.S. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/55, datë 21.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021 në Mbi Projekt raportin e Auditimit nga E. A. dhe M. S. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi kualifikimi u mbështet në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, LPP dhe Udhëzimin nr. 15, datë 26.11.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj mbetet deklarativ, edhe pse oferta ekonomike e paraqitur ka rezultuar e favorshme ekonomikisht, prandaj observacioni i bërë nuk merret në konsideratë.

VI-Tenderi me objekt: “Blerje detergjente te ndryshëm“, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: në Blerje detergjente te ndryshëm		
1.Urdhër Prokurimi Nr.667 Prot Dt. 21.02.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit 1.V. B. - kryetare (ekon.) 2.S. K.- Juriste	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.1049Dt 20.03.2019 1.A. I. Kryetar (ekonomiste) 2. P. N. Anetare (ekonomise)

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kerkes me propozim	3. E. K.	3. K. M. Anetare (juriste)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2 496 261 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) <i>716,400 dhe 851,090 leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 928,771 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 21.03.2019	9.Burimi Financimit TE ARDHURA DYTESORE	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.5 (PESE)OE b) S kualifikuar EU. ME. OE, c) S kualifikuar Mu. D ç) S kualifikuar NI. d) Skualifikuar AT. d) Shpallur Fitues DI.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitn me procesverbal datë 24.05.2019, sipas UB nr. 499 prot., datë 08.02.2019 dhe 499/1, datë 14.2.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 08.03.2019 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me UB nr. 499 prot., datë 08.02.2019 dhe 499/1, datë 14.2.2020.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato janë ndryshuar me procesverbalin datë 08.03.2019, sipas rekomandimeve të APP. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të prokurimit.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 08.03.2019, ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	DIM.	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	ATL.	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
3.	E. 2010	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
4.	MUR.	Skualifikuar Arsyeja e Skualifikimit Mungesë dokumentacioni Teknik e ligjor
5.	NIR.	Skualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 25.03.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 5 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 4 dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm 1 OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE nDI.ò SHPK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.4.2020 ka shpallur fituese ofertën e

shoqërisë nDI.ò, si dhe lidhur kontrata nr. 1323prot, datë 08.04.2019 për vlerën **716 400** lekë dhe nr. 2456prot, datë 24.07.2019, për vlerën **851090** lekë pa TVSH.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues** nDI.ò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik fitues **Di. SHPK** nuk e ka paraqitur Formularin e ofertës ne përputhje me DST-te. Ka paraqitur vetëm preventivin me çmimet për njësi.

(Shih foto nr. 6, nr.7 dhe nr. 8 në aneksin bashkëlidhur)

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE nDI.ò SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 nShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 nPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet nAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga A. I., në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe K. M., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “DI.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të}), për vlerën prej **1,567,490** lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat **ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A. I. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe K. M. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A.D.**

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit nBlerje detergjente te ndryshëmò.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 08.03.2019, ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 25.03.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku ka rezultuar se ka pasur vetëm 5 operatorë, nga të cilët janë skualifikuar 4. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE nDI.ò SHPK dhe lidhur kontrata me nr. 1323 prot, datë 08.04.2019 për vlerën 716 400 lekë dhe nr. 2456 prot, datë 24.07.2019, për vlerën 851090 lekë pa TVSH. **** Lidhur me OE të shpallur fitues nDI.ò SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: Operatori ekonomikfitues Di. SHPK nuk e ka paraqitur Formularin e ofertës ne përputhje me DST-te. Ka paraqitur vetëm preventivin me çmimet

	për njësi. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në DI.0 SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>. Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë "DI.", nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), për vlerën prej 1,567,490 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik".
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>"; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>"; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave</i>, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 1,567,490 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) (Gjerësisht trajtuar në Akt-konstatimet nr. 02, datë 14.05.2021).
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 1,567,490lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}).

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga A. I. , në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe K. M. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/43, datë 15.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/5, datë 29.09.2021 në Mbi Projektraportin e Auditimit nga A. I. dhe K. M. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi formulari i ofertës është plotësuar sipas DST-ve të tenderit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me risqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj mbetet deklarativ, duke mos pasur asnjë dokument që vërteton se formulari i ofertës është plotësuar në të gjithë zërat e tij, prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

Për vitin 2020, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2020 - 31.12.2020;
- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);
- Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/ dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila strukturë përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka SRSH për punë, shërbime e mallra, të cilat janë miratuar nga Drejtori i SRSH, për çdo vit, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 në Për prokurimin publik, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59. Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{-së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si më poshtë vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2020 i 31.12.2020, auditoi 4 procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa tvsh.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varjon nga 1 deri në 2 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesimin e paktë të OE ose kriteret që aplikohen nga AK, edhe pse ato përgjithësisht janë në përputhje me ligjin, llojin dhe natyrën e prokurimit..

-Nga auditimin i 4 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, në Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 1 në Objektin dhe qëllimin pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në Parimet e përzgjedhjes germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ku;

a- Në 1 (një) nga Titullari i AK dhe Njësia e Prokurimit është bërë copëzimi i fondeve.

b- Në 1 (një) procedurë, OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike, për vlerën e kontratave prej 8,310,000 lekë.

Procedurat e audituara janë:

Nr.	Objekt prokurimit	Lloji procedurë	Vlera e prokurimit	OE shpallur fitues	Shkelje të LPP	Prokurim të fondeve në kundërshti me 3E ^{-të}	Dëm Ekonomik
1	Blerje pajisje mjekësore për SRSH	E hapur	8,322,000	Al.Ph	PO	8,310,000	JO
2	Blerje materiale pastrimi	Kërkesë për propozim	1,625,000	At. 3	JO	JO	JO
3	Blerje kite dhe reagentë e ndarë në 2 lote	Kërkesë për Propozim	4,971,690	K. E.	JO	JO	JO
4	F.V Pompë Vakumi	Kërkesë për Propozim	1,488,000	E.	JO	JO	JO
5	Blerje Ushqime 2020 Lot 1 Ushqime koloniale; Lot 2 Buke Gruri; Lot 3 Bulmeti; Lot 4 Mish Vici; dhe Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj	Blerje e Vogël			PO	PO	JO
	Totali		16,406,690			8,310,000	

Për çdo procedurë të audituar, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

I-Tenderi me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ñBlerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër”		
1.Urdhër Prokurimi Nr 495 Datë 18.02.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.495 dt.18.02.2020 1.V. B. - Ekonomiste 2.G. N. - Juriste 3.G. U. i Inxhinier	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.721. Dt 12.03.2020 1.A. D. Kryetar -(Radiolog) 2.S. R. Anetare (ekonomist) 3.G.G. - Anëtare (Koordinatorë cilësie)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8 322 000 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 8 310 000 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 12,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.03.2020	9.Burimi Financimit Te ardhurat dytesore	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.4 (kater) OE b) Sëkualifikuar MED. c) Sëkualifikuar MO. ç) Sëkualifikuar O.E.S DIS. ç) Shpallur Fitues AL.P.

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni nëmbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitit me procesverbal datë 19.01.2020, sipas UB nr. 3546 prot., datë 18.11.2019. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit. Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 19.02.2020 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga Komisioni i posaçëm, i ngritur me 861 prot., datë 06.03.2019.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar. Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të prokurimit..

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 25.03.2020, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	AL.P.	8,310,000	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	Me.	Ska ofertë	Skualifikuar
3.	Mo.	Ska ofertë	Skualifikuar
4.	OE. Dis.	6,730,000	Skualifikuar PSE jepni arsyet dhe shprehuni a qëndrojnë apo jo nga auditimi i kryer

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 10.4.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 4 operatorë pjesëmarrës nga të cilët janë skualifikuar dhe kualifikuar fituesi.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE në AL.P. SHPK, me vlerë kontrate 8,310,000 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 10.04.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në AL.P. SHPK me vlerë kontrate 8,310,000 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 12,000 lekë si dhe lidhur kontrata me nr.949, datë 23.04.2020, me afat 12 muaj.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** në AL.P. Pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik AL.P nuk duhet të kualifikohet sepse:

Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1; janë të pasakta:

(Shih foto nr. 9 dhe nr. 10 në aneksin nr.6)

Data e dorëzimit të deklaratës është 28.02.2020

Data e zhvillimit të tenderit: 16.03.2020

Ndërkohë që procedura është zhvilluar më datë 20.03.2020

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në AL.P. SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në

përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet në *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, e përbërë nga A. D. , në cilësinë e kryetarit të KVO, S. R. dhe G. G. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Konkluzioni: Referuar sa më sipërm, kualifikimi i shoqërisë “AL.P”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, **si dhe vlera e kontraktuar prej 8,310,000 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te})**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A. D. , në cilësinë e kryetarit të KVO, S. R. dhe G. G. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër” .
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Me procesverbalin e datës 25.03.2020, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë. Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 10.4.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka pasur vetëm 4 operatorë pjesëmarrës nga të cilët janë skualifikuar dhe kualifikuar fituesi. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE në AL.Pò SHPK, me vlerë kontrate 8,310,000 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 10.04.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në AL.photoò SHPK me vlerë kontrate 8,310,000 lekë, ose më pak se fondi limit për vlerën prej 12,000 lekë si dhe lidhur kontrata me nr.949, datë 23.04.2020, me afat 12 muaj. **** Lidhur me OE të shpallur fitues në AL.Pò SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht: Operatori ekonomik AL.P nuk duhet të kualifikohej sepse: <i>Deklaratë për paraqitje oferte sipas Shtojcës 2/1;;</i> <i>ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;</i> <i>d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;</i> <i>dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1; janë të pasakta:</i> Data e dorëzimit të deklaratës është 28.02.2020 Data e zhvillimit të tenderit: 16.03.2020 Ndërkohë që procedura është zhvilluar më datë 20.03.2020

	Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE në SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”. Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “A.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpallje e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 8,310,000 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 në <i>Shqyrtimi i ofertave</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 në <i>Për prokurimin publik</i>, i ndryshuar ku citohet <i>Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”; si dhe neni 1 në <i>Objekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në <i>Parimet e përzgjedhjes</i> germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 në <i>Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave</i>, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Shpalljen fitues të OE, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, si dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 8,310,000 lekë për prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}) (Gjerësisht trajtuar në Akt-konstatimet nr. 01, datë 14.05.2021).
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSB, të nxjerrë përgjegjësitë për vlerën e kontraktuar 8,310,000 lekë, si prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}).

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga A.D. , në cilësinë e kryetarit të KVO, S. R. dhe G. G. , në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. D. , në cilësinë e miratuesit të procedurës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 230/45, datë 20.09.2021, administruar nga KLSH me nr. 131/3, datë 27.05.2021 në Mbi Projekt raportin e Auditimit nga A. D. , S. R. dhe G. G. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe DST, pasi FNJK Buletini nr. 7, datë 24.02.2020, afati kohor për hapjen e ofertave është 16.3.2020; më datë 28.02.2020 OE pjesëmarrës dhe i shpallur fitues ka ngarkuar në SEP sipas FNJK ka data e realizimit të procedurës është 16.03.2020; më datë 11.03.2020 është prot shkresa 708, rekomandime të APP dhe si pasojë është pezulluar procedura me nr. 708/1, datë 11.03.2020, ndërsa me shkresën nr. 708/2, datë 11.03.2020 është bërë shtyrja e afatit të tenderit nga data 16.03.2020 në datë 20.03.2020; OE i ka ngarkuar dokumentet sipas kriterëve të përcaktuara në DST; ndryshimi i datës nga data 16.03.2020 në 20.03.2020 është bërë pasi OE i kishte ngarkuar dokumentet në SEP.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sqarimin e bërë nga KVO, grupi i auditimit nuk i ka marrë në konsideratë për faktin se kundërshtimi juaj mbetet deklarativ, pasi rikujtojmë se me ndryshimin e afatit të realizimit të procedurës janë ndryshuar edhe kriteret e miratuara nga AK në DST (shtoja 708/2, pika 2.3,1-10), prandaj observacioni nuk do të merret në konsideratë.

II. Mbi auditimin e procedurës për blerje ushqime 2020, me këto referenca:

Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020

Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020

Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020

Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020

Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020

Autoriteti Kontraktor në titull i ka emërtuar si procedura me lote, por janë zhvilluar si procedura me nëblerje me vlerë të vogël dhe pavarësisht emërimit në përshkrimin e të dhënave rezultojnë se janë procedura pa lote.

Bazuar në nenin 29 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

(Shih foto nr. 11, 12, 13, 14 dhe nr. 15 në aneksin vendos numër aneksi bashkëlidhur RPA)

Bazuar në nenin 8 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP.

Bazuar në nenin 9 pika 5 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje të siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.

Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.

Bazuar në nenin 57 pika 3 dhe 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme Përlogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme, Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/kryejnë detyrat e mëposhtme:

- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

*Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.*⁸

Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjestuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi z. L. M. , me detyrë ZV/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga N. Gj. , G. N. dhe M. K. .

Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e procedurës së prokurimit ñBlerje ushqime 2020ò.
Situata:	Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020 Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020 Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020 Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020 Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020 Autoriteti Kontraktor në titull i ka emërtuar si procedura me lote, por janë zhvilluar si procedura me ñblerje me vlerë të vogëlò dhe pavarësishtemërtimit ne përshkrimin e te dhënave rezultojnë se janë procedura pa lote. Bazuar në nenin 29 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e <i>lotit</i>; bazuar në nenin 8 pika 2, ñAsnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPPò; bazuar në nenin 9 pika 5 ñKontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'ia siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktorò. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot; bazuar në nenin 57 pika 3 dhe 4, ñSpecialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme, Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtmeò: - Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme. <i>Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.</i>⁹

⁸ Ky paragraf është shtuar me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, ñpër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.

⁹ Ky paragraf është shtuar me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, ñpër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.

	<i>Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit.</i>
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: nenin 29 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në <i>lote</i>, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin <i>lot</i>. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit; bazuar në nenin 8 pika 2, nëAsnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP; bazuar në nenin 9 pika 5 nëKontrata ndahet në <i>lote</i>, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në <i>lote</i>, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit <i>lot</i>; bazuar në nenin 57 pika 3 dhe 4, nëSpecialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme, Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme: - Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme. <i>Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.</i>¹⁰ <i>Procedurat e zhvilluara nuk janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit.</i>
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	<i>Procedurat e zhvilluara nuk janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit.</i>
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, SRSB, në vlerësimin e llojit të procedurave të prokurimit, për çdo rast të ketë në konsideratë mos pjesëtimin e fondit për shmangien e procedurës së prokurimit, por bashkimin e tyre për artikuj, grup artikuj apo ofrim shërbimesh të së njëjtës natyrë.

Për veprimet sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi L. M. , me detyrë ZV/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga N. Gj., G. N. dhe M. K. .

2.7. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arke, banke dhe blerjet e vogla (shpenzimet administrative, për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.)

¹⁰ Ky paragraf është shtuar me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 nëPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit Nr. 131/1Prot. datë 28.01.2021, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Urdhër shpenzimet e realizuar, për vitet objekt auditim.
- Procedurat e auditimit për blerje të vogla.
- Shpenzimet për udhëtime dhe dieta.
- Shpenzimet për karburantin.
- Librat e arkës dhe mandat pagesat.

Kryerja e shpenzimeve me arkë.

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë, në përputhje me disiplinën financiare dhe magazinës, rezultoi se:

Spitali Rajonal Shkodër ka një arkë dhe depozitimet në të janë nga; të ardhurat nga poliklinika; nga të ardhurat në pavijone për sistemin e referimit në sistemin spitalor; të ardhura nga parkimi i mjeteve brenda territorit spitalor.

Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin përkatës të veprimeve të kryera me arkë rezultoi se ditari i arkës ishte i rakorduar dhe nënshkruar prej arkëtarit, regjistrimet janë bërë në mënyrë kronologjike, duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen në librin e arkës, gjithashtu për të ardhurat e arkëtuara janë prerë mandat arkëtimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës si dhe janë prerë mandat pagesat përkatëse.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për transaksionet bankare për shpenzimet e kryera për vitin 2018, për vitin 2019 si dhe për vitin 2020, rezultoi se Spitali Rajonal Shkodër ka kryer shpenzime me vlera të ndryshme, kryesisht për materiale kancelarie, shtypshkrime, shërbim interneti, mirëmbajtje, blerje medikamentesh, ushqime për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër, mirëmbajtje e ambienteve të jashtme dhe të brendshme etj. Gjithashtu rezultoi se shumica e shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës janë pagesat e stafit si dhe sigurimet shoqërore. Për sa i përket transaksioneve të sipër përmendura dhe veprimeve kontabël rezultoi se janë kryer në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 nëPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 si dhe ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të ndryshuar.

Shpenzime për udhëtime brenda dhe jashtë vendit.

Spitali Rajonal Shkodër ka paguar, kryer shpenzime udhëtimi brenda vendit në vlera; në vitin 2018, **197,1936 lekë**, në vitin 2019, **285,600 lekë** dhe në vitin 2020, **367,200 lekë**. Shpenzimet e kryera nga Spitali Rajonal Shkodër për shpenzime udhëtimi e dieta për shërbime brenda vendit, për periudhën objekt auditimi, në të gjitha rastet veprimet janë në përputhje me VKM me nr. 329, datë 20.4.2016 nëPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit. Nuk ka shpenzime për udhëtimet jashtë vendit.

Konsumi i karburantit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se konsumi i karburantit, për periudhën objekt auditimi, është nga lëvizja e autoambulancave dhe automjeteve për ofrimin e shërbimit ndaj pacientëve në zonën urbane dhe inter-urbane. Në dosjet e administruara, kartelat për secilin mjet, është e dokumentuar çdo lëvizje dhe arsyeja e kryerjes së saj ku gjendet kërkesa e mjekut përkatës për shoqërimin e pacientit, fletë udhëtimi i firmosur nga drejtuesi i mjetit, dhe urdhri i Drejtorit për autorizimin e kryerjes së kësaj lëvizjeje. Shpërndarja e karburantit bëhet nëpërmjet sistemit elektronik, referuar legjisllacionit në fuqi, pasi çdo shofer ka në dispozicion kartën elektronike. Pas kërkesës nga mjeku për kryerjen e shërbimit magazinierja, përgjegjëse për karburantin, i furnizon me naftë në sistemin elektronik shoferit përkatës të automjetit. Sasia e konsumit të karburantit për çdo automjet llogaritet në bazë të distancës së përshkuar dhe normës bazë së konsumit të tij. Nga

grupi auditimit u morën të dhënat e furnizimit nga sistemi elektronik të automjeteve, për periudhën objekt auditimi, dhe u kryqëzuan me dosjet e mbajtura nga dega teknike ku pasqyrohet konsumi i karburantit për çdo lëvizje nga të cilat u konstatua se nuk ka diferenca midis tyre. Për periudhën objekt auditimi sasia e karburantit e konsumuar dhe kilometrat e përshkruar nga automjetet në vite janë; viti 2018 43234 litra dhe 301301km; viti 2019 41003 litra dhe 278098 km; viti 2020 47372 litra dhe 335476 km.

2.7.1. Procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2018

Për kryerjen e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël, për vitin 2018 nga Titullari i AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël mbi bazën e Urdhrit të Brendshëm nr. 741 prot, datë 26.02.2018 me përbërje: Xh. H. kryetare; E. H.; G. N.anëtare.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP për vitin 2018, Autoriteti Kontraktor SRSR ka realizuar 36 procedura prokurimi blerje me vlere te vogël, me fond limit 19,974,305 leke (pa TVSH) dhe vlerën e kontratave të realizuara në shumën 16,621,275 leke (pa TVSH), pra me një diferencë prej 3,353,030 leke ose 83.2 % të shfrytëzimit te fondit limit. Shtoni sa keni audituar ju si numër dhe në % ndaj vlerës totale

Titulli i gjetjes:	Në disa procedura prokurimi për blerje te vogla, AK ka bërë copëzim të fondit limit.
Situata:	Autoriteti Kontraktor gjatë vitit 2018, për disa procedura prokurimi ka bërë copëzim të fondit limit dhe shmangie nga procedurat konkurruese të prokurimit duke realizuar më shumë se një procedurë me blerje të vogël për mallra, shërbime, pune me të njëjtin objekt prokurimi. Më poshtë paraqitet copëzimi i fondit limit prej 1,764,178 leke për realizimin e blerjeve të materialeve te kancelarisë te cilat nga AK janë parashikuar dhe realizuar ne tre procedura të blerjeve të vogla, si më poshtë: a. Procedura me objekt <i>“Blerje kancelari”</i> me fond limit 800,000 lekë, me vlerë të kontratës 372,000 leke e zhvilluar me datën 20/09/2018. b. Procedura me objekt <i>“Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi)”</i> me fond limit 800,000 lekë, me vlere te kontratës 697,000 leke e zhvilluar me date 20/06/2018. c. Procedura me objekt <i>“Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi dhe sende të tjera)”</i> me fond limit 164,178 leke, me vlere te kontratës 164,178 leke e zhvilluar me date 08/02/2018. Veprime në mospërputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ku citohet: <i>"Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese.</i>
Kriteri:	Neni 40, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Copëzimi i fondeve buxhetore nëpërmjet blerjeve të vogla
Shkaku:	Mos zbatim të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	Drejtori i SRSR në cilësinë e titullarit te AK, të kërkoj relacion shpjegues nga strukturat përgjegjëse të hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike, që të parandaloj mundësin e copëzimit të fondeve, nëpërmjet përdorimit të procedurave të blerjeve të vogla për blerje dhe shërbime me të njëjtin objekt prokurimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019)

Tenderi me objekt: Blerje Laptop

Titulli i gjetjes:	Specifikimet teknike të Laptop nuk përputhen me specifikimet e ofertuar dhe të ofruara nga OE c
Situata:	Me urdhër prokurimi nr.834 prot. date 01.03.2018 Drejtori i Spitalit ka autorizuar fillimin e procedurës së prokurimit me blerje te vogla me objekt nëBlerje laptop në. Komisioni i ngritur me urdhrin nr.601prot. datë 12.02.2018 i përbërë nga Xh. H. kryetare, E. H. , G. N. dhe N. L. anëtarë (specialiste IT), ka përcaktuar Fondin Limit prej 449,000 leke (pa tvsh) për procedurën e prokurimit me blerje te vogël me objekt nëBlerje lap topò. Procedura e prokurimit është zhvilluar me date 05.02.2018, ne këtë prokurim kane paraqitur interes 21 OE. Pas renditjes se OE fitues, firma nëIT Gjergji kompjuterò është renditur e para, por m.q.s nuk u paraqit brenda afateve kohore te parashikuar ne DST, komisioni ka shpallur fitues OE nëF.ò Shpk i cili ishte i renditur i dyti me ofertën 369,700 leke (pa tvsh) dhe me dif. 79,300 lekë (pa tvsh) nga fondi limit. OE Fas. ka dorëzuar mallin me nr. 220 date 08.03.2018. Sasia prej 10 Lap Top është marrë ne dorëzim me proces-verbal e datës 08.03.2018 nga komisioni i prokurimit. Lap Top-të e dorëzuar kishin garancinë prej 12 muaj dhe janë dorëzuar nga OE Fas. dhe me S/N te tyre, si më poshte:ad07600, abf7600, ac77600, ad17600, ad27600, ac87600, acb7600, acf7600, ac57600, ad37600, <i>Nga auditimi konstatohet se:</i> a. Ne dokumentacionin e tenderit për blerjen e lap topit, specifikime teknike te kërkuara nga AK, nuk janë te firmosura nga anëtarët e komisionit te blerjeve dhe nuk ka evidence dokumentare te argumentuar për përcaktimin e specifikimeve teknike te kërkuara. Veprim ne mospërputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku thuhet se: <i>Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.</i> b. OE Fastech ka dorëzuar pranë Spitalin Rajonal Shkodër 10 Lap Top, model nëACER A3...1-C6FNò. Nga verifikimi i bere nga grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore i tre laptop-ve mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit nëSystem Informatinò të SO Windows 10, në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT. Pas verifikimit të specifikimeve teknike te tre laptop të përzgjedhur

	rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që: 10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues në Fastech Ndërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e Fastech janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A315-31-C6FN me RAM-in 4 GB. c. Për sa me lart, marrja në dorëzim nga komisioni i prokurimeve të mallit pa verifikuar dhe kontrolluar me pare përputhshmërinë e parametrave teknik të kërkuar me përputhshmërinë e parametrave teknik të ofruara dhe të dorëzuar fizikisht nga OE i shpallur fitues, përbënë veprim në mospërputhje me kriteret e miratuara nga AK në DST (specifikimet teknike) me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 në Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 47 <i>Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dhe njofton shitësin për t'i tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësi publike në marrëdhënie me furnitorin).</i> d. Modeli në ACER A315...C6FN në ofertuar dhe dorëzuar nga OE Fastech, nga kërkimi në internet në adresën: https://ëëë.bcgroup-online.com/laptopovi/acer-aspire-a315_31_c6fn-%28nx.gntex.016%29-intel-n3350.-4gb.-500gb-439290, përdor memorien RAM 4GB LPDDR3 1600MHz. Nga kërkimi në internet në adresën: RëRë.amazon.it, çmimi për "Crucial RAM CT51264BF160BJ 4GB DDR3 1600 MHz CL11 Memoria Laptop" është 28.8 euro, konvertuar me kursin zyrtar të këmbimit të BSH, se datës 14.05.2021, ku një euro konvertohet me 122.9 leke. Vlera totale për 10 cope RAM 4GB DDR3 1600 MHZ është: $10 \times (28.8 \times 122.9) = 35,395$ lekë
Kriteri:	DST, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 në Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik
Ndikimi/Efekti:	Marrja nga SRSH të laptop-ve me tregues të ulët nga ato të kërkuar, duke ndikuar në kapacitetin dhe shpejtësinë e përpunimit të të dhënave nga përdoruesit e tyre
Shkaku:	Dorëzimi nga OE I laptop-ve me parametra më të ulta se ato të kërkuara nga AK dhe të ofertuar nga vete OE
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	SRSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 35,395 lekë nga z. A. P., në cilësinë e përfaqësuesit të OE F. sh.a, si personi përgjegjës për dorëzimin e një malli me specifikime teknike të ndryshme nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST.

Pra si përfundim, vlera 35,395 lekë konsiderohet dëm ekonomik i shkaktuar për buxhetin e shtetit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi. anëtarët e komisionit të marrjes ne dorëzim: Xh.H. kryetare; E. H. ; G. N. ; N. L. (specialiste IT) anëtare.

Gjithashtu për dorëzimin e një malli të ndryshëm nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST si dhe deklarim të pa vërtetë/saktë sipas shtrojsës 6 (deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike date 08.05.2018 prot. AK me nr. 930 prot. date 08.03.2018) dhe shtrojsa nr.1 (formulari i ofertës, ku përshkrimi mallit është bere për lap top me RAM 8 GB), ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i OE Fas. Z. A.P. .

Tenderi me objekt: F.V sistemi i radhës përfshirë (server+printer+TV Led)

Titulli i gjetjes:	Marrja në dorëzim i sistemit të radhës ku përfshihet kompjuteri server, printer dhe TV Led nga komisioni i marrje në dorëzim dhe kolaudit pa verifikuar dhe identifikuar specifikimet teknike dhe markën e pajisjeve përbërëse të sistemit.
Situata:	Me Urdhër Prokurimi Nr. 115 prot., datë 30.03.2018 drejtori i SRSH ka autorizuar fillimin e realizimit të procedurës së prokurimit me blerje të vogël për <i>òF.V sistemi i radhës përfshirë (server+printer+TVLed)</i>” Komisioni i prokurimit përbëhej nga: Xh. H. përgj/prok /jurist kryetare; E. H. -spc/ekon dhe G. N. sp/juriste/anëtare. Në zbatim të Urdhrit nr.1151 dt.30.03.2018, janë hartuar dokumentet e tenderit për <i>ñF.V sistemi I radhës përfshirë (server+printer+TV Led)</i>” me fond limit (pa TVSH) 708 000 leke. Llogaritja e fondit limit është bërë mbi bazën e kërkesës me nr.600 prot dt.12.02.2018 të komisionit të ngritur me urdhrin e brendshëm nr.prot 1053 datë 21.03.2018. Përcaktimi i fondit pasqyrohet në proces verbal-in nr.1057 Prot datë 23.03.2018 dhe është miratuar me shkresën nr.100/18 Prot. Datë 26.01.2018. SRSH në ftesën për oferte nr.1152 Prot dt.30.03.2018 kërkonte nga OE që te paraqisnin ofertën e tyre ne lidhje me tenderin <i>ñF.V sistemi i radhës përfshirë (server+printer+TV Led)</i>” Procedura e prokurimit është realizuar më datë 10.04.2018 ora 10.00. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 10 (dhjetë) OE, nga ku 9 (nëntë) prej tyre janë s̃kualifikuar nga komisioni i prokurimit për mungesë dokumentacioni. Komisioni i prokurimit ka shpallur fitues BOE O. shpk & S.&S. me ofertën 630 000 leke (pa TVSH). Pas shpalljes fitues të BOE është lidhur kontrata nr. 1323 Prot, datë 13.04.2018 ndërmjet AK dhe BOE fitues ñO. shpk & S.&S.ò për vlerën 630 000lekë (pa TVSH) ose 756 000 lekë (me TVSH). Për marrjen në dorëzim, drejtuesi i SRSH nëpërmjet urdhrin të brendshëm nr.1353 Prot, datë 16.04.2018, ka ngritur komisionin e marrjes ne dorëzim të sistemit të radhës përfshirë (server+printer+TV Led) për qytetarët/pacientët që marrin shërbim të kujdesit shëndetësor pranë shërbimeve të specialiteteve në Spitalin Rajonal Shkodër sipas sistemit te referimit. Komisioni i marrjes ne dorëzim dhe kolaudit përbëhej nga: Ing.Gj. B. , N. L. , B. L. <u>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:</u>

	Marrja në dorëzim e mallit është bërë sipas Aktit Teknik nr.1624 prot datë 08.05.2018 nga komisioni i marrjes ne dorëzim. Akti Teknik nuk është miratuar nga titullari i institucionit ish Drejtori V.M. , pasi nuk është nënshkruar prej tij. Lidhur me marrjen në dorëzim të mallrave rezulton se pajisjet e lëvruara janë të përshkruara sipas listës, pjesë e aktit por pa përcaktuar vendin e origjinës, markën (Brand Name). Po ashtu për sa i përket njësisë së prenotimit me monitor me prekje dhe printer POS (fig. nr.1); monitor salle pritje (fig. Nr.2) dhe terminal thirrje numër radhë në shërbime (fig.4) janë përcaktuar si shembuj ilustrues, çka nënkupton se në momentin e hartimit të aktit dhe marrjes në dorëzim të mallit produktet nuk kanë qenë disponibël fizikisht. Për sa cituar më lart, rezulton se jemi para të njëjtave dokumenteve identik (formulari nr.3 me nr. 837 prot., date 01.03.2018 nëftesë për ofertë) miratuar nga titullari i AK z. V. M. dhe kontratës së shërbimit nr. 1323 prot., datë 13.04.2018 të nënshkruar nga titullari i AK V. M.dhe BOE O. shpk përfaqësuar nga R. K. dhe S.&S. përfaqësuar nga A. K. . Në këto kushte nuk rezulton e dokumentuar se cilat produkte hardware-ike apo pajisje janë marrë në dorëzim dhe si kanë funksionuar ato në momentin e hartimit të aktit teknik dhe të marrjes në dorëzim
Kriteri:	DST, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik
Ndikimi/Efekti:	Paqartësi për të identifikuar dhe inventarizuar pajisjet informatike të sistemit të radhës ku përfshihet dhe kompjuter server, printer dhe TV Led
Shkaku:	Marrja në dorëzim nga komisioni I kolaudimit të pajisjeve informatike duke mos evidentuar markën dhe nr.serial të tyre.
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandime:	Nga ana e Drejtorisë së SRSH të ngrihet grupi i punës për të verifikuar dhe identifikuar markën dhe specifikimet teknike të pajisjeve përbërëse hardware-ike të sistemit të radhës ku përfshihet; kompjuter server, printer dhe TV Led të dorëzuar nga BOE O. shpk dhe S.&S.

Për sa më lart, për marrjen në dorëzim të produkteve të paidentifikuara, si në drejtim të emërimit “brand name” të pajisjeve apo të dhënave të tjera të parashikuara në LPP, për dhënien e ofertës tekniko ekonomike, ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim: Gj. B. , N. L. dhe B. L.

2.7.2. Procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2019

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, Spitali Rajonal Shkodër për vitin 2019 ka parashikuar dhe realizuar 32 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), me fond limit të parashikuar në vlerë 14,958,510 lekë pa TVSH e vlerë të kontratave të realizuar 11,470,892 lekë pa TVSH. Diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 3,487,618 lekë pa TVSH (23.3 % e fondit limit). Nga këto 26 procedura, ftesë për ofertë, me fond limit të parashikuar 14,534,763 lekë pa TVSH e vlerë të kontratave të realizuar 11,017,262 lekë pa TVSH e diferenca midis fondit limit të parashikuar e realizimit është 3,517,501 lekë pa TVSH (24.2 % e fondit limit).

Nga procedurat e audituara rezultoi si më poshtë:

1. F.V kondicioner

Me datë 04.11.2019 nga ana e Ing.V. F. është bërë kërkesa me nr.3432 prot, datë 04.11.2019 për blerje kondicionerësh. Me shkresën nr.3432/1 prot, datë 04.11.2019 është bërë miratimi i kërkesës për blerje kondicionerësh. Grupi i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga I. C. , Dh. K. , M. K. është ngritur me urdhrin e brendshëm nr.3432/2prot datë 04.11.2019. Me shkresën nr.3432/3, datë 06.11.2019 është përllogaritur vlera e fondit limit me 776,666 lekë pa TVSH. Në datën 18.12.2019 është lëshuar Urdhër Prokurimi me Nr.3432/4 Prot. për “Blerje kondicionerësh”. Në këtë procedurë morën pjesë 28 operator ku 7 janë s kualifikuar për tejkallim të fondit limit si dhe 11 operatorë janë tërhequr nga gara. Fitues është shpallur operatori ñKL. TEK. TB2ò me ofertën më të ulët prej 586,454 lekë pa TVSH. Me faturën tatimore nr.1815, datë 16.12.2019 është likuiduar operatori ñK. T. T2ò me vlerën 703,745 lekë me TVSH për shërbimin e kryer. Nga grupi i auditimit është konstatuar se ambientet e godinës së re së Spitalit janë të pajisura me sistem qendror ngrohje dhe ftohje (CHILLER) ndaj blerja e këtyre kondicionerëve është e panevojshme dhe e pa argumentuar ndaj vlera **703,745 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit**, veprim ky që ngarkon me përgjegjësi zv/drejtorin e shërbimeve administrative z.L.M. .

2. Siguracione ndërtesë.

Me datë 01.10.2019 nga ana e Ing.V. F. është bërë kërkesa me nr.3082 prot, për sigurimin e ndërtesave të Spitalit. Me shkresën nr.3082/1 prot, datë 01.10.2019 është bërë miratimi i kërkesës për sigurimin e ndërtesës. Grupi i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga F. Sh. , M. K. , N. Gj. është ngritur me urdhrin e brendshëm nr.188, datë 01.10.2019. Me shkresën nr.3082/3, datë 04.10.2019 është përllogaritur vlera e fondit limit me 795,000 lekë pa TVSH. Në datën 7.10.2019 është lëshuar urdhri i prokurimit nr.197 me objekt ñSiguracion ndërtesëò me vlerë kontabël 944,029,873 lekë. Për këtë procedurë është paraqitur vetëm operatori ekonomik ñAN.ò sh.p.k me ofertën 795,000 lekë. Me faturën tatimore nr.6005, datë 11.10.2019 është likuiduar operatori ñAN.ò me vlerën 795,000 lekë për shërbimin e kryer. Nga grupi i auditimit konstatohet se në përllogaritjen e vlerës kontabël të ndërtesave të spitalit janë vlerësuar godinat si më poshtë :

- 1) Spitali i Ri me vlerë 744,526,706 lekë
- 2) Pediatria me vlerë 97,219,192 lekë
- 3) Kirurgjia me vlerë 38,062,030 lekë
- 4) Poliklinika me vlerë 14,926,000 lekë
- 5) Sanatoriumi me vlerë 18,097,745 lekë
- 6) Materniteti me vlerë 31,198,200 lekë

Për sa i përket godinës së Spitalit të Ri, që në momentin që është ndërtuar e deri më sot ende nuk është marr në dorëzim nga Spitali Rajonal Shkodër si dhe nuk është regjistruar në kontabilitetin e Spitalit ndaj pagesa e vlerës prej **795,000 lekë për sigurimin e ndërtesave konsiderohet efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit, veprim ky që ngarkon me përgjegjësi zv/drejtorin e shërbimeve administrative z.L. M..

2.7.3. Procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2020

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, Spitali Rajonal Shkodër për vitin 2020 ka parashikuar dhe realizuar 57 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), me fond limit të parashikuar në vlerë 31,470,433 lekë pa TVSH e vlerë të kontratave të realizuar 24,738,174 lekë pa TVSH. Diferenca midis vlerës së fondit limit të parashikuar dhe realizimit është 6,732,259 lekë pa TVSH (21.3 % e fondit limit). Nga këto 42

procedura, ftesë për ofertë, me fond limit të parashikuar në vlerë 29,170,433 lekë pa TVSH e vlerë të kontratave të realizuar 20,551,250 lekë pa TVSH e diferenca midis fondit limit e realizimit është 8,619,182 lekë pa TVSH (29.5 % e fondit limit).

Për vitin 2020, blerje me vlerë të vogël, u audituan me përzgjedhje 9 (nëntë) procedura me fond limit, të llogaritur nga komisionet përkatëse, me vlerë totale 5,900,656 lekë pa TVSH dhe realizuar me vlerë totale 5,175,500 lekë pa TVSH me diferencë 725,156 lekë pa TVSH (13% e fondit limit). Procedurat e audituar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Procedurës	Vlera e fondit limit lekë pa TVSH	Vlera e Ofertës lekë pa TVSH	Operatori ekonomik
1	Blerje filma te ndryshëm dhe solucione për imazherinë	798,987	684,900	SA. MED.
2	Blerje materiale dhe mjete mbrojtëse (Covid-19)	794,220	794,000	E.
3	Blerje fotokopje	791,753	456,000	PC ST.
4	Blerje alkool mjekësor	299,520	249,600	Aq. Med.
5	Blerje oksigjen të gaztë	518,400	518,400	Me. A.
6	Blerje materiale te buta	798,700	550,000	EN.M.
7	Riparim mirëmbajtje objekte ndërtimore	799,699	634,000	BLI.
8	Riparim, asfaltim i territorit para shërbimit të Urgjencës	799,920	645,000	BLI.
9	Ndërtim i strehës në poliklinikën dhe vend grumbullimin e mbetjeve	799,437	643,600	BLI.

Nga auditimi i procedurave rezultoi si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Copëzim i procedurave të prokurimit për mallra të të njëjtës natyrë me funksion të njëjtë..
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit për prokurimet, blerje me vlerë të vogël, për vitin 2020 konstatohet problematika e copëzimit të fondit për mallra që përfshihen në të njëjtin grup dhe kanë të njëjtin funksion kryesor. Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurat, “ <i>Riparim mirëmbajtje objekte ndërtimore</i> ” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, “ <i>Riparim, asfaltim i territorit para shërbimit të Urgjencës</i> ” me fond limit 800,000 pa TVSH. Vlera totale, prokuruar e copëzuar, 1,600,000 lekë pa TVSH duhej të prokurohej në një procedure të vetme.
Kriteri:	VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”, i ndryshuar, Neni 40, pika 8 dhe Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “ <i>Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël</i> ”, i ndryshuar, pika 3 ku citohet: <i>Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.</i>
Ndikimi:	Shmangie nga procedurat konkurruese.
Shkaku	Copëzimi i fondeve.
Rëndësia:	E Mesme.
Rekomandime:	Spitali Rajonal Shkodër, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë mallrat dhe shërbimet e të njëjtit funksion në një procedure të vetme për realizimin e një oferte sa më të favorshme ekonomike.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj.N. Gj. , Përgjegjëse e Njesisë së Prokurimeve dhe z.L. M. sipas Urdhrit të Brendshëm Nr.85 datë 23.05.2019 në Delegim kompetencash.

2.8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore

2.8.1. Burimi i të ardhurave të veta në Spitalin Rajonal Shkodër:

Pjesë e buxhetit të konsoliduar të SRSH, janë dhe të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i ushtruar nga vetë spitali, ato kryesisht përfitohen nga tarifat e shërbimeve shëndetësore në bazë të sistemit të referimit për pacientet, nga shërbimi i parkingut dhe kontratat e dhënies së objekteve me qira dhe nga donacionet financiare.

Në VKM nr.46 datë 30.01.2019, pika 7 dhe 11 në Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor për vitin 2019 është parashikuar, që:

Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga MSHMS. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

Për sa më lart, të ardhurat e gjeneruar nga SRSH përdoren në masën 100% dhe mbarten dhe për vitin pasardhës për të financuar shpenzime të ndryshme, të nevojshme për aktivitetin e shërbimeve shëndetësore dhe asaj të administratës

Të ardhurat dytësore në SRSH përfitohen kryesisht nga:

1. Nga tarifat për shërbimet shëndetësore të përfituara nga qytetaret/pacientet nëpërmjet sistemit të referimit në shërbimin shëndetësor publik.

Tarifat për këto shërbime janë përcaktuar në Urdhër Nr. 28 datë 26.01.2016 të MSHMS në Për sistemin e referimit dhe tarifat e Shërbimit Shëndetësor Publik, këto shërbime merren nëpërmjet kryerjes së pagesës nga pacient/qytetar pranë recepsionit të spitalit, maternitetit, poliklinikës së specialiteteve.

2. Nga tarifa për shërbimin e parkingut për automjetet që shfrytëzojnë hapësirën e parkingut të Spitalit Rajonal Shkodër.

Tarifa për automjetet që shfrytëzojnë hapësirën e përcaktuar për parking brenda territorit të spitalit është 100 lekë, për kohë qëndrimi të pacaktuar.

Përcaktimi i kësaj tarife është bërë me vendimin nr. 2471 prot. datë 24.07.2019 në Mbi administrimin e parkimit të automjeteve në territorin e korpusit qëndror

3. Nga Kontratat e qirave të lidhura me subjekte private që kryejnë aktivitet në ambientet e SRSH.

Tarifat për dhënien e ambienteve me qira bazohet mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 315, datë 24.04.2003 në Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 në Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore

4. Donacioneve në vlerë financiare.(për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur donacion)

Të ardhurat dytësore të arkëtuara:

Për vitin 2018 në vlerën 41,084,373 lekë; Për vitin 2019 në vlerën 44,482,055 lekë ; Për vitin 2020 në vlerën 34,347,523 lekë; Për muajin Janar 2021 në vlerë 3,202,522

Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat totale të arkëtuara në SRSH dhe të rakorduar në degën e thesarit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe Janar 2021, janë pasqyruar në tabelën nr.1. të aneksit nr. 8.

Për vitin 2018 janë parashikuar 40,103,000 leke nga të ardhurat e veta, dhe janë realizuar 41,084,373 leke. Pra rezulton me tejkalim të realizimit të të ardhurave në masën 102.4%. Në

fakt kjo % realizimi ka ardhur për shkak të një planifikimi të ulët për të ardhurat dytësore për vitin 2018, sepse nga grupi i punës për planifikimin e të ardhurave dytësore për PBA 2018, është bërë një parashikim i ulët i të ardhurave dytësore duke mos parashikuar të ardhurat dytësore që do të siguroheshin nga aktiviteti i parkingut. Gjithashtu hartimi i PBA nuk është shoqëruar me një relacion shpjegues mbi parashikimet e bëra duke munguar gjurma audituese e cila do të mundësonte krijimin e një ambienti efektiv të funksionimit të kontrollit të brendshëm shumë i nevojshëm për vetë institucionin por dhe për kontrollet e auditimit të brendshëm dhe të KLSH.

Për vitin 2019 janë parashikuar të ardhura dytësore në vlerën 40,103,000 leke dhe janë realizuar 44,482,055 ose 110.9 %.

Për vitin 2020 janë parashikuar të ardhura dytësore në vlerën 47,251,000 leke, të cilat janë realizuar në vlerën 34,347,523 leke ose 72.6%. Pra për vitin 2020 SRSJ rezultoi me mos realizim të të ardhurave në masën 27.4 % kundrejt parashikimit të bërë nga SRSJ. Nga aktiviteti i parkingut të makinave nga SRSJ janë planifikuar 12,500,000 lekë të ardhura, duke llogaritur një mesatare me 347 makina në ditë që qarkullojnë në territorin e SRSJ dhe tarifë 100 leke për çdo makinë pa kohë qëndrimi.

Për vitin 2020 të ardhurat nga parkingu janë realizuar në masën 67.54% , kundrejt vitit 2019 duke shënuar një rënie me 36% të të ardhurave nga parkingu kundrejt vitit 2019.

2.8.2. Të ardhura nga qerat

Të ardhurat që përfitohen nga dhënia me qira të ambienteve të Spitalit Rajonal Shkodër janë burim të ardhurash dytësore që arkëton SRSJ, të cilat janë pasqyruara hollësisht në tabelën nr.2. aneksi nr.8

Si rezultat i dhënies së ambienteve me qira, SRSJ ka gjeneruar të ardhurat dytësore për vitin 2018 në vlerën 749,073 lekë, për vitin 2019 në vlerën 756,755 leke dhe për vitin 2020 në vlerën 852,523 lekë të pasqyruar në tabelën nr.3. aneksi nr.8

Ambientet e dhëna me qera

1. Ambiente në katin e tretë të Spitalit Rajonal Shkodër 343.43 m2.

Në ambientet e SRSJ ushtron aktivitetin koncesionari nD.V.ò për shërbimin e dializës. Kontrata e qirasë nr. prot. 1225, datë 31.05.2016, është nënshkruar për qiradhënesin SRSJ nga z. P.Ç dhe për qiramarrësin shoqërinë nD.V.ò shpk përfaqësuar nga administratorja znj. M.A.H., mbështetur në Kontratën e Koncesionit midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kompanisë nD.V.ò sh.p.k nënshkruar më datë 08.02.2016, sipas përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014. Objekti kësaj kontrate është nKryerja e Shërbimit të Dializës sipas plan biznesit të paraqitur në kontratën e koncesionit. Ambienti ndodhet në katin e tretë të SRSJ me sipërfaqe 343.43 m2. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar për një periudhë 8 (tetë) vjet dhe ka hyrë në fuqi nga data 01.06.2016 dhe përfundon me datë 31.05.2024. Çmimi i kontratës është 160 lekë/m2, ose në vlerën 54,948.8 lekë/muaj. Subjekti ka kontrate me OSHEE dhe Ujësjetësin për pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit.

2. Ambient me sipërfaqe 12 m2.

Në ambientet e brendshme të SRSJ janë instaluar 6 (gjashtë) distributorëve automatikë bianchi për snack dhe 6 (gjashtë) distributorëve automatikë bianchi për kafe.

Për vitin 2018, kontrata e qirasë nr. prot. 3582, datë 01.10.2018, është nënshkruar nga nëpunësi i autorizuar i deleguar për SRSJ z. T. Rr. në cilësinë e qiradhënësit subjektit nA. N.ò person fizik, bazuar në miratimin e dhënies me qira të Ministrisë së Shëndetësisë sipas shkresës nr. prot. 4963/2, datë 12.09.2018, dhënia e këtij ambienti që ka për destinacion instalimin e 6 distributorëve automatikë bianchi për snack dhe 6 (gjashtë) distributorëve automatikë bianchi për kafe, gjithsej janë 12 distributorë.

Kontrata ka afat 1 (një) vjeçar.

Për vitin 2018, vlera totale e qirasë për sipërfaqen 12 m² me një kuotë 200 lekë/m² në muaj duke llogaritur edhe konsumin e energjisë elektrike nga pajisjet e instaluar për 30 ditë shkon në vlerën 13,680.0 lekë me TVSH.

Për vitin 2019, kontrata e qirasë nr. prot. 3586, datë 21.11.2019, është nënshkruar nga nëpunësi autorizues z.A. D. (drejtori i SRSH) dhe në cilësinë e qiradhënësit. Subjektit ñA. N.ò person fizik, në cilësinë e qiramarrësit, bazuar në miratimin e dhënies me qira të Ministrit të Shëndetësisë sipas shkresës nr. prot. 5110/1, datë 19.11.2019, dhënia e këtij ambienti ka për destinacion instalimin e 6 distributorëve automatik bianchi për snack dhe 6 distributorëve automatikë bianchi për kafe, gjithsej 12 distributorë.

Kontrata ka afat 1 (një) vjeçar. Për vitin 2019, vlera totale e qirasë për sipërfaqen 12 m² me çmim 200 lekë/m² në muaj duke llogaritur edhe konsumin e energjisë elektrike të konsumuar nga pajisjet e instaluar për 30 ditë shkon në vlerën 11,262.0 lekë me TVSH.

Për vitin 2020, kontrata e qirasë nr. prot. 2678, datë 23.11.2020, është nënshkruar nga nëpunësi autorizues z.A. D. (drejtori i SRSH) dhe në cilësinë e qiradhënësit. Subjektit ñA. N.ò person fizik, në cilësinë e qiramarrësit, bazuar në miratimin e dhënies me qira të Ministrit të Shëndetësisë sipas shkresës nr. prot. 4995/1, datë 16.11.2020, dhënia e këtij ambienti ka për destinacion instalimin e 6 distributorëve automatik bianchi për snack dhe 6 distributorëve automatik bianchi për kafe, gjithsej 12 distributorë.

Kontrata ka afat 1 (një) vjeçar.

Për vitin 2020, vlera totale e qirasë për sipërfaqen 12 m² me çmim 200 lekë/m² në muaj duke llogaritur edhe konsumin e energjisë elektrike të konsumuar nga pajisjet e instaluar për 30 ditë shkon në vlerën 11,262.0 lekë me TVSH.

Kontratat për këtë shërbim, janë rinovuar në përfundim të periudhës 1 vjeçare dhe për vitin 2020, kontrata përfundon më datë 23.11.2021

Të ardhurat e përfituar nga subjekti ñA. N.ò, për vitet 2019 dhe 2020 ka një rënie të të ardhurave megjithëse kanë të njëjtat terma të nënshkruar në kontratë me vitet e mëparshme. Diferenca prej 2,418 leke për muaj vjen si pasojë e reflektimit të çmimit të energjisë elektrike të faturuar për këto vite nga 14 lekë për kwh në 11 lekë për kwh.

3. Shërbimi i kateringut

Ky shërbim është dhënë me *“outsourcing”* dhe për ambientin ku është vendosur është lidhur kontratë qiraje me Nr.1637 Prot datë 29.07.2020 me afat një vjeçar. Lidhja e kësaj kontrate është bërë pas dhënies së autorizimit për lidhje kontrate nga Agjencia e Blerjeve të përqendruara, sipas marrëveshjes kuadër nr.26/8 prot dt. 16.06.2020. Miratim për dhënie me qera nga MSHMS është me nr.3608 prot date 28.07.2020, protokolluar pranë SRSH me nr.1611/1 dt. 29.07.2020. Subjekti ñA. N.ò ka kontrate me OSHEE dhe UKSH për konsumin e energjisë elektrike dhe të ujit.

4. Ish punti i gjakut-arka-pranimi, spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m².

Kontrata e qirasë nr. prot. 368/1, datë 07.08.2002, është nënshkruar për Qiradhënësin Spitalin Shkodër z. M.Ç. në cilësinë e qiramarrësit përfaqësuar nga ñN.D.ò person fizik.

Bazuar në VKM Nr. 430, datë 09.07.1998 ñPër dhënien me qira të objekteve Ndërmarrjeve, shoqërive a Institucioneve Shtetëroreò pika 1, germa (a) dhe pika 3, germa (a): Dhënia e këtij ambienti me sipërfaqe 70 m². Kuota e qirasë për sipërfaqen 70 m² është përcaktuar në vlerën 1 USD/m² në muaj/m², pa përfshirë pagesën për ujin, energjinë elektrike.

Pagesa do të bëhet në lekë pas konvertimit që do ti bëhet në bazë të kursit të USD brenda datës 5 të fillimit të çdo muaji. Vlefshmëria e kontratës është përcaktuar për një periudhë 20 vjeçare. (data e fillimit 01.12.2002 data e përfundimit 01.12.2022)

Titulli i gjetjes:	Afati i vlefshmërisë së kontratës nr. 368/1prot., datë 07.08.2002 është në kundërshtim me referencën ligjore.
Situata:	Kontrata e qirasë nr. 368/1prot., datë 07.08.2002, ka afat 20 (njëzet) vjeçar dhe përfundon më datë 10.07.2022. <i>Kontrata është lidhur kundërshtim me referencën ligjore të kohës për sa i përket periudhës së vlefshmërisë. Afati i vendosur për një periudhë 20 vjeçare, është në tejkalim të kompetencave të ish titullarit të Spitalit të asaj periudhe, pasi për kontratat me afat mbi 1(një) vit të drejtën e lidhjes së saj i takon organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit, në këtë rast të drejtën e përfaqësimit të pronarit e ka Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</i> Veprim në mospërputhje me VKM nr. 430, date 09.07.1998 pika1 germa b dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu I, pika 6, germa b. Gjithashtu të gjithë drejtuesit e SRSH, brenda periudhës së auditimit nuk kanë bërë rinovimin e kontratës nr.368/1prot., datë 07.08.2002 duke vepruar në kundërshtim me nenin 5, pika 2 të kontratës, ku është parashikuar se: <i>Kjo kontratë përtërihet në mes të palëve çdo 5 vjet.</i>
Kriteri:	VKM nr. 430, date 09.07.1998 pika1 germa b dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, kreu I, pika 6, germa b
Ndikimi/Efekti:	Mos rinovimi çdo 5 vite të kësaj kontrate ka bërë që kjo kontratë të vazhdojë zbatimin e saj me VKM nr. 430, date 09.07.1998 e cila është shfuqizuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014
Shkaku:	Kontrata e lidhur me subjektin N.D. për objektin “ish punti i gjakut-arka-pranimi, spitali i vjetër me sipërfaqe 70 m ² ” është në mospërputhje me referencën ligjore të kohës
Rëndësia:	e lartë
Rekomandime:	Drejtorja dhe zyra juridike e Spitalit, të hartoj dhe të lidhin kontratë qeraje sipas akteve nën ligjore në fuqi për objektin “ish punti i gjakut, spitali i vjetër”

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj.T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Zbatimi i rekomandimit të KLSH:

Bazuar në vendimin nr.53 date 20.06.2018 të Kryetarit të KLSH, nga grupi i auditimit është konstatuar se: Subjekti N. D. përveç sipërfaqes prej 70 m², është zgjeruar edhe me 138.7 m² brenda territorit të SRSH. Për këtë konstatim KLSH ka rekomanduar që SRSH të kërkojë që subjekti të arkëtoj vlerën e pagesës për sipërfaqen e shtuar në masën 13,376 \$ për periudhën nga viti 2008 deri me 14.04.2016. Vlera prej 13,376 \$, është konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit nga KLSH.

Nga auditimi i gjendjes aktuale të zbatimit të rekomandimit është konstatuar se:

SRSH nëpërmjet shkresës nr. 2518 prot. datë 06.07.2018 në zbatim të rekomandimit të KLSH ka njoftuar subjektin N.D. mbi detyrimin për të arkëtuar shumën 13,376 \$ për sipërfaqen e shtuar me 138.7 m² brenda territorit të spitalit.

Në lidhje me këtë njoftim të Spitalit Rajonal Shkodër mbi arkëtimin e vlerës 13,376 \$, subjekti fizik N. D. me shkresën 3041 prot. date 20.08.2018 me objekt fëmëhim përgjigjë e nuk ka pranuar njohjen e detyrimit të lënë nga KLSH

Më pas SRSH ka ridërguar njoftimin me nr. 1150 prot. date 28.03.2019 për të arkëtuar detyrimin e konstatuar nga KLSH

Nga ana e subjektit N. D. është depozituar pranë gjykatës administrative shkalla e parë Shkodër akt padi me nr.1453 prot datë 23.04.2019, mbi mospranimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH, të shprehura në vendimin nr.53 date 20.06.2018 të kryetarit të KLSH Aktualisht, kjo çështje është në proces gjyqësor.

Përdorimi i territorit të Spitalit nga subjekte private, pa dokumentacion justifikues.

Titulli i gjetjes:	Përdorimi i territorit të Spitalit nga subjekte private, pa dokumentacion justifikues.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, SRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka marrë asnjë masë për përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë së paluajtshme (truall + ndërtesë) në regjistrin publik të pronave dhe pajisjen e saj me certifikatë pronësie, mosveprim që bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën fëmëdhënë të nenit 193 dhe nenin 196 të Ligjit nr.7850, date 29.7.1994 fëmëPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenin 6 të Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 fëmëPër pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, nenin 25, nenin 34 dhe nenin 47 të Ligjit nr.111/2018 fëmëPër Kadastrën, si dhe nenin 38 dhe 44 të Ligjit nr.20/2020 fëmëPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr.4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se, një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m2, përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat bar-bufe. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirim të sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 fëmëPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 506, datë 18.09.2013 fëmëPër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore
Kriteri:	Ligjit nr.7850, date 29.7.1994 fëmëPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenin 6 të Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 fëmëPër pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, nenin 25, nenin 34 dhe nenin 47 të Ligjit nr.111/2018 fëmëPër Kadastrën, si dhe nenin 38 dhe 44 të Ligjit nr.20/2020 fëmëPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.
Ndikimi/Efekti:	Zënia e hapësirës se nevojshme te SRSH për te ushtruar veprimtari normale të vetëm ne funksion te rritjes së cilësisë së shërbimit shëndetësor spitalor
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të territorit te spitalit

Rëndësia:	e lartë
Rekomandime:	1.SRSH të bëjë inventarizimin dhe përditësimin e pasurisë së paluajtshme dhe aksesoreve të saj, si dhe në bashkëpunim me MSHMS, të marri masat e nevojshme për regjistrimin e pasurisë (truall ndërtesë), pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër. 2.Drejtoria e SRSH, tã drejtohet zyrtarisht subjektit privat, i cili është duke përdorur sipërfaqe të truallit të pasurisë së paluajtshme të spitalit, me qëllim lirim të saj, dhe në rast të mosveprimit nga subjekti privat, tã drejtohet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV)

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A.D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim).

Marrëveshja me Credins Bank për vendosjen e ATM

Titulli i gjetjes:	Përdorimi i ambienteve të brendshme të SRSH nga C. Bank pa kontratë qeraje.
Situata:	SRSH ka lidhur marrëveshje me Cre. Bank me nr. 153 prot. 03.02.2014, ku është parashikuar edhe vendosja e një ATM, sipas përcaktimeve të pikës 3.11 të marrëveshjes, citoj sa vijon: <i>“Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Banka merr përsipër vendosjen e një ATM, në ambientet e Spitalit për te lehtësuar marrjen e pagave nga punonjësit e institucionit”</i> Në ambientet e brendshme të spitalit shfrytëzohet nga subjekti C. Bank një sipërfaqe prej 5.6 m2 prej datës 03.02.2014. Në lidhje me këtë çështje SRSH nuk ka lidhur kontratë qeraje me subjektin bankar duke vepruar në mospërputhje me VKM nr.54, datë 05.02.2014 nëpër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore për te lidhur kontrate qiraje sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je. Për sa më lart, a. SRSH mbi bazën e marrëveshjes së datës 03.02.2014 me Cre. Bank nuk ka lidhur kontrate qiraje me këtë subjekt për kryerjen e pagesës së sipërfaqes së shfrytëzuar dhe konsumin e energjisë elektrike që përdor për te mbajtur aktive 24 orë këtë ATM. b. Në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 nëpër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore C. Bank duhet të paguante 150 lekë/m2 x 5.6 m2= 840 lekë për muaj. c. Duke llogaritur nr. e muajve të përdorimit nga fillimi i shfrytëzimit të ambientit prej 5.6 m2 deri në 31.01.2021 janë 85 muaj. <i>Vlera total 71,400 lekë (840 lekë/muaj*85 muaj = 71,400 lekë) e cila konsiderohet e ardhur e munguar nga mungesa e përfitimit të tarifës së qirasë për subjektin Credins Bank ndaj SRSH.</i> Bazuar në të dhënat e sektorit të shërbimeve të SRSH, ATM ka një konsum fuqie elektrike prej 0.8 Kwh. Çmimi i energjisë elektrike për vitin 2018 ka qenë 14 lekë për Kwh (pa TVSH) dhe 11 lekë për Kwh (pa TVSH) për vitin 2019, 2020, 2021, çmime të referuara nga faturat e energjisë elektrike të faturuara nga OSHEE për SRSH.

	Nga analiza dhe përlllogaritja e konsumit të energjisë elektrike ATM ka konsumuar energji elektrike sa më poshtë vijon: Për vitin 2018 ne vlerën 116,122 leke $\{(0.8\text{këh} \cdot 24\text{h} \cdot 360\text{dite} \cdot 16.8\text{leke/kwh}(\text{me Tvsh})\}$, Për vitin 2019 ne vlerën 116,122 leke $\{(0.8\text{këh} \cdot 24\text{h} \cdot 360\text{dite} \cdot 16.8\text{leke/kwh}(\text{me Tvsh})\}$ Për vitin 2020 ne vlerën 91,238 leke $\{(0.8\text{këh} \cdot 24\text{h} \cdot 360\text{dite} \cdot 13.2\text{leke/kwh}(\text{me Tvsh})\}$ dhe për periudhën nga 01.01.201 deri 31.01.2021 ne vlerën 7,603 leke $\{(0.8\text{këh} \cdot 24\text{h} \cdot 30 \cdot 13.2\text{leke/Kwh}(\text{me Tvsh})\}$ <i>(llogaritja e konsumit të energjisë elektrike është bere nga data e vendosjes së ATM deri në përfundim të periudhës së auditimit)</i> <u>Si përfundim vlera totale 331,085 lekë konsiderohet dëm ekonomik</u>
Kriteri:	VKM nr.54, datë 05.02.2014 nëpër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e të ardhurave nga shfrytëzimi i ambienteve të brendshme të SRSH nga vendosja e ATM-së së Cre. Bank, dega Shkodër si dhe rritja e shpenzimeve për energjinë elektrike të SRSH. Vendos shumen në leke
Shkaku:	Shfrytëzimi pa kontratë shërbimi, të ambienteve të brendshme të SRSH
Rëndësia:	e lartë
Rekomandime:	1. Nga ana e Drejtorisë së SRSH të analizohet shkaqet dhe të merren masa për personat përgjegjës, që nuk kanë lidhur kontratë qiraje me C. Bank dhe për pasoj nuk është arkëtuar shuma 71,400 lekë, e cila konsiderohet një e ardhur e munguar për spitalin. Gjithashtu Drejtori dhe zyra juridike e Spitalit, të hartoj dhe të lidhin kontratë qiraje me subjektin Cre. Bank për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme të spitalit. 2.SRSH të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 331,085 lekë nga C. Bank, dega Shkodër si detyrim i përlllogaritur për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme pa kontratë qiraje dhe përdorimit të energjisë elektrike të SRSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V.M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim).

I.3. Mbi zbatimin e kontratës koncesionare S. S.

Titulli i gjetjes:	Mbi zbatimin e kontratës koncesionare.
Situata:	SRSH nuk disponon kontratën koncesionare ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe S. S. me objekt nëKontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S. Se. SHPK.

Të gjithë drejtuesit e SRSH brenda periudhës së auditimit nuk kanë kërkuar zyrtarisht nga MSHMS kopjo të kontratës koncesionare e cila rregullon marrëdhënien kontraktuale të shërbimit koncesionar që përfiton SRSH

Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se SRSH është njohur zyrtarisht me faktin e lidhjes së kësaj kontrate (por jo me kontratën), me anë të shkresës së Drejtorisë së Administrimit Spitalor në MSH me nr.188/14 prot. date 12.07.2017 për zbatimin e kontratës koncesionare për sterilizimin e instrumenteve kirurgjikalë, kjo shkresë është pa numër protokolli hyrës në SRSH.

Nëpërmjet kësaj shkrese SRSH njoftohet për fillimin e zbatimit të kontratës koncesionare dhe gjithashtu kërkohet bashkëpunim me kompaninë koncesionare për përcaktimin e ambienteve të nevojshme dhe krijimin e lehtësirave për zbatimin e kontratës.

Në zbatim të nenit 19.4 SRSH duhet të jap ambiente në përdorim për t'i kthyer në nevojshëm, kompanisë S.S. si fitues i koncesionarit.

Shkresa e mësipërme e MSH, ka të bashkëngjitur vetëm faqen 14 (katërmëdhjetë) të kontratës koncesionare, në të cilën përfshihen vetëm pikat 19.3 deri 21.5 të saj

Në zbatim të kësaj shkrese nga SRSH, koncesionarit S. Se. ka marrë në përdorim një sipërfaqe prej 296 m2 brenda ambienteve të Spitalit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet të jetë ngritur grup pune apo të jete hartuar relacion në lidhje me këtë çështje.

Në zbatim të kontratës Spitalore/S të FSDKSH dhe SRSH, neni 9, pika 1 ndetyrime të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S.Se. ò parashikohet:

Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale", të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shqipërisë Koncesionare "S.Se." Sh.p.k.

Fillimi i shërbimit koncesionar:

SRSH nuk disponon kopjen e Kontratës së Financimit të Koncesionarit ndërmjet FSDKSH dhe S. S..

Nga ana e drejtuesve të SRSH brenda periudhës së auditimit nuk është kërkuar kopjo e kontratës së financimit të koncesionarit që rregullon marrëdhënien kontraktuale me efekte financiare që rrjedhin prej saj, sëbashku me anekset e saj:

Gjithashtu, nga ana e koncesionarit nuk ka informacion të protokolluar në SRSH për fillimin e shërbimit koncesionar. Pyetjes së grupit të auditimit mbi ekzistencën e informacionit për datën e fillimit të shërbimeve koncesionare, Drejtori i SRSH z. A. D. arsyetoj përgjigjen për datën e fillimit të shërbimit koncesionar duke u bazuar tek regjistri i operacioneve nga ku rezulton se në datën 20.11.2017 është bërë tërheqja e parë e seteve kirurgjikale të sterilizuara nga S.Se. dhe sipas tij kjo është data e fillimit të shërbimit koncesionar në SRSH.

Konkluzion:

	Nga ana e drejtuesve të SRSH brenda periudhës së auditimit nuk është kërkuar kopjo e kontratës koncesionare dhe ajo financiare të cilat rregullojnë marrëdhënien kontraktuale Nga evidenca dokumentare konstatohet se nuk ka komunikim nga SRSH me MSHMS për evidentimin e problemeve të zbatimit të kontratës. Veprime në mospërputhje me kontratën Spitalore/S të FSDKSH dhe SRSH, neni 9, pika 1 në detyrimet të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S. Se.ò parashikohet: <i>Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale", të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Koncesionare "S. Se." Sh.p.k.</i>
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 në për koncesionet dhe partneritetin publik privatò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumentacionit të plotë të Kontratës së koncesionarit dhe asaj të financimit ka ndikuar në efektivitetin e ndjekjes së zbatimit të shërbimit koncesionar
Shkaku:	Drejtuesit e mëparshëm dhe ai aktual nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të poseduar kopjen e kontratës së koncesionarit për sete kirurgjikale
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandime:	Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë për kontratën koncesionare me objekt në Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj.T.Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Të dhëna statistikore mbi numrin e ndërhyrjeve kirurgjikale të ndara sipas vlerave financiare të disbursuar për koncesionarin për vitet 2018, 2019, 2020

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultojnë qe:

Gjatë vitit 2018 janë realizuar në total 6212 ndërhyrje kirurgjikale dhe 819 instrumente të sterilizuar me avull duke disbursuar 132,133,505 leke nëpërmjet FSDKSH për koncesionarin S. S..

Për vitin 2019 janë realizuar 3433 ndërhyrje në total dhe 4207 sete instrumentesh me avull në vlerën 88,144,754 leke.

Për vitin 2020 janë realizuar 2539 ndërhyrje në total dhe 2158 sete instrumentesh me avull në vlerën 69,630,074 leke. Në mënyrë më të detajuar dhe të ndara sipas nivelit të kompleksitetit numri i ndërhyrjeve dhe vlera financiare respektive sipas viteve paraqitet në tabelën nr.3.

Tabela nr. 3. Nr. i ndërhyrjeve kirurgjikale sipas kompleksitetit dhe disbursimet për llogari të koncesionarin

Shërbimi mjekësor	Viti	Ndërhyrje sipas kompleksitetit			Sterilizimi i instrumenteve me avull	Vlera totale ne Lekë
		i Larte	i Mesëm	i ulet		
Totali i Sallave	2018	587	1140	4485	819	132,133,505
	2019	639	1120	1674	4207	88,144,754
	2020	581	992	966	2158	69,630,074

Burimi: Spitali Rajonal Shkodër, përpunimi nga Grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë:

Prej datës 20.11.2017 dhe në vazhdim koncesionari furnizohet me energji elektrike dhe ujë të siguruar nga SRSB, dhe shpenzimet për to mbulohen nga buxheti i SRSB, mbi bazën e nenit 19.5 të kontratës midis MSH dhe koncesionarit S. S., ku parashikohet:

Në qendrat e Back-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT, autoriteti i siguron koncesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime ne ngarkim te autoritetit.

Gjithashtu kjo klauzol parashikohet dhe në nenin 4 të kontratës spitalore s/2018 ku thuhet: *Spitali duhet të përmbush të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e lidhur ndërmjet MSHMS dhe shoqërisë koncesionare S.S. si përfitues i shërbimeve të ofruara nga kjo kontrate* Sipas të dhënave të sektorit teknik në SRSB koncesionari ka një fuqi të instaluar të autoklavave prej 200 KWh dhe konsum të sasisë së ujit afërsisht 10 m³ ujë në ditë.

Titulli i gjetjes:	Koncesionari S. Se. përdor energjinë elektrike dhe ujin nga spitali, shpenzimet e të cilave mbulohen nga buxheti i SRSB.
Situata:	<u>Për konsumin e energjisë elektrike:</u> Në mungesë të matësve, konsumi i përafërt i përlllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSB është: [200Këh*4 ore*22 dite*13.2 leke/këh (me TVSh)] * 36 muaj= 8,363,520 lekë Pra në përlllogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklavat punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1këh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SRSB <u>Për konsumin e ujit:</u> Konsumi i përafërt i përlllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSB dhe në mungesë të matësve të ujit, është: Konsumi i ujit: 10 m³/dite*22dite*36 muaj *156 leke/m³=1,235,520 leke Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S. Se. SHPK, <u>në vlerën 9,599,040 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të SRSB.</u> <i>Përlllogaritja e përafërte e bërë nga grupi i auditimit është bërë mbi bazën e të dhënave të siguruar nga sektori i teknik në SRSB, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.</i>

Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 nëPër koncesionet dhe partneritetin publik privatò, i ndryshuar; kontrata koncesionare; kontrata e Shërbimit Spitalor ndërmjet FDSKSH dhe SRSH
Ndikimi/Efekti:	Shpenzimet për energji elektrike dhe ujë kanë rënduar Buxhetin e Spitalit Rajonal Shkodër. Në shumën ,,.,.,.,.
Shkaku:	Mungesa e komunikimit dhe kërkesës se Drejtuesve të SRSH për MSHMS ne lidhje me rishikimin e disa termave te kontratës, kryesisht ato qe e ngarkojnë Buxhetin e Spitalit ne lidhje me konsumin e energjisë elektrike dhe te ujit
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore <u>në vlerën 9,599,040 lekë</u> ,si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncesionarit dhe jo buxhetit të spitalit

Titulli i gjetjes:	Të ardhurat të munguara nga mungesa e lidhjes së kontratës së qeras me koncesionarin S.S. mbi shfrytëzimin e 296 m2
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Sipërfaqja totale në përdorim nga koncesionari është 296 m2 brenda ambienteve të Spitalit. Koncesionari e ka përdorur këtë sipërfaqe nga data 20.11.2017 e në vazhdim, pa paguar qira. Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: <i>“Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj, akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar”</i>. Por në kontratë është përcaktuar që “Autoriteti” është “Ministria e Shëndetësisë” SRSH në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk ka ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 nëPër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. Në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të koncesionarit, nuk është mbajtur nga SRSH detyrimi për marrjen e qerasë për këto ambiente, duke qenë se Spitali nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria e Shëndetësisë. Për periudhën në auditim dhe për sipërfaqen prej 296 m2 duke llogaritur si tarifë dysheme, mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 nëPër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. Spitali Rajonal Shkodër nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit brenda SRSH, ku koncesionari zhvillon aktivitetin.

	E ardhura e munguar nga mos përfëtimi i shumës së qerasë llogaritet: (296m²*150 leke/m²=44,400 leke/muaj). Koncesionari brenda periudhës së auditimit ushtron aktivitetin prej 36 muaj. Pra ne total kemi 44,400 leke/muaj*36 muaj= 1,598,400 lekë <i>Për sa më lart, shuma 1,598,400 lekë, përbën efekt financiar negativ për SRSH.</i> <i>Veprime në mospërputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”.</i>
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 nëPër koncesionet dhe partneritetin publik privat, i ndryshuar; kontrata koncesionare; kontrata e Shërbimit Spitalor
Ndikimi/Efekti:	Përdorim i ambienteve të Spitalit Shkodër nga Koncesionari pa paguar detyrimin e qirasë. Në shumën
Shkaku:	Mos zbatimi VKM nr. 54, datë 05.02.2014 nëPër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficientë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 1,598,400 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegociimin e kontratës për pikën 19.5.

Mbetjet e rrezikshme:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.Se. SHPK, nuk ka dorëzuar pranë SRSH dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme.

Titulli i gjetjes:	Mbi zbatimin e kontratës koncesionare.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.Se. SHPK, nuk ka dorëzuar pranë SRSH dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht: a. Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 nëPër miratimin e rregullores nëPër administrimin e mbetjeve spitalore, Kreu II, pika 7.1. b. Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 nëPër miratimin e rregullores nëPër administrimin e mbetjeve spitalore, Kreu II, pika 7.2. c. Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç. d. Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë nëDokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

Kriteri:	VKM nr. 798, datë 29.09.2010 nëPër miratimin e rregullores nëPër administrimin e mbetjeve spitalore; VKM nr. 371, datë 11.06.2007.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e ndjekjes dhe monitorimit të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme nga SRSH
Shkaku:	Mos dorëzim i dokumentacionit nga koncesionari të dokumentacionit mbi trajtimin e mbetjeve të rrezikshme
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin nga Koncesionari S.S. SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Autoklava e SRSH.

Krahas shërbimit të sterilizimit të pajisjeve dhe seteve kirurgjikale të ofruara nga koncesionari S. S., SRSH përdorë një autoklavë tip Astell ASB300 me fuqi 28 kwh. Pajisja autoklave është bërë kalim inventari nga shërbimi i Penologjisë në shërbimin e Kirurgjisë nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr.261 date 26.12.2019.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e gjurmueshmërisë së përdorimit të seteve kirurgjikale të sterilizuara nga SRSH
Situata:	<i>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:</i> Autoklava nuk është e certifikuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore dhe vazhdon të bëjë sterilizimin e seteve kirurgjikale kryesisht me kompleksitet të ulët. Administrimi i seteve të sterilizuara në autoklavën e spitalit bëhet në mungese të një urdhri dhe procedure të miratuara nga Drejtori i SRSH, gjithashtu setet kirurgjikale të sterilizuara nga kjo autoklavë nuk pajisen me pullën e sigurisë për evidentimin e cilësisë së sterilizimit. Përveç kostove të harxhimit të energjisë elektrike dhe ujit, nga sektori teknik për autoklavën është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Nga drejtuesit e SRSH nuk është hartuar rregullore apo udhëzim mbi administrimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuar nga autoklava e SRSH . Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuara dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndare sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH. Për këtë

	shkak në kontratën dypalëshe midis FSDKSH dhe Spitalit me nr. 45/2 prot. date 13.01.2020 pasqyra nr.15 (fq.53) përcaktohet që evidenca duhet të plotësohet nga SRSR sipas kompleksitetit të ndërhyrjeve. Kjo evidencë dërgohet elektronikisht dhe shkresore çdo muaj nga spitali në DRF jo me vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pra në regjistrat e operacionit për vitin 2018/2019 ndërhyrjet nuk janë pasqyruar sipas kompleksitetit të tyre, por sipas diagnozës në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet MSH dhe koncesionarit.
Kriteri:	Kontrata e MSHMS me koncesionarin, kontrata e financimit ndërmjet FSDKSH dhe koncesionarit dhe Kontrata /S e SRSR me DRF Shkodër
Ndikimi/Efekti:	Shmangie nga sistemi i referimit dhe mungesa e gjurmueshmërisë së përdorimit të seteve kirurgjikale të sterilizuara në autoklavën e SRSR
Shkaku:	Mungesa e evidentimit të përdorimit të seteve të veta kirurgjikale të SRSR
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori i SRSR të përcaktojë në aktet administrative (rregullore e veçantë, urdhra, udhëzime, etj.) mënyrën e përdorimit të seteve kirurgjikale që janë në inventarin e spitalit dhe sterilizohen në autoklavën e Spitalit, për të mundësuar evidentimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, në sallat kirurgjikale sipas planifikimit apo rasteve urgjente, si dhe dokumentimin e tyre në regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. D., në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

2.9. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale. Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Spitalin Rajonal Shkodër, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura, dhe për mjedisin e kontrollit

Titulli i gjetjes:	Sistemi i kontrollit të brendshëm të SRSR për periudhën objekt auditimi rezulton jo efektiv .
Situata:	Nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim të plote Ligji i MFK-së sipas parashikimeve të tij, për pasoj strukturat përgjegjëse kanë njohuri të pakta me kërkesat dhe parashikimet për zbatimin dhe krijimin e një mjedisi të brendshme efektiv të kontrollit të veprimtarisë së tyre ekonomiko administrative. Një nga problematikat e hershme të SRSR është mosfunksionimi i Këshillit Administrativ, duke cenuar sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këshilli Administrativ megjithëse është ngritur me vendim me nr. 1716 prot., datë 15.05.2019 mbi bazën e rekomandimit të përsëritura të KLSH, rezulton që nuk është mbledhur dhe nuk ka vendimmarrje sipas parashikimeve të neneve 13, 14, 15 të ligjit 9106 nëpër shërbimin spitalor

	në RSH, si me poshtë vijon: a) miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë; b) programon dhe i propozon Ministrit të Shëndetësisë ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut; c) propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij; ç) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra; d) i propozon Ministrit të Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të autoritetit spitalor të qarkut; dh) emëron dhe shkarkon drejtorët e spitaleve të qarkut, në bazë të propozimit të bërë nga drejtori ekzekutiv. 2.Nga ana e Drejtuesve të SRSH nuk është përpiluar deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në SRSH, veprime që janë në mospërputhje me udhëzimin e MF me nr. 28 date 15.12.2011 në mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike pika 15, germa ñaò. 3.Nga ana e Drejtuesve të SRSH nuk është ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), duke vepruar në mos përputhje me ligjin e MFK, kreu II, neni 8, pika 2 dhe 8/b dhe neni 9 germa ç 4.Nga ana e drejtuesve të SRSH, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, nuk janë kryer vlerësime periodike të stafit administrativ të SRSH, mbi performancën dhe realizimin e detyrave të punonjësve mbi bazën e përshkrimeve të detyrave në kontratën e punës dhe rregulloren e përgjithshme. 5.Nga auditimi evidentohet që stafi administrativ, has shumë vështirësi në kuptimin e komponentëve të Ligjit të MFK, dhe nga ana e Drejtuesve të SRSH nuk është planifikuar apo realizuar trajnim pranë ASPA për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve të administratës me tematike të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në mospërputhje me manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kap. II pika 2.5.1 në mjesdise të kontrollit, paragrafët nëpolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore dhe nëprofesionalizmi i stafit. Për vitin 2018, 2019, 2020 SRSH, nuk ka parashikuar programe trajnimi për stafin, për njohjen dhe zbatimin e Ligjit të MFK dhe Prokurimeve Publike. Për sa më lartë, sistemi i kontrollit të brendshëm i SRSH vlerësohet jo efektiv dhe me mangësi të shumta në lidhje me funksionimin e të pese komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie. Në mungesë të hartimit dhe dërgimit të pyetësorit të vetëvlerësimit grupi i auditimit të KLSH-së i përcolli Drejtorisë së SRSH pyetësorin e vetëvlerësimit, i cili iu shpërnda strukturave përgjegjëse nga Drejtori i SRSH. <i>Përgjigjet e dhëna nga strukturat përgjegjëse të SRSH ishin përgjithësisht narrative dhe nuk jepnin përgjigje të arsyetuara dhe të mbështetura në evidence dokumentare.</i>
--	--

	<i>Mungesa e funksionimit të Këshillit Administrativ përbën një nga dobësitë me të theksuar të SRSH, mungesa e cila multiplikon shumë dobësi të tjera në drejtimin të përgjegjësiave menaxheriale. Gjithashtu dhe mungesa e Njesisë së Auditit të Brendshme kanë krijuar premisa të mos funksionimit efektiv të kontrollit të brendshëm me 5(pese) komponentët e tij.</i> Drejtuesit e SRSH, në cilësinë e nëpunësve autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në Ligjin për MFK, nenin 20 në Mjedisin e kontrollit, pika 1 ku përcaktohet, që: <i>Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.</i>
Kriteri:	Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 në Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nenin 20 në Mjedisin e kontrollit, pika 1
Ndikimi/Efekti:	Rritja e efektivitetit të SRSH për arritjen e objektivave të vendosura, krahas përcaktimit të misionit, strategjisë në mënyrë të veçantë duhet të fokusohet në drejtim të hartimit dhe monitorimit të planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Përcaktimi i këtyre objektivave duhet të jenë sanksionuar në akte administrative të Drejtuesit të institucionit dhe të vendimeve të këshillit administrative.
Shkaku:	Mos respektimi i plotëso
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori i SRSH, të bëjë funksional veprimtarinë e këshillit administrativ duke planifikuar dhe thirrur në mbledhje anëtarët e këshillit administrativ për të bërë të mundur që çdo vendimarrje që është kompetence e tij, të merret dhe të miratohet nga ky organ i parashikuar nga ligji organik.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr., në cilësinë e nëpunësve të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Titulli i gjetjes:	SRSH ka mangësi në aktivitetet e kontrollit.
Situata:	SRSH nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit në kundërshtim me nenin 16 të ligjit të MFK. Dega e financës mbanë dhe përpunon të dhënat kontabël në format Excel dhe jo në një sistem informatik profesional të miratuar kontabël SRSH nuk ka kod të brendshëm etik ose kod sjellje, rregullore apo udhëzim për marrjen e masave disiplinore. Veprime në mospërputhje me nenin 22 pika 1 e Ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është parashikuar që: <i>Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.</i>

Kriteri:	Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ligji nr. 114/2015, nëPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik
Ndikimi/Efekti:	Risk i Lartë për menaxhimin e fondeve publike.
Shkaku:	Mos vlerësimi i duhur nga drejtimi i shoqërisë i dispozitave ligjore në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtorja e Spitalit Rajonal Shkodër, të planifikojë dhe të realizoj blerjen e një sistemi informatik financiar në gjuhen shqipe, të certifikuar sipas standardeve të miratuara të mbajtjes së evidencës kontabël.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Titulli i gjetjes:	Në SRSH, nuk ka strategji të zhvillimit institucional dhe profesional.
ituata:	SRSH nuk ka hartuar, strategji të riskut, në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK. SRSH nuk ka hartuar, regjistër risku. Strukturat dhe sektorët e SRSH nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve potencial të sektorëve përkatës së SRSH. Për sa më lart, drejtuesit e SRSH, në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit të MFK, nëPërgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut dhe neni 21 nëMenaxhimi i riskut, ku përcaktohet që: <i>Neni 10/1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.</i> <i>Neni 21/1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.</i> <i>Neni 21/2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.</i>
Kriteri:	Ligji 10296, datë 08.07.2010, nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e regjistrimit të riskut ka ndikuar në mos identifikimin dhe kategorizimin e risqeve potenciale, që mund të shfaqen gjatë veprimtarisë së SRSH për parandalimin e ndodhjes së tyre.
Shkaku:	Mungesa e strategjisë dhe regjistrimit të riskut për identifikimin dhe kategorizimin e risqeve potenciale që mund të shfaqen gjatë ushtrimit

	të veprimtarisë së SRSH.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Drejtoria e SRSH nëpërmjet grupeve të ngritura të punës të filloj hartimin e strategjisë së zhvillimit të spitalit, duke përcaktuar objektiva afat shkurtra dhe afat gjata për arritjen dhe realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura në drejtim të përmirësimit të kujdesit shëndetësor spitalor.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Titulli i gjetjes:	SRSH nuk ka zhvilluar një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.
Situata:	Në Rregulloren e brendshme të SRSH, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të SRSH. SRSH, nuk posedon faqe Web-i zyrtar. SRSH, nuk ka të publikuar online programin e transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 nëPër të Drejtën e Informimitò Veprime në mospërputhje me nenin 23 të Ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është përcaktuar që: <i>Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë...</i>
Kriteri:	Ligji për MFK, neni 23 nëInformacioni dhe komunikimiò, Ligji nr. 119/2014 nëPër të Drejtën e Informimitò dhe Rregullorja e Brendshme e SRSH
Ndikimi/Efekti:	Në sistemin e komunikimit dhe informimit të brendshëm administrativ
Shkaku:	Mungesa e një komunikimi efektiv, në të gjitha nivelet e hierarkisë së SRSH.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	SRSH të filloj procedurat për ndërtimin e faqes së web-it zyrtar, ku të pasqyroj programin e transparencës, gjithashtu e gjithë struktura administrative, mjekësore e miratuar e spitalit duhet të komunikoj vetëm me adresë e-mail-i zyrtar, si brenda institucionit po ashtu dhe jashtë saj.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z.V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj. T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit të autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z.A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Spitali Rajonal Shkodër kanë vetëm një specialist auditi në të pa certifikuarò. Në SRSH njësia e AB nuk është plotësuar sipas parashikimeve të VKM nr. 83 datë 3.2.2016 nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin

publikò, ku çdo njësi publike që plotëson kriteret përcaktuar në vkm duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) auditues, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë së auditit të brendshëm.

Titulli i gjetjes:	Mungon sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Situata:	SRSB nuk ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB). Spitali Rajonal Shkodër kanë vetëm një specialist të certifikuar për auditin e brendshëm, por kjo strukturë nuk është plotësuar në përputhje me VKM nr. 83 datë 3.2.2016 nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò, ku çdo njësi publike që plotëson kriteret e përcaktuar në VKM duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Nga strukturat përgjegjëse të SRSB, nuk janë hartuar raporte ekonomiko financiar mbi aktivitetin e shoqërisë, për periudhën 6-mujore apo vjetore, gjatë vitit 2018-2020, të cilat duhej t'iu paraqiteshin Këshillit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim. Nuk ka kontrata midis shëfave të shërbimit dhe SRSB Nuk ka rregullore për shërbimin farmaceutik. Sistemi informatik Spitalor SIIS është i instaluar në SRSB, funksionon në një rrjetë lokal pra funksionon off line duke përpunuar të dhëna vetëm për llogari të SRSB. Sistemi është i personalizuar mbi bazën e kërkesave të SRSB. Sistemi SISP nuk mundëson lajmërimin e barnave në prag skadencës. Sistemi SISP nuk mundëson vendosjen e kufizimeve gjatë fazës së marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit, sipas parashikimeve të kontratave të furnizimit mbi afatet kohore të përdorimit të barnave dhe materialeve të mjekimit, në rastin kur ato nuk plotësohen, atëherë nga anëtarët e komisionit të kolaudimit të mos ketë mundësi që ti bëjnë hyrje në Farmacinë e Spitalit. Ky personalizim i sistemit informatik SISP do të ndikonte në uljen e sasisë së barnave të skaduara. Veprime në mospërputhje me nenin 24 të Ligjit për MFK të drejtuesve të institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është përcaktuar që: <i>Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.</i>
Kriteri:	Ligji i MFK, neni 24 nëMonitorimiò, Ligji nr. 114/2015, nëPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò, Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 nëMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitet publikeò.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e vlerësimit nëse sistemi i drejtimit, politikat, veprimtaria dhe kontrolli, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, të kenë mundësuar shërbimeve publike efektive dhe eficiente, për të adresuar drejt risqet potenciale, për të dhënë garanci të

	mjaftueshme në realizimin e objektivave të vendosura nga SH.A Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive efektive, efçente dhe me ekonomicitet, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e brendshme, gjenerimit të informacioneve operative dhe financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit dhe të aktiveve.
Shkaku:	Mungesa e Njësisë së Auditit të Brendshëm
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	SRSJ të bëjë të gjitha përpjekjet, dhe në bashkëpunim me MSHMS të ngrejë, dhe të bëjë efektiv njësinë e auditit të brendshëm për të monitoruar dhe kontrolluar veprimtarinë ekonomiko financiare.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V. M. , në cilësinë e ish drejtorit (05.12.2017- 02.07.2018); Znj.T. Rr. , në cilësinë e ish nëpunësit te autorizuar të deleguar (03.07.2018 - 14.04.2019); Z. A. D. , në cilësinë e drejtorit (14.04.2019 në vazhdim)

2.10. Mbi zbatimin e fondeve të akorduara dhe shpenzuara për përballimin e situatës së pandemisë COVID-19.

I. Spitali Rajonal Shkodër me shfaqen e pandemisë Covid-Sars 19, bazuar në orientimet e marra nëpërmjet akteve ligjore të nxjerra nga MSHMS, duke filluar nga 11 Mars 2020, ka marrë angazhimet/masat për përballimin e pandemisë, dhe krijimin e kushteve mbrojtëse të personelit mjekësor, në fazat fillestare, masa të cilat rezultojnë se kryesisht janë në drejtim të realizimit të shpenzimeve për përballimin e situatës dhe konkretisht:

1. *Dezinfektimpër ambientet spitalore për vlerën prej 118,800 lekë me tvsh.*
2. *Blerje materiale mjekësore mbrojtëse parandaluese për vlerën prej 114,000 lekë me tvsh.*
3. *Blerje doreza ekzaminimi, medikamente dhe materiale mbrojtëse në vlerën prej 2,620,272 lekë me tvsh.*
4. *Shpenzime për dieta në vlerën prej 146,900 lekë*

Nga auditimi i realizimit të shpenzimeve të sipërcituara, nuk janë konstatuar probleme në lidhje me përlllogaritjen dhe shpenzimin e tyre.

II. Në mbështetje të VKM nr. 207 datë 10.3.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë, Urdhrit të M.SH.M.S. nr. 224 datë 01.04.2021 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit në diagnostikimin dhe trajtimin e të sëmurëve Covid-19, për periudhën objekt auditimi, Mars 2020 i Dhjetor 2021, sipas të dhënave të vëna në dispozicion për persona të paraqitur me simptoma të Covid-19 rezultojnë:

- 4970 personave të paraqitur në urgjencë,
- 3315 persona kanë marrë shërbim nga urgjenca paraspitalore,
- 2496 raste janë ndjekur nga mjekët infeksionistë,
- 1166 raste janë ndjekur nga mjekët pneumologë,
- 133 raste janë ndjekur nga mjekët reanimatorë
- 1179 ekzaminime të realizuara, për CT pulmonar

Nga të gjitha rastet e përshkruara më sipër, vetëm për raste 257, nga SRSJ janë referuar dhe dërguar për trajtim më të specializuar pranë spitaleve Covid në Tiranë.

Lidhur me shpërblimet e personelit mjekësor dhe personelit mbështetës rezulton se procedurat janë referuar në dokumentet si më poshtë:

1. Listat e personelit mjekësor, infermieror dhe mbështetës që kanë trajtuar pacientë me Covid-19, për secilin shërbim të sjella nga kr/infermieri i shërbimit dhe shefi i shërbimit, të rakorduara me listëprezencën mujore në pune të personelit. Listat mujore janë mbajtur duke pasqyruar të dhëna si: emër, mbiemër pacienti, numër kartelet, datë kontakti / ditëqëndrimi, personeli që është kujdesur (mjek, infermier, sanitar etj.)
2. Regjistrat ambulator fizik të shërbimit të pneumologjise dhe të poliklinikës të cilët rezultojnë të sekretuar për pacientët jo-spitalorë.
3. Dokumentacioni laboratorik mbi pacientët e konstatuar pozitiv, nga Struktura e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësore- Shkodër.
4. Konfirmimet për raste të veçanta të marra nga Sistemi i Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI) Tirane.
5. Protokollet e përkufizimit të rastit të ardhura nga M.SH.M.S. dhe I.SH.P.
6. Kartelat ditore dhe/ose të shtrimit të pacientëve përgjatë gjithë periudhës së pandemisë.

Të dhënat e raportuara nga Sektori i Financës dhe të rakorduara edhe me të dhënat e paraqitura nga Zv/Drejtori i Shërbimeve Klinike, për Shpërblimet Covid-19, raportohen në tabelë:

Muaji	Viti	Nr. i personelit përfitues të shpërblimit	Vlera
Mars	2020	37 Personel	174375
Prill	2020	110 Personel	1450682
Maj	2020	36 Personel	206832
Qershor	2020	132 Personel	2872165
Korrik	2020	182 Personel	4750460
Gusht	2020	127 Personel	3935180
Shtator	2020	155 Personel	2885258
Tetor	2020	133 Personel	3725176
Nëntor	2020	209 Personel	8439379
Dhjetor	2020	192 Personel	8940218
Janar	2021	174 Personel	7531821
Total			44,911,546

Grupi i auditimit përzgjedhi si kampion për të audituar pagesat e muajve Korrik dhe Nëntor-Dhjetor, si muaj me vlera të larta, për shkak të angazhimit të një numri të madh të personelit spitalor. Nga auditimi nuk u konstatuan probleme mbi përlllogaritjen dhe kryerjen e pagesave. Për sa trajtuar është mbajtur akt verifikimi nr. 1, datë 14.5.2021, me Zv/Drejtorin e Shërbimeve Teknike A. S., Zv/Drejtorin e Shërbimeve Administrative L.M.dhe Përgjegjësen e Sektorit të Financës M. N. , nga të cilët nuk është kundërshtuar akti i mbajtur nga përfaqësuesit e KLSH.

2.11.Të ndryshme:

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është paraqitur ankesa/kërkesa e administruar me nr. 1016, datë 28.9.2021, e punonjës L. Gj. , me objekt nëKërkesë për verifikimin e ligjshmërisë së Urdhrit nr. 135, datë 15.9.2021 të Drejtorit të SRSHò.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikës rezulton se Znj. Gj. , është larguar nga detyra e Përgjegjëses të Sektorit të Burimeve Njerëzore të SRSH me urdhrin e Drejtorit nr. 135, datë 15.9.2021 nëLëvizje në detyrë, urdhër i referuar në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 nëPër shërbimin spitalor në RSHò, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 nëKodi i Procedurave Administrativeò, Rregullores së SRSH, ligjit nr. 9125, datë 29.07.2003 nëKodi i Punës së RSHò, në zbatim të rekomandimeve të KLSH,si dhe për përmirësimin e punës.

Urdhri i sipërcituar rezulton akt i nxjerrë pa referim ligjor pasi nuk ka të përcaktuar asnjë dispozitë konkrete e cila përligj titulli i SRSH miratimin e tij, duke e bërë aktin lehtësisht të cënueshëm administrativisht dhe gjyqësish. Akti citohet se ka dalë në zbatim të rekomandimeve, fakt i pa vërtetë, përse KLSH nuk ka dalë me një vendim duke mos rekomanduar SRSH për masa disiplinore. Përdorimi i pa drejtë/ligjshëm i një institucioni si KLSH, (në kushtet kur nuk ka asnjë rekomandim të miratuar) por dhe institucione të tjera përbën shkak për precedentë pasoja të cilat duhet ti dëmshpërblej përdoruesi i paautorizuar (miratuesi i urdhrit nr. 135) dhe jo institucioni apo buxheti i shtetit.

Konkluzioni: Spitali Rajonal Shkodër, drejtuesi aktual i tij, me urdhrin nr. 135, datë 15.9.2021, ka prodhuar një akt në kundërshtim me sa referuar si dhe ne tjetërsim të fakteve e rrethanave, përse KLSH nuk ka rekomanduar masa për SRSH dhe as më pak për znj.Gj. .

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SRSH, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 56 rekomandime te pranuar plotësisht nga SRSH, nga te cilat:

-31 masa organizative, 20 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 9 masa janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.

-Për zhdëmtim e dëmit ekonomik të shkaktuar janë rekomanduar 11 masa, 7 prej tyre janë ne proces, 1 është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare ne buxhetin e shtetit, janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat 1 është zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim është proces zbatimi.

-Për parregullsitë e konstatuara janë rekomanduar 12 masa disiplinore për personat përgjegjës, të cilat janë zbatuar plotësisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Spitali Rajonal Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultojnë në proces, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në nenin 15 pika 2 e Kontratës me nr. 45/2 date 13.01.2020, Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, për vitin 2020 nuk ka ngritur komision ñad hoc për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit, komisioni duhet të hartonte në bazë të kërkesave të shërbimit të shërbimit, listën vjetore të nevojave për barnave dhe materialeve të mjekimit për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit normal të shërbimeve spitalore deri në realizimin e procedurave të blerjes për vitin pasardhës. Lista e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit duhet të jetë e saktë dhe realiste për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e stokut të barnave të skaduara.

Drejtori i SRSH z. A.D. me shkresën nr.44 prot. date 09.01.2020 dhe nr.158 date 20.01.2020, ka përcjell në MSHMS listën me kërkesa për barna dhe materiale mjekimi për vitin 2020-2021. Por kjo listë nuk është hartuar nga asnjë komision. Veprime këto në mospërputhje me Kontrata/S nr. 45/2 date 13.01.2020, neni 15 pika 2 të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2020 ndërmjet FDSKSH dhe SRSH, ku përcaktohet se:

ñLista e barnave që propozohet për planifikim për blerje për vitin ushtrimor, miratohet fillimisht nga grupi teknik i ngritur ñAd hoc nga drejtori i spitalit dhe më pas dërgohet për miratim në MSHMS

(Më hollësisht trajtuar në pikën pika 2.3.3, faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit, të përcjell pranë MSHMS, listën e barnave dhe materialeve të mjekimit për vitin ushtrimor, vetëm pas miratimit paraprak nga grupi teknik i ngritur për planifikimin e tyre.

Në vijimësi

2.2 Rekomandimi: SRSH të fillojë hartimin e rregullores për shërbimin farmaceutik duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 dhe 2019 është krijuar vlera më e madhe stokut të medikamenteve materialeve të mjekimit, të cilat kanë skaduar në farmacinë e Spitalit Rajonal të Shkodrës, si rezultat i kërkesave jo reale të shërbimeve dhe të planifikimit dhe menaxhimit jo eficient të tyre nga strukturat përgjegjëse të SRSH, duke shkaktuar një efekt negativ në buxhetin e SRSH. Si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë përgjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të Spitalit Rajonal Shkodër barna dhe materiale mjekimi në vlerën totale 11,116,722 lekë.

Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse. Grupi i punës për planifikimin e barnave dhe materialeve të mjekimit është mjaftuar vetëm me plotësimin e kërkesave të paraqitura nga shefat e shërbimit pa analizuar gjendjen në magazinën e farmacisë dhe të qarkullimit të tyre në dy vitet e fundit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozojë masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është marrë asnjë masë disiplinore për strukturat e ngritura për mos realizimin e inventarizimit sipas afateve të vendosura nga vet drejtuesja e institucionit, për më tepër që nga ana e saj ka patur informacion për mos zbatim të UB nr. 09 datë 16.01.2019, pasi me Urdhrin nr. 61 datë 02.04.2019 ka bërë një ndryshim të një anëtarit të komisionit qendror të inventarizimit. Gjithashtu anëtarët e komisionit qendror që kanë patur detyrë të koordinojnë punën e 6 komisioneve, nuk kanë respektuar afatet e paraqitjes së relacionit përfundimtar për inventarizimin. Anëtarët e komisionit qendror për inventarizimin periodik të aktiveve për vitin 2018, nuk kanë zbatuar UB nr. 09 datë 16.01.2019 dhe kanë tejkaluar kompetencat e përcaktuara duke marrë kompetencat e Titullarit të institucionit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të relacionit të inventarizimit për komisionin nr. 5, veprime këto në mospërputhje ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik të rregullores së Spitalit Rajonal Shkodër, Rregulloren e funksionimit Teknik (nr. 882 prot., datë 19.09.2011) si dhe Urdhrin e Brendshëm nr. 09 datë 16.01.2019 për inventarizimin periodik të aktiveve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH-së të marr masat që në të ardhmen procesi i inventarizimit periodik të aktiveve, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në aktet administrative të nxjerra nga vet institucioni, për të mundësuar që aktivet e propozuara jashtë përdorimit të reflektohen në evidencën kontabël të vitit ushtrimor.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se Spitali Rajonal Shkodër, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet) dhe pajisjet mjekësore diagnostikuese dhe laboratorike. Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të marrë masat për hartimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël sipas standardeve ligjore të kërkuara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRSH, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie dhe nga ana e drejtuesve të këtij institucioni, për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për ti regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, të marrë gjitha masat e nevojshme, për identifikimin, inventarizimin fizik dhe regjistrimin e aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër, si dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Deri më datën 31.12.2021

7. Gjetje nga auditimi: Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionojnë dhe për një pjesë të tyre, nga komisioni është propozuar nxjerrja jashtë përdorimit dhe më pas asgjësimi i tyre, sipas procedurave ligjore në fuqi. Disa nga aparaturat mjekësore janë pa dokumente dhe disa të tjera nuk janë të regjistruar në inventarin e SRSH. Nga shqyrtimi i të dhënave mbi inventarin e pajisjeve mjekësore dhe përpunimit të tyre nga pikëpamja sasiore nga grupi i auditimit rezulton:

-SRSH posedon 471 pajisje mjekësore, nga këto 156 pajisje ose 33.1 % e tyre nuk funksionojnë dhe qëndrojnë prej vitesh në ambientet e brendshme të reparteve të SRSH duke ndikuar në ndotjen e ambientit për shkak të problematikave që ato kanë në drejtim të mundësisë së rrezatimit etj., duke ndikuar në cilësinë e shëndetit të pacienteve dhe personelit të spitalit;

-Të gjitha pajisjet mjekësore nuk janë regjistruar sipas formularit tip të inventarizimi, sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) të pasqyruar në udhëzuesin e saj;

-Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO, njësia e inxhinierisë klinike pranë SRSH ka regjistruar 287 pajisje ose 61 % të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: SRSH në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bej vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore

dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SRSH të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor gjatë vitit 2018, për disa procedura prokurimi ka bërë copëzim të fondit limit dhe shmangie nga procedurat konkurruese të prokurimit duke realizuar më shumë se një procedurë me blerje të vogël për mallra, shërbime, pune me të njëjtin objekt prokurimi. Më poshtë paraqitet copëzimi i fondit limit prej 1,764,178 lekë për realizimin e blerjeve të materialeve të kancelarisë të cilat nga AK janë parashikuar dhe realizuar në tre procedura të blerjeve të vogla, në kundërshtim me nenin 8, 29 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëpër miratimin e rregullave të prokurimit publik, si më poshtë:

a. Procedura me objekt “*Blerje kancelari*” me fond limit 800,000 lekë, me vlerë të kontratës 372,000 lekë e zhvilluar me datën 20/09/2018.

b. Procedura me objekt “*Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi)*” me fond limit 800,000 lekë, me vlerë të kontratës 697,000 lekë e zhvilluar me datë 20/06/2018.

c. Procedura me objekt “*Blerje shtypshkrime (Letër shkrimi dhe sende të tjera)*” me fond limit 164,178 lekë, me vlerë të kontratës 164178 lekë e zhvilluar me datë 08/02/2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH në cilësinë e Titullarit të AK, të kërkojë relacion shpjegues nga strukturat përgjegjëse të hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, që të parandaloj mundësinë e copëzimit të fondeve, nëpërmjet përdorimit të procedurave të blerjeve të vogla për blerje dhe shërbime me të njëjtin objekt prokurimi.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Marrja në dorëzim e sistemit të radhës ku përfshihet kompjuteri server, printer dhe TV Led nga komisioni përkatës i marrjes në dorëzim dhe kolauditimit pa verifikuar dhe identifikuar specifikimet teknike dhe markën e pajisjeve përbërëse të sistemit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Marrja në dorëzim e mallit është bërë sipas Aktit Teknik nr. 1624 prot datë 08.05.2018 nga komisioni i marrjes në dorëzim. Akti Teknik nuk është miratuar nga Titullari i institucionit ish i Drejtori V. M., pasi nuk është nënshkruar prej tij.

Lidhur me marrjen në dorëzim të mallrave rezulton se pajisjet e lëvruara janë të përshkruara sipas listës, pjesë e aktit por pa përcaktuar vendin e origjinës, markën (Brand Name). Po ashtu për sa i përket njësisë së prenotimit me monitor me prekje dhe printer POS (fig. nr. 1), monitor salle pritje (fig. nr. 2) dhe terminal thirrje numër radhë në shërbime (fig. nr. 4) janë përcaktuar si shembuj ilustrues, çka nënkupton se në momentin e hartimit të aktit dhe marrjes në dorëzim të mallit produktet nuk kanë qenë disponibël fizikisht. Për sa cituar më lart, rezulton se jemi para të njëjtave dokumenteve identik (formulari nr. 3 me nr. 837 prot., datë 01.03.2018 nëftese për ofertë) miratuar nga Titullari i AK z. V. M. dhe kontratës së shërbimit nr. 1323 prot., datë 13.04.2018 të nënshkruar nga Titullari i AK V. M. dhe BOE O. shpk përfaqësuar nga R. K. dhe S.&S. përfaqësuar nga A. K.. Në këto kushte nuk rezulton e dokumentuar se cilat produkte hardëare-ike apo pajisje janë marrë në dorëzim dhe si kanë funksionuar ato në momentin e hartimit të aktit teknik dhe të marrjes në dorëzim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së SRSH të ngrihet grupi i punës për të verifikuar dhe identifikuar markën dhe specifikimet teknike të pajisjeve përbërëse hardware-ike të sistemit të radhës ku përfshihet kompjuter server, printer dhe TV Led të dorëzuar nga BOE ñO. shpk dhe ñS.&S.ò.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata e qirasë nr. 368/1 prot., datë 07.08.2002, ka afat 20 vjeçar dhe përfundon më datë 10.07.2022. Kjo kontratë është lidhur kundërshtim me referencën ligjore të kohës për sa i përket periudhës së vlefshmërisë. Afati i vendosur për një periudhë 20 vjeçare, është në tejkalim të kompetencave të ish Titullarit të Spitalit të asaj periudhe, pasi për kontratat me afat mbi 1 vit të drejtën e lidhjes së saj i takon organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit, në këtë rast të drejtën e përfaqësimit të pronarit e ka Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtori dhe zyra juridike e Spitalit, të hartojnë dhe të lidhin kontratë qiraje sipas akteve nën ligjore në fuqi për objektin “ish punti i gjakut, spitali i vjetër”.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr. 4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m² përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat Bar-Bufë. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirimin e sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 nëPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 nëPër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: SRSH të bëjë inventarizimin dhe përditësimin e pasurisë së paluajtshme dhe aksesoreve të saj si dhe në bashkëpunim me MSHMS, të marrin masat e nevojshme për regjistrimin e pasurisë (truall ndërtesë) pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër.

Menjëherë e në vijimësi

11.2 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH, t’i drejtohet zyrtarisht subjektit privat, i cili është duke përdorur sipërfaqe të truallit të pasurisë së paluajtshme të spitalit, me qëllim lirimin e saj dhe në rast të mosveprimit nga subjekti privat, t’i drejtohet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV).

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr. 3 datë 14.05.2021 (nr. 230/18 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se:

Në ambientet e brendshme të spitalit shfrytëzohet nga subjekti C. Bank një sipërfaqe prej 5.6 m² prej datës 03.02.2014. Në lidhje me këtë çështje SRSH nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektin bankar duke vepruar në mospërputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 nëPër përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore për të lidhur kontratë qiraje sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së SRSH të analizohet shkaqet dhe të merren masa për personat përgjegjës, që nuk kanë lidhur kontratë qiraje me C. Bank dhe për pasojë nuk është arkëtuar shuma 71,400 lekë, e cila konsiderohet një e ardhur e munguar për spitalin. Gjithashtu Drejtori dhe zyra juridike e Spitalit, të hartojë dhe të lidhin kontratë qiraje me subjektin C. Bank për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme të spitalit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga ana e drejtuesve të SRSH brenda periudhës së auditimit nuk është kërkuar kopje e kontratës koncesionare dhe ajo financiare të cilat rregullojnë marrëdhënien kontraktuale. Nga evidenca dokumentare konstatohet se nuk ka komunikim nga SRSH me MSHMS për evidentimin e problemeve të zbatimit të kontratës., veprime këto në mospërputhje me kontratën Spitalore të FSDKSH dhe SRSH, neni 9, pika 1 në Detyrime të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S.Se.ò, parashikohet:

Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, nëPër ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikaleò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Koncesionare nëS. Se.ò Sh.p.k.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë për kontratën koncesionare me objekt nëKontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikaleò.

Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.Se. SHPK nuk ka dorëzuar pranë SRSH dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

a. Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 nëPër miratimin e rregullores nëPër administrimin e mbetjeve spitaloreò, Kreu II, pika 7.1.

b. Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 nëPër miratimin e rregullores nëPër administrimin e mbetjeve spitaloreòò, Kreu II, pika 7.2.

c. Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç.

d. Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë nëDokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshmeò, në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin nga koncensionari nëS.Se.ò SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Mungesa e gjurmueshmërisë së përdorimit të seteve kirurgjikale të sterilizuara nga SRSH. Autoklava nuk është e certifikuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore dhe vazhdon të bëjë sterilizimin e seteve kirurgjikale kryesisht me kompleksitet të ulët. Administrimi i seteve të sterilizuara në autoklavën e spitalit bëhet në mungese të një urdhri dhe procedure të miratuara nga Drejtori i SRSH, gjithashtu setet kirurgjikale të sterilizuara nga kjo autoklavë nuk pajisen me pullën e sigurisë për evidentimin e cilësisë së sterilizimit. Përveç kostove të harxhimit të energjisë elektrike dhe ujit, nga sektori teknik për autoklavën është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Nga drejtuesit e SRSH nuk është hartuar rregullore apo udhëzim mbi administrimin dhe evidentimin e ndërhyrjeve në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara nga autoklava e SRSH. Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e

autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuara dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndara sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim ky në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH të përcaktojë në aktet administrative (rregullore e veçantë, urdhra, udhëzime, etj.) mënyrën e përdorimit të seteve kirurgjikale që janë në inventarin e spitalit dhe sterilizohen në autoklavën e Spitalit, për të mundësuar evidentimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, në sallat kirurgjikale sipas planifikimit apo rasteve urgjente, si dhe dokumentimin e tyre në regjistrin e ndërhyrjeve kirurgjikale.

Menjëherë e në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Administrativ.

Një nga problematikat e hershme të SRSH është mosfunksionimi i Këshillit Administrativ, duke cenuar sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këshilli Administrativ megjithëse është ngritur me vendim me nr. 1716 prot., datë 15.05.2019, mbi bazën e rekomandimit të përsëritura të KLSH, rezulton që nuk është mbledhur dhe nuk ka vendimmarrje sipas parashikimeve të nenëve 13, 14, 15 të ligjit 9106 për shërbimin spitalor në RSH.

Sistemi i kontrollit të brendshëm të SRSH për periudhën objekt auditimi rezulton jo efektiv. Nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim të plotë ligji i MFK-së sipas parashikimeve të tij, për pasojë strukturat përgjegjëse kanë njohuri të pakta me kërkesat dhe parashikimet për zbatimin dhe krijimin e një mjedisi të brendshëm efektiv të kontrollit të veprimtarisë së tyre ekonomiko administrative.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Drejtori i SRSH, të bëjë funksional veprimtarinë e këshillit administrativ duke planifikuar dhe thirrur në mbledhje anëtarët e Këshillit Administrativ për të bërë të mundur që çdo vendimmarrje që është kompetence e KA, të merret dhe të miratohet nga ky organ i parashikuar nga ligji organik.

Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Dega e financës mban dhe përpunon të dhënat kontabël në format Excel dhe jo në një sistem informatik profesional të miratuar kontabël. SRSH nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit, veprim ky në kundërshtim me nenin 16 të ligjit të MFK. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 22 pika 1 e ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është parashikuar që:

Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, të planifikojë dhe të realizojë blerjen e një sistemi informatik financiar në gjuhën shqipe të certifikuar sipas standardeve të miratuara të mbajtjes së evidencës kontabël.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Në SRSRSH nuk ka strategji të zhvillimit institucional dhe profesional; nuk ka hartuar, strategji të riskut, në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK; nuk ka hartuar, regjistër risku, si dhe Strukturat dhe sektorët e SRSRSH nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve potencial të sektorëve përkatës. Për sa më lart, drejtuesit e SRSRSH, në cilësinë e nëpunësitor autorizues, për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit të MFK, nëPërgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSRSH nëpërmjet grupeve të ngritura të punës, të fillojë hartimin e strategjisë së zhvillimit të spitalit duke përcaktuar objektiva afat shkurtra dhe afat gjata për arritjen dhe realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura në drejtim të përmirësimit të kujdesit shëndetësor spitalor.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: SRSRSH nuk ka zhvilluar një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv. Në Rregulloren e brendshme të SRSRSH, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të saj.SRSRSH nuk posedon faqe Rëb-i zyrtar, për pasoj nuk ka të publikuar online programin e transparencës,në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 nëPër të Drejtën e Informimit, veprime këto në mospërputhje me nenin 23 të ligjit të MFK nga titullarët e institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit, ku është përcaktuar që:

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë... ”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: SRSRSH të filloj procedurat për ndërtimin e faqes së Web-it zyrtar, ku të pasqyrojë programin e transparencës, gjithashtu e gjithë struktura administrative, mjekësore e miratuar e spitalit duhet të komunikoj vetëm me adresë e-mail-i zyrtar, si brenda institucionit po ashtu dhe jashtë saj.

Menjëherë e në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Shkodër kanë vetëm një specialist auditit një të certifikuar. Në SRSRSH njësia e AB nuk është plotësuar sipas parashikimeve të VKM nr. 83 datë 3.2.2016 nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, ku çdo njësi publike që plotëson kriteret përcaktuar në VKM duhet të ngrejë njësinë e auditimit të brendshëm e cila duhet të përbehet nga jo më pak se 3 (tre) auditues, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë së auditit të brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 130-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: SRSRSH të bëjë të gjitha përpjekjet, dhe në bashkëpunim me MSHMS të ngrejë, dhe të bëjë efektiv njësinë e auditit të brendshëm për të monitoruar dhe kontrolluar veprimtarinë ekonomiko financiare.

Menjëherë e në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga intervistimi i punonjësve të Spitalit Rajonal Shkodër ku përfshihet dhe Drejtori i Spitalit, u konstatua një problematikë mbi dypunësimin e disa

punonjësve të Spitalit (Mjek të urgjencës, mjek të përgjithshëm) të cilët gjatë orarit të punës kryenin vizita ndaj pacientëve të cilët janë të shtruar në ambientet e Hemodializës në D.V. Sh.p.k. Pas intervistimit të këtyre mjekëve, ato pranuan para grupit të auditimit që kishin lidhur kontratë dhe me shoqërinë private të hemodializës në D.V. Sh.p.k kundrejt pagesës. Me gjithë pretendimet për një kontratë part-time (e cila nuk u vu në dispozicion) e cila është e pavlefshme në momentin që Titullari i Institucionit nuk është zyrtarisht në dijeni për shërbimet që këto mjek bëjnë në ambientet e kësaj shoqërie private si edhe pasi orari zyrtar i vizitave dhe konsultave në ambientet e Hemodializës është nga ora 07:00-16:00.

Nga vetë deklaratat e këtyre punonjësve rezulton se gjatë orarit zyrtar për të cilin kanë lidhur dhe kontratën individuale me Drejtorin e Spitalit Rajonal Shkodër, ata kryejnë shërbime të ndryshme dhe paguhen dhe nga shoqëria private në D.V. Sh.p.k, veprime këto në kundërshtim me nenin 110 dhe 119 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masa duke analizuar këtë situatë me qëllim shmangien e këtij fenomeni në të ardhmen.

Menjëherë e në vijimësi

22. Gjetjet nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 30 punonjës të rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj. Për sa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Shkodër, të marri masa që në të ardhmen në rastin e vendimit për largimin nga detyra të ndonjë punonjësi të ndiqen në mënyrë rigoroze të gjitha procedurat e përshkruara qartë në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Menjëherë e në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi. Në lidhje me dosjet e personelit, u kërkuar me zgjedhje 40 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua mungesa e dokumentacionit duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit nr. 511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, nëpër kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik. Emërimet dhe largimet e punonjësve në SRSH janë në mospërputhje me Urdhrin nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë nëpër ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore pika 1 dhe 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Shkodër, të analizoj këtë situatë ku janë punësuar punonjës në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe të nxjerri përgjegjësitë për mungesën e dokumentacionit të konstatuar nga grupi i auditimit për këto punonjës në dosjet e tyre personale.

Menjëherë e në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit për prokurimet, blerje me vlerë të vogël, për vitin 2020 konstatohet problematika e copëzimit të fondit për mallra që përfshihen në të njëjtin grup dhe kanë të

njëtit funksion kryesor. Autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurat, “Riparim mirëmbajtje objekte ndërtimore” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, “Riparim, asfaltim i territorit para shërbimit të Urgjencës” me fond limit 800,000 pa TVSH. Vlera totale prokuruar e copëzuar prej 1,600,000 lekë pa TVSH duhej të prokurohej në një procedure të vetme, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 40, pika 8 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë mallrat dhe shërbimet e të njëtit funksion në një procedurë të vetme për realizimin e një oferte sa më të favorshme ekonomike.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Të gjitha regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin Excel pasi institucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Nga drejtori i Spitalit të merren masa që drejtoria e financës të pajiset me një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij.

Deri më datën 31.12.2021

26. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i SR Shkodër nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, Sipas strukturës së vitit 2018 e vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorëve, kur në fakt, ligji organik specifikon përbërjen e Drejtorisë së SRSH në: Drejtori Ekzekutiv; Zv. Drejtori Ekonomik; Zv. Drejtori Teknik, si dhe Kryeinfermieri i Përgjithshëm. Pozicioni i 2 ZV është riemërtuar ndryshe dhe konkretisht në Zv/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe Zv/Drejtor i Shërbimeve Klinike, kur ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 nëpër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë në neni 18 pika 2 specifikon se: “Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me VKM”. Ndryshimi në emërtesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emërtesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese të SRSH, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas MFK, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, që në rastin e ndryshimit të emërtesave pa VKM ky pozicion nuk ekziston.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, me qëllim drejtimin e SRSH në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërpërmendura, të marrë masa për rregullimin e strukturës dhe emërtimeve si dhe arritjes së sigurisë dhe efektivitetit të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrat të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 31.12.2020, është konstatuar se është prokuruar për nëblerje ushqime 2020, (Loti 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Loti 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Loti 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Loti 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Loti 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020). Autoriteti Kontraktor në titull i ka emërtuar si procedura me lote, por janë zhvilluar si procedura me nëblerje me vlerë të vogël dhe pavarësisht emërtimeve në përshkrimin e të

dhënave rezultojnë se janë procedura pa lote. Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjesëtuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit, veprime këto në kundërshtim me nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 5, nenin 29 dhe nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është paraqitur ankesa/kërkesa e administruar me nr. 1016, datë 28.9.2021, e punonjës L.Gj., me objekt nëKërkesë për verifikimin e ligjshmërisë së Urdhrit nr. 135, datë 15.9.2021 të Drejtorit të SRSHe. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikës rezulton se znj. Gj., është larguar nga detyra e Përgjegjëses të Sektorit të Burimeve Njerëzore të SRSHe me urdhrin e Drejtorit nr. 135, datë 15.9.2021 nëLëvizje në detyrë, urdhër i referuar në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 nëPër shërbimin spitalor në RSHò, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 nëKodi i Procedurave Administrativeò, Rregullores së SRSHe, ligjit nr. 9125, datë 29.07.2003 nëKodi i Punës së RSHò, në **zbatim të rekomandimeve të KLSH**,si dhe për përmirësimin e punës. Urdhri i sipërcituar rezulton akt i nxjerrë pa referim ligjor pasi nuk ka të përcaktuar asnjë dispozitë konkrete e cila përligj titulli i SRSHe miratimin e tij, duke e bërë aktin lehtësisht të cenueshëm administrativisht dhe gjyqësish. Akti citohet se ka dalë në zbatim të rekomandimeve, fakt i pa vërtetë, për sa KLSH nuk ka dalë me një vendim duke mos rekomanduar SRSHe për masa disiplinore. Përdorimi i pa drejtë/ligjshëm i një institucioni si KLSH, (në kushtet kur nuk ka asnjë rekomandim të miratuar) por dhe institucione të tjera përbën shkak për precedentë pasoja të cilat duhet ti dëmshpërblej përdoruesi i paautorizuar (miratuesi i urdhrin nr. 135) dhe jo institucioni apo buxheti i shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, drejtuesi aktual i tij, në cilësinë e personit i cili ka miratuar dhe nxjerrë urdhrin nr. 135, datë 15.9.2021, të marrë masa për eliminimin e të gjitha pasojave të krijuara nga momenti i nxjerrjes së aktit, duke e kthyer znj. L.Gj. në pozicionin e mëparshëm, dhe institucionin në ligjshmërinë e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetja nga auditimi: Deri në fund të vitit 2018 është akumuluar një debi që kanë punonjës ose ish punonjës së SRSHe, si detyrim ndaj institucionit në shumën që kap vlerën 3,487,621 lekë. Ky detyrim është konstatuar nga auditimet të ushtruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor Shkodër. Në lidhje me këto detyrime SRSHe nuk ka ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e këtyre detyrimeve të punonjësve ndaj SRSHe.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, Sektori i Financës, Sektori Juridik, të marrin masa, të analizojnë situatën e debitorëve dhe të ndjekë të gjitha hapat administrative për arkëtimin e shumës **3,487,621 lekë**.

Deri më datën 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: OE nFas.ò ka dorëzuar pranë Spitalin Rajonal Shkodër 10 Lap Top, model nAC. A31...C6FNò. Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore i tre laptop-ve mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit nSy. Inf.ò të SO Windows 10, në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT. Pas verifikimit të specifikimeve teknike të tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që:

10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues nF...ò nërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e Fas. janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A31...C6FN me RAM-in 4 GB.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 108-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: SRSB të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **35,395 lekë** nga z. A.P., në cilësinë e përfaqësuesit të OE Fas. sh.a, si personi përgjegjës për dorëzimin e një malli me specifikime teknike të ndryshme nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST.

Deri më datën 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në SRSB është vendosur një ATM pa kontratë qiraje nga subjekti C. Bank. Bazuar në të dhënat e sektorit të shërbimeve të SRSB, ATM ka një konsum fuqie elektrike prej 0.8 KWh. Çmimi i energjisë elektrike për vitin 2018 ka qenë 14 lekë për KWh (pa TVSH) dhe 11 lekë për KWh (pa TVSH) për vitin 2019, 2020, 2021, çmime të referuara nga faturat e energjisë elektrike të faturuara nga OSHEE për SRSB.

Nga analiza dhe përlllogaritja e konsumit të energjisë elektrike ATM ka konsumuar energji elektrike sa më poshtë vijon:

Për vitin 2018 në vlerën **116,122 lekë** $\{(0.8k\ddot{o} h*24h*360dite*16.8lek\ddot{e}/k\ddot{o} h(me Tvsh))\}$;

Për vitin 2019 në vlerën **116,122 lekë** $\{(0.8k\ddot{o} h*24h*360dite*16.8lek\ddot{e}/k\ddot{o} h(me Tvsh))\}$;

Për vitin 2020 në vlerën **91,238 lekë** $\{(0.8k\ddot{o} h*24h*360dite*13.2 lek\ddot{e}/k\ddot{o} h(me Tvsh))\}$;

Për periudhën nga 01.01.201 deri 31.01.2021 në vlerën **7,603 lekë** $\{(0.8k\ddot{o} h*24h*30*13.2lek\ddot{e}/K\ddot{o} h (me Tvsh))\}$ *(llogaritja e konsumit të energjisë elektrike është bërë nga data e vendosjes së ATM deri në përfundim të periudhës së auditimit).* Vlera totale prej **331,085 lekë** konsiderohet dëm ekonomik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: SRSB të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **331,085 lekë** nga C. Bank, Dega Shkodër si detyrim i përlllogaritur për shfrytëzimin e ambienteve të brendshme pa kontratë qiraje dhe përdorimit të energjisë elektrike të SRSB.

Deri më datën 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2018, të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 7,009,992 lekë dhe vlerë kontrate 6,921,840 lekë, ose më pak se fondi limit prej 88,152 lekë dhe OE fitues "S...S" SHPK, është konstatuar se nga KVO dhe Titullari i AK nuk është bërë shpallja fituese e ofertës më të favorshme ekonomike, duke u sdukualifikuar ajo, për të njëjta mangësi si dhe oferta e shpallur fituese. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike nNI.ò SHPK & nK.ò SHPK me vlerë oferte prej 6,850,400 lekë dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE nS...Sò SHPK me vlerë ofertë prej 6,921,740 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe SRSB për vlerën prej **71,440 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, veprime këto në shkelje të ligjit nr. 9643, datë

20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, si dhe të fillojë procedurat për arkëtimin e vlerës **71,440lekë** nga anëtarët e KVO të përbërë nga M. K., në cilësinë e kryetarit të KVO, P. N. dhe A. I. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor V. M. , shkaktuar si pasojë e mos shpalljes fituese të ofertës më të favorshme ekonomike.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Janë konstatuar efekte negative financiare në shumën 75,313,230 lekë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Në periudhën përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 (brenda periudhës së auditimit) kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi për shkak të mos përdorimit të tyre, por dhe të planifikimit të gabuar dhe menaxhimit jo efektiv të medikamente dhe materiale mjekimi nga strukturat përgjegjëse pranë SRSH, si më poshtë:

a. Gjatë vitit 2018 në farmacinë e SRSH janë krijuar barna dhe materiale të skaduara në vlerë **4,952,140.30 lekë.**

b. Gjatë vitit 2019 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi stok të skaduara në vlerë **5,747,180.76 lekë.**

c. Gjatë vitit 2020 janë krijuar barna dhe materiale mjekimi të skaduara në vlerë **169,326.00 lekë.**

d. Përgjatë viteve 2015/16/17 të marra së bashku janë krijuar barna dhe materiale mjekësore të skaduara në vlerën **248,075.24 lekë.**

e. Në total në magazinën e farmacisë së Spitalit, gjenden të skaduar medikamente dhe materiale të mjekimit në vlerë **11,116,722 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën **11,116,722 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Koncesionari nëS. Se.ò përdor energjinë elektrike dhe ujin nga spitali, shpenzimet e te cilave mbulohen nga buxheti i SRSH.

Për konsumin e energjisë elektrike:

Në mungesë të matësve, konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH është:[200KËh*4 ore*22 ditë*13.2 lekë/kWh (me TVSh)] * 36 muaj= 8,363,520 lekë

Pra në përllogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklavat punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1kËh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SRSH.

Për konsumin e ujit:

Konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SRSH dhe në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: $10 \text{ m}^3/\text{ditë} \times 22 \text{ ditë} \times 36 \text{ muaj} \times 156 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 1,235,520 \text{ lekë}$.

Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S.Se. SHPK, **në vlerën 9,599,040 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të SRSH.**

Përllogaritja e përafërt nga grupi i auditimit është bërë mbi bazën e të dhënave të siguruar nga sektori i teknik në SRSH, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore **në vlerën 9,599,040 lekë**, si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncesionarit dhe jo buxhetit të spitalit.

Deri më datën 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se sipërfaqja totale në përdorim nga koncesionari është 296 m^2 brenda ambienteve të Spitalit. Koncesionari e ka përdorur këtë sipërfaqe nga data 20.11.2017 e në vazhdim, pa paguar qira. Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: *“Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar”*. Në kontratë është përcaktuar që në Autoriteti është në Ministria e Shëndetësisë SRSH në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk ka ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 në Përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar. Në lidhje me ambientet e dhëna në përdorim të koncesionarit, nuk është mbajtur nga SRSH detyrimi për marrjen e qerasë për këto ambiente, duke qenë se Spitali nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria e Shëndetësisë. Për periudhën në auditim dhe për sipërfaqen prej 296 m^2 duke llogaritur si tarifë dysheme, mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 në Përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar. Spitali Rajonal Shkodër nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit brenda SRSH, ku koncesionari zhvillon aktivitetin. E ardhura e munguar nga mos përfitimi i shumës së qerasë e cila llogaritet: $(296 \text{ m}^2 \times 150 \text{ lekë}/\text{m}^2 = 44,400 \text{ lekë}/\text{muaj})$. Koncesionari brenda periudhës së auditimit ushtron aktivitetin prej 36 muaj. Pra ne total kemi $44,400 \text{ lekë}/\text{muaj} \times 36 \text{ muaj} = 1,598,400 \text{ lekë}$. Për sa më lartë shuma **1,598,400 lekë** përbën efekt financiar negativ për SRSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 116-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: SRSH të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **1,598,400 lekë** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë larguar 21 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 30 punonjës të

rinj. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë larguar 34 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 63 punonjës të rinj.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë larguar 57 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, largime, dalje në pension etj) dhe janë emëruar 69 punonjës të rinj.

Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë hapur procese gjyqësore në 2 raste , ku gjykata i ka dhënë të drejtë punonjësve të larguar dhe deri më sot për të dy këta punonjës është likuiduar shuma totale prej **2,299,192 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e SRSH të analizoj shkaqet e krijimit të detyrimit prej **2,299,192 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SRSH duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e detyrimeve të reja në të ardhmen.

Deri më datën 31.12.2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 - 31.12.2018, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditori **8 procedura** me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **88,512,654 lekë**. Nga 8 procedura të audituara, konstatohet se në **3** procedura me vlerë kontrate **9,036,290 lekë**, ose **10%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **9,036,290 lekë**. Procedurat e audituara dhe konstatuara me problematika janë:

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 7,009,992 lekë dhe vlerë kontrate 6,921,840 lekë, ose më pak se fondi limit prej 88,152 lekë dhe OE fitues "S...S" SHPK.

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Riparim mirëmbajtje automjetesh", me vlerë të prokuruar 1,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 990,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 10,000 lekë dhe OE fitues "K..." SHPK.

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje medikamente-Marrëveshje kuadër e ndarë në 23 Lote", me vlerë të prokuruar 22,588,665 lekë, nga ku është konstatuar se për Lotin 1 në vlerën e kontraktuar prej 600,000 lekë, me OE fitues "C. Ph." SHPK si dhe lotin 3 dhe 8 me vlerë të kontraktuar prej 524,450 lekë, me OE fitues nëM. Ph.ò SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **9,036,290 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 - 31.12.2019, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditori **8 procedura** me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **36,627,042 lekë**. Nga 8 procedura të audituara,

konstatohet se në **3** procedura me vlerë kontrate **14,655,553 lekë**, ose **54%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 në*Objekti dhe qëllimi*ò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në*Parimet e përzgjedhjes*ò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **14,655,553 lekë**. Procedurat e audituara dhe konstatuara me problematika janë:

-Procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "Blerje ushqimesh", me vlerë të prokuruar 8,883,208 lekë dhe vlerë kontrate 8,194,820 lekë, ose më pak se fondi limit prej 688,388 lekë dhe OE fitues "S...S" SHPK.

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Riparim mirëmbajtje automjetesh", me vlerë të prokuruar 2,078,000 lekë dhe vlerë kontrate 1,980,500 lekë, ose më pak se fondi limit prej 97,500 lekë dhe OE fitues "K..." SHPK.

-Procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Shërbimi i impiantistikës", me vlerë të prokuruar 4,496,261 lekë dhe vlerë kontrate 4,480,233 lekë, ose më pak se fondi limit prej 16,028 lekë dhe BOE fitues "N...." SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **14,655,553 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 31.12.2020, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi **4** procedura me vlerë të prokuruar mbi 1 milion lekë, pa TVSh dhe vlerë të fondit limit prej **16,406,690 lekë**. Nga 4 procedura të audituara, konstatohet se në **1** procedura me vlerë kontrate **8,310,000 lekë**, ose **42%** e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 në*Objekti dhe qëllimi*ò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 në*Parimet e përzgjedhjes*ò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **8,310,000 lekë**. Procedura e audituar dhe konstatuar me problematikë është:

-Procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "Blerje pajisje mjekësore SRSR", me vlerë të prokuruar 8,322,000 lekë dhe vlerë kontrate 8,310,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 12,000 lekë dhe OE fitues "A...." SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Spitali Rajonal Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike për shumën **8,310,000 lekë**duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2019, të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje shtypshkrime", me vlerë të prokuruar 1,249,999 lekë dhe vlerë kontrate 1,150,215 lekë, ose më pak se fondi limit prej 99,784 lekë dhe OE fitues "R...R." SHPK, është konstatuar se nga KVO dhe Titullari i AK nuk është bërë shpallja fituese e ofertës më të favorshme ekonomike, por asaj me vlerë më të lartë, duke ju referuar vetëm shumatores së çmimeve për njësi e cila në OE e shpallur fitues rezulton më e ulët. Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike nëK...Hò SHPK me vlerë oferte prej 813,001 dhe shpalljen fitues dhe lidhur kontrata me OE nëR..R.ò SHPK me vlerë ofertë prej 1,150,216 lekë, përbën efekt financiar negativ për SRSR në vlerën **337,215 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 nëObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 50-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, SRSR, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, SRSR, të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të analizoj efektin financiar negativ në vlerën prej **337,215 lekë**.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Masa që u rekomandohen, Organeve apo Strukturave të cilat, sipas legjislacionit në fuqi kanë në kompetencë vendosjen e tyre si:

E.1 Masa administrative të rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike., të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe konstatimeve të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenet 23 të ligjit nr. 162/2020, nëPër prokurimin publikò, dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 nëPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, **i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër ti kërkoj Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljen e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për përjashtimin e operatorit ekonomik nëF....òshpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për sa më poshtë:**

-nëF....ò SHPK është shpallur fitues i procedurës së prokurimit realizuar nga Spitali Rajonal Shkodër për 10 Lap Top, procedurë për të cilën OE pas nënshkrimit të kontratës ka dorëzuar pranë SRSR lap-top të Markës/model nëACER A31...-C6FNò.

Grupi i auditimit, me përzgjedhje rastësore ka verifikuar tre laptop mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike nëpërmjet funksionit nëSy. Inf.ò të SO ô indoR's 10, proces i kryer në prezencë të komisionit të prokurimit, anëtarë e të cilit ishte edhe specialistja e IT.

Pas verifikimit të specifikimeve teknike te tre laptop të përzgjedhur rastësisht duke përfshirë dhe laptop-in që posedon specialistja e IT, respektivisht me numrat serial (S/N); Nxntex01674616ad17600; Nxntex01674616ac87600; Nxntex01674616ac57600, rezultojë që: 10 (dhjetë) Lap top-ët kanë RAM-in 4 GB, pra në mospërputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe të ofertës së paraqitur nga vete OE fitues nëF....ò.

Ndërkohë që AK në dokumentet e tenderit ka kërkuar blerjen e 10 laptop-ve me RAM 8 GB nga ana e F.... janë dorëzuar 10 laptop-Model ACER A315-31-C6FN me RAM-in 4 GB.

Modeli në ACER A315-31-C6FN0 i ofertuar dhe dorëzuar nga OE Fas., nga kërkimi në internet në adresën: https://R.R.R.bcgroun-online.com/laptopovi/acer-aspire-a315_31_c6fn-%28nx.gntex.016%29-intel-n3350.-4gb.-500gb-439290, përdor memorien **RAM 4GB LPDDR3 1600MHz**. Për dorëzimin e një malli të ndryshëm nga ai i ofertuar dhe i ndryshëm nga specifikimet teknike të përcaktuara nga AK në DST si dhe deklarim të pa vërtetë/saktë sipas shtrojsës 6 (deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike datë 08.05.2018 prot. AK me nr. 930 prot. datë 08.03.2018) dhe shtrojsa nr.1 (formulari i ofertës, ku përshkrimi mallit është bërë për lap top me RAM 8 GB), duhet të ngarkohet me përgjegjësi OE në... dhe përfaqësuesi i tij z. A. P.

E.2 Masa administrative të rekomanduara Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV).

Nga verifikimi fizik që u krye nga grupi i auditimit, i mbajtur me Akt Verifikim nr.4 datë 14.05.2021 (nr. 230/19 prot., datë 14.05.2021) rezultoi se, një pjesë e sipërfaqes së truallit të pasurisë së paluajtshme prej 66.72 m², përdoret nga një subjekt privat i cili ushtron aktivitet privat bar-bufë. Në lidhje me këtë SRSH nuk ka marrë asnjë masë (njoftim të subjektit, njoftim të IKMT/IMT), me qëllim ndalimin e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe lirim të sipërfaqes, pranë pasurisë që ka në përdorim, mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 195 të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 506, datë 18.09.2013 në ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore.

Sa sipër, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”*, i ndryshuar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, i rekomandojmë, Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Shkodër, vendosjen e masave administrative në Gjorbë, dhe në bashkëpunim të realizojnë pastrimin e territorit të Spitalit Rajonal Shkodër nga të gjitha ndërtimet e ngritura në mënyrë të kundërligjshme.

E. MASA DISIPLINORE

F.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

F.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 në Kodin e Punës, i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës nr. 313 prot, datë 16.09.2016, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit nr. 882 prot. datë 19.09.2011. Drejtori i Spitalit Rajonal Shkodër, të marrë masat disiplinore *“Vërejtje”*, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:

1. Z. L. M., me detyrë ZV/Drejtor i Shërbimeve Administrative për copëtimin e fondeve për procedurat e prokurimit me objekt në Blerje ushqime 2020, me referenca (Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020).

2. Z. E. V., në cilësinë e anëtarit të komisionit qendror për inventarizimin për vitin 2018 dhe në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit në Blerje medikamente MK e ndare në 23 lote; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit në Riparim Mirëmbajtje

Automjeteshò; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i Impiantistikësò

3. Znj. E. H., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të Lap Top-ve; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñRiparim Mirëmbajtje Automjeteshò.

4. Znj. G. N., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim te Lap Top-ve, si dhe në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt ñBlerje ushqime 2020ò, me referenca (Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020ò.

5. Znj. N. L. (specialiste IT), në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes ne dorëzim te Lap Top-ve.

6. B. T., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale konsumi mjekësore e ndare ne 2 loteò.

7. Znj. K. M., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñShërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje privateò, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje detergjente të ndryshëmò.

8. Z. A. H., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje medikamente MK e ndare ne 23 loteò.

9. Z. G.K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurat e prokurimit ñRiparim Mirëmbajtje Automjeteshò.

10. Z. I. Ç., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurat e prokurimit ñRiparim Mirëmbajtje Automjeteshò.

11.Z.V. F., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñRiparim Mirëmbajtje Automjeteshò.

12.Znj. S.K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje shtypshkrimeò.

13. Znj. E.P., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje shtypshkrimeò.

14. Znj. L.Z., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje shtypshkrimeò.

15. Znj. Dh.K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i Impiantistikësò.

16. Znj. S.R., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objektñBlerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër”.

17. Znj. G.G. , në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objektñBlerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër”.

18. Z. A.D., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objektñBlerje pajisje mjekësore për Spitalin Rajonal Shkodër”.

19. Znj. N. Gj., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt ñBlerje ushqime 2020ò, me referenca (Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020ò.

20. Znj. M.K., në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurat e prokurimit me objekt ñBlerje ushqime 2020ò, me referenca (Lot 1 Ushqime koloniale - REF-60461-06-08-2020; Lot 2 Buke Gruri - REF-60463-06-08-2020; Lot 3 Bulmeti - REF-60465-06-08-2020; Lot 4 Mish Vici - REF-60467-06-08-2020; Lot 5 Fruta, perime, zarzavate etj - REF-60469-06-08-2020ò.

21.Znj. M.K., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje ushqimeshò.

22.Znj. A. I., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit ñBlerje ushqimeshò, viti 2018, procedurën e prokurimit ñShërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje privateò, si dhe procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje medikamente MK e ndare ne 23 loteò; në

cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje detergjente të ndryshëmò.

F.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Vërejtje”**, përkatësisht:

- 1. Z. V. M.**, në pozicionin e Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër, për periudhën nga data 05.12.2017- 02.07.2018.
- 2. Znj. T. R.**, në pozicionin e Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër, për periudhën nga data 03.07.2018 - 14.04.2019.
- 3. Znj. Xh. H.**, në cilësinë e kryetarit të komisionit të marrjes në dorëzim të Lap Top-ve, si dhe anëtarit të NJP për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale konsumi mjekësore e ndare ne 2 loteò.
- 4. Znj. A.Gj.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit qendror për inventarizimin për vitin 2018.
- 5. Znj. N.Sh.** , në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i Impiantistikësò.
- 6. Znj. P. N.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje ushqimeshò, viti 2018, ñBlerje kite dhe reagente për Spitalin Rajonal Shkodërò; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje detergjente të ndryshëmò.
- 7. Znj. M. S.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje kite dhe reagente për Spitalin Rajonal Shkodërò.
- 8. Znj. V. B.**, në cilësinë e anëtarit të NJP për procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale konsumi mjekësore e ndare në 2 loteò, viti 2018, procedurën e prokurimit ñShërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje privateò, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurat e prokurimit ñRiparim Mirëmbajtje Automjeteshò.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLI I LARTE I SHTETIT

